

ALFRED KANINI

Vorabërësi
dhe
vajza
e vrarë

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-32

K29

TREGIME

81H-52

K 29

ALFRED KANINI

VOZABËRËSI
DHE VAIZA
E VRARË

Tregime

1430



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJERËZ TË MINIERËS

Në qiellin e minierës qëndronte pezull një diell i madh ngjyrë portokalli dhe mbi çatitë e qytezës lëviznin pa u ndier ngjyrat e perëndimit. Poshtë, oxhaqet e larta të uzinës nxirrnin tym të hollë, gati të tejdukshëm, dhe Maksi mendoi se ajo po konsumonte rezervat e fundit të mineralit. Pastaj do të nisnin të lëviznin makinat nga miniera K. Kjo ishte shumë larg uzinës dhe më parë mineralin e dërgonte në një uzinë tjetër, në një qytet të afërt. Tani miniera ishte urdhëruar të ushqente edhe uzinën e M. Natyrisht kjo ishte punë e vështirë, po rezervat e mineralit të M, ndryshe nga parashikimet, kishin shteruar papritur dhe uzina rrezikohej të mbetej pa punë.

Jeta e saj nuk mund të zgjaste më shumë se dy vjet.

Po ja, një vit më parë kishte ardhur Fati dhe një inxhinier tjetër nga Ministria dhe, për çudi, kërkimet rifilluan në një zonë, që mendohej se mund të mos kishte mineral. Sondat brimonin ditë e natë me një gërvimë të ethshme dhe, ndërsa minatorët nxirrnin shtresat e fundit dhe ushqenin uzinën, ekipi i Fatit nuk kishte ndër mend të tërhiqej. Ai u besonte shumë inxhinierëve që kishin parashikuar

pasuri minerale të pashtershme në nëntokën e M. Edhe qeveria u kishte besuar dhe e kishte aprovuar ndërtimin e uzinës. Por uzina tani mezi mbahej.

Ekipi i Fatit vazhdonte kërkimet. Atëherë Maksi sapo kishte mbaruar studimet. Ai nuk kishte shkëlqyer në mësim, por e ndiente se kishte fituar njohuri të mjaftueshme për një inxhinier miniere dhe, kur e emëruan në atë minierë të humbur, i erdhi keq.

«Ma bënë se nuk mora diplomën «student i dalluar», — mendoj. — Tani për mua të gjitha ëndrrat e bukura morën fund. Unë këtu nuk mund të bëj asgjë dhe do të katandisem në një njeri të rëndomtë, fare pa të ardhme».

Ishte e natyrshme se Tefta as që mund të prante të flitej për të ardhur në M.

Ai mori një valixhe të vogël dhe, pa i thënë asaj asgjë, u nis nëpër qytet, derisa arriti «prapa diellit», në zonën e minierës së M. Qielli iu duk i pangjyrë dhe qyteza mes maleve, e vogël dhe e drojtur. Ndërsa, ndryshe nga ç'e kishte përfytyruar, uturimat e uzinës aty poshtë vinin të mbytura dhe të pafuqishme. Ai e mori vesh si ishte puna dhe një ndjenjë egoizmi e bëri të kalonte një natë jo të qetë.

Po të nesërmen M. u zgjua në festë dhe ai ndjeu se kishte mbetur një njeri i vogël, fare i vetmuar, megjithëse edhe atë e rrëqethte dhe e emociononte gëzimi i përgjithshëm. Ekipi i atij inxhinierit të ri, që në minierë njerëzit u mësuan shumë shpejt ta thërrisnin Fat, kishte arritur më në fund një fitore shumë të madhe: zbulimin e shtresave të bollshme dhe të pashtershme të mineralit. Ai e njihte Fatin. I ishte dukur një njeri i vrazhdë dhe mendjemadh, herë-herë tekanjоз dhe nuk i kishte pëlqyer kurrë. Atëherë Fati ishte student i vitit të fundit. Dukej

djalë i qetë. Kishte shprehur gatishmërinë të punonte ku ta dërgonin. Në diplomë kishte të shënuar «i dalluar», ndaj e kishin emëruar në Tiranë.

«Eh, ky Fati, — i kishte thënë ai njëherë Teftës, — sa bukur dinë ta dredhin njerëz si ky!»

Tefta i kishte hedhur një vështrim të papërcaktuar.

«Nuk e besoj», — i kishte thënë.

Ai kishte dyshuar dhe e kishte vështruar me ironi.

«E njeh?» — e kishte pyetur.

«E njoh, — i kishte thënë ajo, — por, edhe sikur të mos e njihja mund ta kuptoja lehtë se ai nuk duket dhe aq i kënaqur».

Maksi e kishte vështruar ftohtë. Pastaj me një ndjenjë xhelozie të hapur i kishte thënë.

«Mbase ke menduar dhe për të». Ai kishte ndier se po inatosej. «Mbase tani që e vështron, mendon se do të kishe bërë mirë po të shoqëroheshe me të. Në fund të fundit ai është emëruar në Tiranë».

Ajo e kishte vështruar me keqardhje. Kishin zbritur pa folur shkallët e kodrinës, ku ishte vendosur Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave dhe, kur arritën në rrugën e asfaltuar, Tefta i belbëzoi.

«Ti bëhesh xheloz, Maksi, po megjithatë unë të dua, sepse xhelozia është një ndjenjë e përkohshme dhe e parëndësishme. Me Fatin ti nuk mund të mbash një qëndrim të tillë ashtu, rastësisht, dhe këtë unë e kam kuptuar».

Po mendimi se një ditë mund të ndahej nga ajo fare papritur e kishte ndjekur pas gjithë vitin dhe, kur mori emërimin për në minierën e M, ndjeu një zbrazëti dhe një farë zhgënjimi.

«Përse tregohet kaq e pamëshirshme jeta, ë?»

Aty nuk u ngrit ndonjë tribunë, megjithëse prisnin ministrin i cili edhe kishte ardhur. Njerëzit ishin mësuar ta prisnin atë në sheshin e vetëm dhe të gjerë të qytezës dhe t'ia shtronin bisedës pa drojtje. Maksin e shtynë përpara dhe nuk kuptoi se si u ndodh ballë për ballë Fatit. Ai bisedonte me ministrin si me një të njohur.

«Doemos, tha me vete, ai është heroi i ditës».

Edhe minatorët bisedonin me ministrin si me një të njohur.

— Ne kishim hall vetëm mineralin, — tha një minator i vjetër, si të ishte drejtori, — po tani asgjë nuk na mban dot më. Ne me siguri brenda një kohe të shkurtër do ta ushqejmë uzinën me mineralin e ri.

— Në rregull, xha Martin, — tha ministri. (Maksi u habit që ai e njihte me emër minatorin). — Tani vendburimi i ri duhet të kthehet në minierë. Duhet të kthehet menjëherë dhe me të duhet të merren të gjithë inxhinierët dhe specialistët e M. A keni nevojë të dërgojmë specialistë të tjerë?

— Jo, — tha minatori, — nuk kemi nevojë. Këtu janë emëruar inxhinierë të rinj dhe ata kanë energji të pashtershme. Besoj se do t'ia dalim.

(Maksi ishte skuqur deri te veshët dhe i dukej sikur do të tradhtonte veten. Natyrisht, minatori e kishte fjalën për të, por ai mendoi se edhe ato energji që kishte pasur, i ishin mpirë fare).

— Fat, si thua, do të kthehesh në Tiranë? — pyeti ministri.

Inxhinieri, që nuk e kishte mendjen aty, ngriti kokën me habi.

— Jo, përse? — tha. — A nuk jam mirë këtu?

(Maksi ndjeu të rrëqethej i tëri dhe e vësh-troi Fatin në sy. Vërtet ai dukej shumë i habitur).

— Kemi djem të mirë, — tha xha Martini, — kemi djem shumë të mirë.

Dhe Fatij kishte mbetur në minierë. Në drekë ministri u largua. Kur vendosi të kthehej në dhomën e tij, Maksi ndjeu një dorë të lehtë në sup.

— Ej, Maksi, desha të njihem me ty! (Ai e vësh-troi në sy dhe mendoi se ishin pothuaj të një gjatësie dhe të një moshe). Unë jam Fati.

— E di, — i tha ftohtë ai.

— Të pëlqeu miniera në vështrimin e parë?

— Më pëlqeu shumë, — tha ai me ironi të hapur.

Tjetri u mundua të futej thellë në mendimet e tij. Fati kishte një fytyrë të zbetë e të lodhur dhe në faqet ngjyrë gruri dukeshin qimet e mjekrës së parruar. Kur u ndanë, Maksi e vështroi se si ecte ai duke u lëkundur me një mënyrë kapriçioze, por u habit me veten që nuk e kishte përfshirë asnjë ndje-një inati dhe mendoi se të gjitha ndjenjat kishin filluar t'i tulateshin.

*

* *

Nga bregu, lumi i kaltër dhe shumë i kulluar që në kthesat përplasej duke bërë shkumë, mezi dukej. Maksit i ishte bërë zakon të qëndronte për orë të tëra në bregun e lumit. Edhe tani ai vendosi të zbriste dhe të qëndronte vetëm. Më në fund i kishte shkruar Teftës se ndodhej në M, se nuk kishte asnjë shpresë të emërohej në ndonjë vend tjetër dhe i lutej të mos mendonte më për të.

Në M. kishte nisur puna për ta kthyer vendbu-

rimin e ri në minierë. Inxhinierët dhe specialistët ishin angazhuar të gjithë dhe puna po lëvizte me vull. Por ai e ndiqte si një njeri i largët, që nuk ka të bëjë fare me të. Në një mbledhje të hapur të këshillit teknik, ku merrnin pjesë edhe mjeshtrit e minierës, natyrisht edhe heroi i punës socialiste, xha Martini, për herë të parë e zgjuan nga gjendja apatike në të cilën kishte rënë që kur kishte ardhur në M. Ai punonte në një zyrë mes ca shkresave dhe merrej me shpërndarjen e forcave prodhuese.

— Kryeinxhinier, — tha xha Martini, — pse nuk i caktoni ndonjë punë atij të riut?

— I kemi caktuar, xha Martin.

— I keni caktuar një punë të kotë, — tha xha Martini. — Prandaj duhet t'i caktoni një punë në vendburimin e ri.

— Kjo është e drejtë, — tha Fati. — Ai duket sikur ka mbetur i huaj për minierën.

Maksi i hodhi Fatit një vështrim të papërcaktuar.

Tani ai rrinte i menduar në bregun e lumit dhe herë pas here shihte xhadenë e paasfaltuar ku lëviznin makina. Xhadeja nga uzina në minierë gjithnjë kishte lëvizje të madhe, dhe kjo lëvizje e bënte të mendohej e të ndiente shqetësim. Kur doli në rrugë, vuri re se njëra nga makinat u ndal disa hapa larg tij. Nga dera që u hap ngadalë, u dukën një palë këmbë vajze dhe pastaj Fati që u hodh në rrugë. Në fillim ai u habit, por u kujtua se nuk e kishte parë gjithë atë ditë. Fati i thirri që ta priste dhe të dy iu afruan me çap të gjatë dhe të lehtë.

— Maksi, kjo është Didona.

Ai vuri buzën në gaz. Natyrisht, ajo nuk mund

të ishte Didona e Kartagjenës. E kush na qenkësh pra ajo?

— Është gruaja, — tha Fati. (Ja se çfarë, ai na qenkësh i martuar!)

— Vendosa të qëndroj gjithnjë në minierë dhe e thirra të vinte. Ajo nuk mund të vinte pa u siguruar nëse do të qëndronim në minierë për fare, apo për një farë kohe.

Maksi i vështroi me një ndjenjë habie. Ajo ishte një grua e re dhe shumë më e bukur se Tefta, në sytë e saj nuk vihej re asnjë shenjë pakënaqësie.

«Ky Fati, — tha me vete, — vërtet paska lindur me fat». Ai i hodhi një vështrim në fytyrë. «Mbase është nga ata njerëz që kanë shumë besim në vetvete dhe kanë sukses në dashuri. Megjithatë, ai nuk duket kushedi se çfarë».

Fati ishte nga ata njerëz që karakterizohen nga një vullnet i fuqishëm dhe nga zakoni për të mos u tërhequr kurrë përpara se të arrijnë përfundimin.

«Po është me të vërtetë fat të të dojë një grua kaq e bukur dhe të vijë në M. pa u bërë merak fare», — mendoi Maksi.

— Maksi, — i tha ai. — A do të punojmë bashkë në vendburimin e ri? Unë desha të të takoja për të filluar që nesër. Natyrisht, po të pranosh që të punojmë të dy.

Ai e vështroi në sy. Ende e brente ai inati i vjetër dhe nuk i besohej që në sjelljet e tij kishte një sinqeritet të vërtetë. Ai mendonte se Fati mundohej të shtirej si njeri i mirë, që punonte shumë dhe nuk mbante asnjë inat me të tjerët. (Sepse, natyrisht, sikur ta kishte njohur më parë Teftën, ai me siguri do të mbante inat. Maksi i kishte thënë Tef-

tës se nuk donte ta shihte të fliste me Fatën dhe gjatë gjithë kohës ajo e mbajti fjalën).

«Po përse të mos besoj se ai është një djalë i mirë, — mendoi, — unë nuk kam parë asgjë të keqe. Në fund të fundit ai qenka i martuar».

— Si thua, Maksim? — i tha ai.

— E ç'mund të bëj unë në vendburimin e ri?

— Mund të bësh shumë, Maksim, — tha ai, — sepse vendburimi i ri duhet vënë në shfrytëzim menjëherë. Tani ne po realizojmë përgatitjen për shfrytëzim. Po besoj se do të hasim vështirësi për të realizuar dy problemet e tjera: shfrytëzimin dhe ajrimin. Për këtë duhet patjetër ndihma jote.

— Përse mendon se unë jam në gjendje ta zgjidh këtë?

— Unë kam parë punimin tënd të diplomës, — tha Fati.

— E çfarë, ai nuk qe ndër më të mirët. U vlerësua me notën 8.

— Sikur të mos ishe ngutur, ti do të arrije një sukses të vërtetë. Me sa duket ti nuk ishe konsultuar në ndonjë minierë dhe kishe punuar më shumë në laborator.

— Kjo është e vërtetë, — tha Maksim.

— Po tani ti ke rast ta vësh në jetë projektin tënd. Pikërisht shfrytëzimin dhe ajrimin e galerive. A nuk është kështu?

— Është pikërisht ashtu, — tha Maksim, — por është e pamundur.

— Përse është e pamundur?

Maksim hezitoi të përgjigjej dhe e vështroi në sy.

«A mund të jetë me të vërtetë kaq i sigurtë ai siç duket në sy?» Vendosi të flasë hapur.

— Sepse mua nuk më pëlqen të punoj në M, —
i tha.

— Ah, po kjo është punë tjetër.

— Merre si ta marrësh, — tha Maksi.

— Jo, jo, Maksi, kjo s'ka të bëjë fare me aftësitë
e tua si inxhinier.

Ai u kthye nga Didona.

— Mendoj se ke të drejtë, Fat, — i tha ajo.

«Ja një harmoni mendimesh», — tha me vete
Maksi.

Ata kishin arritur para ndërtesës dy katëshe,
ndërtuar sipas një arkitekture të vjetëruar dhe lyer
me gëlqere. U ngjitën të tre në katin e dytë dhe u
futën në apartamentin e Fatit. Atë apartament ia ki-
shin liruar dy ditë më parë, pasi inxhinieri kishte njoft-
tuar se do të sillte të shoqen. Apartamenti ishte po-
thuaj i zhveshur dhe çifti i ri, me sa dukej, nuk ki-
shte menduar për ta mobiluar.

Atyre u mjaftonte ta nisnin jetën në M. me një
dhomë, ku ishte vendosur vetëm krevati tek i Fatit
dhe një kolltuk i vjetër dhe një kuzhinë ku kishte
vetëm një tryezë, dy karrige dhe libra mbi tryezë,
në parvazet e dritareve dhe nëpër ca valixhe.

«Mbase Tefta e parashikon një gjë të tillë, —
mendoi Maksi, — dhe kjo me siguri i duket e tmerr-
shme në krahasim me apartamentin e saj në Tiranë»

Pasi vështruan të tre apartamentin, inxhinier
Fat i u kthye nga ai:

— Mos pandeh se mua nuk do të më pëlqente të
punoja në minierën e Mëzezit afër Tiranës, — i tha.
— Unë mund të punoja edhe atje, po si inxhinier atje
s'kam ç'të bëj. Problemet për të cilat mund të ndih-
moj, atje janë zgjidhur me kohë.

— Unë duhet të pranoj se nuk e kam arritur ende një ndërgjegje të tillë, — tha Maksi.

— Ty nuk të pengon ndërgjegjja, Maksi, — i tha ai. — Ty vetëm të mundon mendimi se ke ardhur në një vend të humbur dhe se do të mbetesh gjithë jetën këtu. Ti mendon se këtu nuk mund të ndërtosh familje. A nuk është kështu?

— Mbase është edhe kështu, — tha Maksi.

— Por, — tha Fati, — ky mendim të ka munduar përpara se të provosh se si mund të jetohet këtu, përpara se të kuptosh se këtu je i domosdoshëm, siç mund të ishe në shumë vende të tjera, por aspak në ndonjë zyrë revizionimi. Ta fillosh jetën në një apartament të zbrazët (Fati i hodhi një sy apartamentit të tij dhe ndiente se si kumbonte zëri nga zbrazëtira e dhomës), kjo është më se e natyrshme, siç është e natyrshme të lindë qyteti në një fushë pa asnjë ndërtesë. Qyteti ka lindur, Maksi, dhe njerëzit, të cilët do të kenë nevojë për shumë gjëra, natyrisht do t'i kërkojnë dhe do t'i sigurojnë. Besoj se më kupton.

Papritur u hap dera dhe brenda u futën disa minatorë. Fati u doli përpara dhe i priti duke u zgjatur duart dhe duke vënë buzën në gaz.

— E dinim se nuk do t'ju ndodhej asgjë për të na qerasur, — se kush tha nga minatorët, — pran-daj ju sollëm raki dhe gota.

— I thuaj ndonjë gjë atij, xha Martin, — pësh-përiti Fati.

Xha Martini i zgjati dorën dhe ia mbajti një copë herë në pëllëmbën e tij të ashpër. Ai vuri re se inxhinieri nisi ta ndiente veten ngushtë dhe të drojtur.

— Sikur të mos ishte gjetur vendburimi i ri, —

ia nisi heroi, — ne na duhej të mblidhnim rraquet dhe të shkonim në ndonjë vend tjetër. Po tani që u gjend, ne duhet ta kthejmë atë në minierë. — Ai e vësh-troi Maksin në sy. — Këtë ne do ta bëjmë patjetër, por ne duam ta bëjmë në një kohë sa më të shkurtër. Kjo, natyrisht, do të kërkojë minatorë të tjerë, qytezën do ta kthejmë në një qytet industrial dhe jo të vogël, po të fuqishëm. Ti atëherë do të jesh ende i ri, ndërsa unë plak. Megjithatë, kjo nuk na pengon që të punojmë të dy sa më mirë dhe më shpejt. Socializmit tek ne, more djalë, nuk i lejohet të humbasë kohë. A e kupton ti një gjë të tillë?

Maksi nuk foli, po iu afrua dritares. Qyteza kishte nisur të errësohej dhe tek-tuk ishin ndezur disa drita. Ai ndjeu një turbullirë të pakuptueshme, mendoi kryeqytetin dhe Teftën, nga e cila kishte ikur pa e lajmëruar fare, po shumë i mërzhitur, dhe ndjeu në fytyrë një komb mallëngjimi.

«Mbase nuk duhet marrë me kaq shqetësim, — tha me vete. — Po ta hajë dreqi, këtu s'më ka zënë syri asnjë vajzë që mund t'i vish rrotull!» Ai u ngashërye përbrenda. «Kjo është dobësi karakteri, — tha me vete. — Unë Teftën e kam dashur dhe jam i bindur se më ka dashur. Prandaj, të paktën, tani për tani nuk duhet të më shkojnë në mend gjëra të tilla».

Gruaja e Fatit kishte marrë shishen e rakisë dhe gotat që i kishin prurë minatorët, dhe nisi t'i mbush-te. Kjo ishte mënyra më moderne e të qerasurit dhe atij i erdhi për të qeshur.

«Këta njerëz, — tha me vete, — as që u vënë rëndësi gjërave të tilla. Po, natyrisht, Tefta do ta konsideronte si një gjë shumë të çuditshme.» Ai ndjeu të

inatosej me veten. «Përse të mendoj kaq keq për të, kur ende nuk kam provuar asgjë!»

Atij i kishin lënë një gotë në dorë dhe ai e ktheu pa uruar fare. Por as kjo nuk u ra në sy njerëzve të minierës dhe atij i erdhi mirë, sepse në fakt ai kishte harruar se duhej të uronte diçka.

— Ta kishe sjellë gruan pas një muaj, — tha xha Martini. — Atëherë vendburimi i ri do të niste nga shfrytëzimi dhe ne do ta kishim mendjen të mbledhur dhe do ta kishim festuar si duhej.

— Kjo nuk prish shumë punë, xha Martin, — tha Didona. — Mbase bëra mirë që erdha tani.

— Sidoqoftë, ne duhej ta festonim, — tha xha Martini. — Edhe ti, more djalë (ai iu drejtua Maksit), duhet ta sjellësh gruan këtu.

— Unë nuk jam i martuar, — tha Maksi.

— Po kjo nuk do të thotë se nuk ke ndonjë të dashur, apo jo.

Maksi e vështroi në sy dhe nuk i dha përgjigje. Pastaj u ngrit dhe tha se do të shkonte të flinte. Minatorët e përshëndetën me mirësjellje, ndërsa Fati e përcolli deri jashtë.

— Maksi, — i tha ai para se të ndaheshin. — Pse nuk i shkruan Teftës?

Maksi ndjeu të tronditej, kjo natyrisht nuk mund të ishte një sfidë e rastit dhe ai u kthye me rrëmbim dhe e vështroi tjetrin me dyshim.

— Nga e njeh Teftën ti? — i tha.

Fati vuri buzën në gaz. Maksit kjo buzëqeshje iu duk shumë e çiltër dhe u pendua që bëri atë pyetje.

— Por unë, more Maksi, — i tha me modesti, — unë jam rritur në një oborr me të. Ajo ka qenë

gjithnjë një shoqe e mirë. Unë e di se ju e keni dashur njëri-tjetrin. A nuk të paska folur për mua?

Ai iku pa thënë asgjë duke ndier se ishte skukur deri tek veshët nga turpi. Vërtetë kaq pak e kishte njohur atë vajzë? Kush e lejonte atë të jepte gjykime të përcipta për njerëzit? Ajo vetëm një herë kishte dashur të shprehte mendimin e saj për shokun e femënisë dhe ai ishte bërë xheloz e ishte inatosur.

Ai u end nëpër qytezën e minatorëve fare i vetëm, me mendime të turbullta. Tek-tuk kishin filluar të hapeshin themele dhe të ngriheshin mure, dhe ai mendoi se xha Martini kishte pasur të drejtë kur i tha se M. do të bëhej qytet në një kohë shumë të shkurtër. Sikur vendburimi i ri të përmbante sasira të atilla minerali, atëherë edhe uzina do të zmadhohej dhe M. do të bëhej një qytet shumë i rëndësishëm.

Ai kapërceu xhadenë, iu afrua bregut të lumit, dhe nuk mendoi më për qytetin. Por ai mezi merrte frymë pas krahëve të tij dhe oshëtima e lumit pothuajse i mbyste uturimat e uzinës.

*

* *

As të nesërmen dhe asnjëherë nuk i shkroi Teftës. Ai u harrua pas punës për të përgatitur projektin e shfrytëzimit të minierës. Fati i solli skicat dhe ai krijoi një ide për vendburimin e M. Llogaritë në një kohë të shkurtër të gjitha mundësitë dhe mjetet që ekzistonin, dhe e kuptoi se duhej ta njihte me hollësi vendburimin e ri. Ai nisi të punonte

pa ndërprerje, duke harruar fare se diku, në kryeqytet, ishte Tefta dhe ajo kishte marrë një letër ku ai i shkruante të mos mendonte më për të. Ai besonte se ajo nuk mendonte më për të, prandaj kot kishte marrë mundimin t'i shkruante ashtu.

Nganjëherë në dhomën ku punonin ata hynte Didona dhe u sillte kafe. Duke rufitur kafënë në filxhanët e vegjël, Fati e vështronte atë që thellohej në skicat e galerive, futej brenda nëpër to, dridhej kur ai i thoshte se në atë vend mund të paraqitej rrezik shembjeje dhe nuk duhej hapur galeri, e shihte të gëzohej si fëmijë kur realizonte ndonjë galeri me kapacitet të madh prodhimi. Ai skiconte galeri, horizonte, shuante, hapte të reja dhe, kur pinin kafënë, buzëqeshnin të lodhur. Në dhomë tymi i duhanit vërtitej si një mjegull e bardhë. Didona hapte dritaren dhe atëherë ata kujtoheshin se duhej pushuar pak. Por u lindte një mendim i ri dhe nisnin të grindeshin. Ajo i dëgjonte në heshtje, ata grindeshin me atë gjakftohtësinë karakteristike të njerëzve të shkencës.

— Transportimi i mineralit? Po kjo është më e rëndësishmja! Vështirë të transportohet minerali këtu.

Në letrën e skicuar mbyllej një galeri dhe ata përpiqeshin ta hapnin në një vend tjetër. Një pasdite problemi i shfrytëzimit të galerive ishte zgjidhur. Didona i gjeti ata me këmbët mbi tryezë duke pirë cigare.

— Nesër ta dërgojmë për aprovim, — tha Maksi.
— Besoj se kemi arritur një gjë të mirë.

— Kemi arritur një gjë shumë të mirë, — tha Fati, — dhe nuk ka pse të dërgohet për aprovim. Ajo duhet të dërgohet që tani për të filluar punën.

Sa për aprovimin, atë ministria e ka lënë në duart e vetë njerëzve të minierës. A nuk kemi parë rrugët më pak të kushtueshme dhe më të leverdisshme?

— Kjo është e vërtetë, Fat, — tha Maksi, — por është një gjë me përgjegjësi.

— A nuk jemi ne në gjendje ta mbajmë përgjegjësinë?

— Por, Fat...

Ai ngurronte si një djalosh i pagdhundur dhe Fatit i erdhi t'ia ngjeshte me ndonjë gjë kokës. Pastaj thirri:

— Ej, Maksi, — ai mori një pamje të çiltër, — kjo do të thotë se partia ka besim te ne dhe ne nuk duhet ta justifikojmë besimin vetëm me fjalë. Na u deshën ditë dhe net për të krijuar një projekt të tillë, me pak shpenzime dhe modern. Përse duhet të ngurrojmë si mikroborgjezë.

— Fat, a e di se je një kokëshkrep? — i tha Maksi me habi.

Tjetri ia dha gazit me të madhe. Po kur ndeshi vështrimin e shqetësuar të Didonës, heshti menjëherë.

— Për punën tonë përgjegjësi mbajnë të gjithë njerëzit e minierës, që të gjithë, dhe jo një inxhinier i vetëm. — tha pastaj. — Dhe kjo do të thotë se puna jonë duhej të ishte jo vetëm e ndërjegjshme, por edhe e sigurt. Dhe dije se e kemi realizuar në më pak se gjysmën e mundësisë. Kësaj i thonë të punuar derrçe. Tani duhet të zgjidhim problemin e ajrimit. Mua më duket se ky është një problem i vështirë. Sepse kemi pak mjete dhe mundësira, po shumë nevojë.

Didona vuri mbi tryezë kafënë dhe doli jashtë. Ajo nuk mund t'i vështronte për një kohë të gjatë.



Ata ishin zbehur dhe dobësuar pak dhe leshrat u ishin shpupuritur. Por ajo kishte jetuar gjithë kohën me ta dhe me shqetësimet e tyre dhe tani mendoi se duhej të jetonte edhe ca nën pushtetin e tensionit që kërkon puna shkencore.

Kur u mbyll dera, Fati vështroi andej. Ai e kishte kuptuar heshtjen e saj dhe mendoi se ajo duhej të ishte shumë e shqetësuar. Ata të dy e kuptonin mirë njëri-tjetrin dhe ishin mësuar të këmbenin mendime në heshtje.

— Maksi, pse nuk i ke shkruar Teftës? — pyeti pa të keq Fati.

Tjetri e vështroi me habi.

— Si të erdhi? — i tha.

— Pse nuk i ke shkruar, — nguli këmbë Fati. Ajo është një vajzë shumë e mirë.

— Nga e di ti se nuk i kam shkruar? — e pyeti ai.

— Po t'i kishe shkruar, atëherë ajo do të kishte ardhur, — tani zëri i tij u ngrit dhe ngjante me një hungërimë.

Maksi nuk foli dhe ata u ngritën për të dërguar projektin në vendburimin e ri, ku i prisnin njerëzit të nisnin punën menjëherë. Kur u kthyen, ishte bërë natë dhe qyteza kishte nisur të dremiste. Ndërsa larg, në vendburimin e ri, nisën të uturinin eskavatorët dhe makineritë e tjera që do të pregatisnin minierën e re. Maksi ndjeu se po e përfshinte një mallëngjim i pakuptueshëm. Qyteza po binte në gjumë, ndërsa gërvima e dobët e uzinës që punonte me rezervat e fundit të mineralit, nisi të mbytej nën uturimën e fuqishme të makinerive.

* * *

Nga bregu, konturet e uzinës binin në sy në të gjithë pamjen e tyre. Ajo ngrihej më e madhe nga gjithçka që ishte ndërtuar rreth e rrotull, po madhësia e saj as që binte në sy kur vështrimi përfshinte edhe malet.

Megjithatë, ajo ishte embrioni i një qyteti të madh dhe të fuqishëm industrial. Ai vuri re se oxhakët e saj nuk nxirrnin më tym të tejdukshëm, por e kishin shtuar sasinë e djegies dhe kjo donte të thoshte se ato ditë vendburimi i ri kishte filluar nga shfrytëzimi. Ai e ndiente veten të lodhur dhe nuk kishte asnjë dëshirë të përfytyronte punën për hartimin e projektit të shfrytëzimit të vendburimit të ri. Problemi i ajrimit i mbeti atij, sepse Fati deklaroi se nuk kishte fare haber dhe do të bënte mirë të mos humbte më kohë, po të ndihmonte në zbatimin e projektit për shfrytëzim. Këtë ai e tha thjesht, si të qe një vartës i drojtur, i vockël dhe jo një inxhinier i njohur dhe i zoti në të gjithë minierën. Ai i tha se, po të mos e ndiente veten të sigurt, të mos harronte se ai ndodhej midis minatorëve dhe ata me siguri do t'i jepnin ndonjë mendim.

«Kjo është shumë e çuditshme, — tha Maksi me vete. — Unë as që do ta besoja që një ditë të arrija në mendimin se Fati ishte një njeri i rrallë. Vallë si mund të formohet një njeri i tillë?»

Ai e përfytyroi gjysmë të shtrirë në minder me fytyrë të hequr dhe me vështrim të lodhur dhe të përqëndruar. Ishte një vështrim i tillë që kur ngulej në ndonjë vend, dukej sikur hapte një vrimë të thellë. Ai përsëri e kishte nxitur t'i shkruante Tef-

tës, po kjo për të ishte e pamundur. Sepse ai i kishte shkruar të kundërtën e asaj që kishte dashur dhe, me sa besonte ai, Tefta nuk kishte ndër mend të bënte ndryshe.

Maksi vështronte uzinën dhe mundahej të dallonte uturimën e makinerive, e cila shkrihej me oshëtimën e lumit. Tani në uzinë punonin të gjitha makineritë, uturima e saj ishte si një frymëmarrje e qetë e një vigani. Në orën pesë ai duhej të konsultohej në drejtori me punëtorët për dy projektplanet e sistemit të ajrimit të minierës së re. Ai u mundua të përfytyronte veten mes atyre njerëzve që flisnin pak, po çdo fjalë e tyre zinte vend si një copë e rëndë minerali, dhe ndjeu të mbushej me djersë. Ai ende nuk kishte mundur ta ndiente veten mirë mes tyre ashtu si Fati, po kjo nuk e pengonte t'u paraqiste projektet për konsultim dhe aprovim.

Një javë më parë Fati e kishte marrë me vete në vendburimin e ri. Ai ishte habitur kur kishte gjetur të piketuar në tokën e fortë skicat e tij. Ata kishin hapur galeri, kishin shtruar rrugë dhe shina në një kohë pothuaj të pabesueshme. Minatorët i kishin vështruar ngrohtë. Ata ishin dy inxhinierë të rinj, që kishin vënë të gjitha forcat për të zgjidhur një problem jetik në M. dhe s'kishte pse të mos i vështronin ngrohtë. Por, ama, punën e tyre të jash-tëzakonshme për t'i kthyer vizat në galeri e udhë të hekurta e quanin si një detyrë të rëndomtë, që do ta kryenin sido që të ishte puna. Po Maksi nuk mund të mos e mendonte këtë, ai madje kishte krijuar në përfytyrimin e tij shumë tablo pune nën tokë dhe në të gjitha kishte vënë re njerëz, njerëz më të fortë se toka, njerëz që dinin të shkërmoqnin me lehtësi gurin. Dhe kishte ndier të mbushej përbrenda, ki-

shte ndier një farë mallëngjimi dhe një farë respekti për ta dhe për veten. Ai nuk e kuptonte përse dhe si ata njerëz e kishin detyruar të kërkonte vetveten dhe ta gjente midis tyre. Pse ndodhte një gjë e tillë, ë? U ishte afruar xha Martini. Ai kishte marrë një pamje solemne dhe mudohej t'i vështronte në sy.

«Keni bërë një punë të mirë, djema, — u kishte thënë, — keni bërë një punë shumë të mirë. Sikur të mos arrinit ta shihnit me syrin e partisë, atëherë do të na duhej një vit ose më shumë për ta vënë në shfrytëzim vendburimin e ri. Po ju nuk mund ta shihnit ndryshe dhe ia arritët në krye të muajit».

Ata lëviznin mes makinerive dhe njerëzve që i vështronin me një ndjenjë respekti. Po kur kishin mbetur vetëm, Fati i kishte shtrënguar krahun.

«Maksi, — i kishte thënë, — ai u tregua shumë i sjellshëm, por unë, pa dashur të të fyej apo të krijosh ndonjë iluzion, do të të them atë që s'tha ai. Ti ke aftësi të mëdha në punën shkencore, por unë dua të të jap një këshillë. A më lejon të të jap një këshillë?»

«Sa të duash, Fati».

«Unë vura re se ti gjithçka e vështroje me habi. A nuk është e vërtetë?»

«Po, Fati».

«E pra, ne nuk e kishim të vështirë të projektonim planin e shfrytëzimit, sepse unë e njihja me pëllëmbë vendburimin e ri. Po tani që ty të duhet të punosh vetëm për sistemin e ajrimit, mos harro se do ta kesh të vështirë ta projektosh nga laboratorit».

«Kjo është e vërtetë, Fati».

«Prandaj ti duhet të studjosh galeritë në vend një për një, në mënyrë të hollësishme, duke pasur parasysh perspektivën. Duhet ta heqësh drojtjen».

Ai e kishte vështruar drejt në sy.

«Të kuptoj, Fati, — i kishte thënë dhe i kishte zgjatur edhe atij një cigare. — Ti më fole hapur dhe me singëritet, të falemnderit. Vetëm se ditën e parë do ta kem të vështirë. A do të më ndihmosh ti ditën e parë?»

«Sigurisht, Maksi».

Dhe ata nisën të futeshin nëpër galeritë duke ndier tronditjen e nëntokës dhe gjënimet e mbytura të minave. Pastaj ai vazhdoi punën vetëm, po, për çudi, vinte re se nuk mbetej asnjëherë vetëm. Në errësirën e nëntokës ndrinin llambat e minatorëve dhe vështrimet e tyre të qeta e ndiqnin pas. Dhe ai nisi të bisedonte me ta dhe t'i pyeste për çdo gjë, duke këmbyer mendime nga më të ndryshmet. Kur ishte ulur të projektonte sistemin e ajrimit, në letërën e bardhë i dukej sikur lëviznin buzë, dilnin fjalë, vërejtje, këshilla, mendime (oh, sa shumë mendime) dhe kishte thënë me vete se nuk do t'ia harronte kurrë Fatit këshillën e mirë.

Prandaj ai vendosi të hartonte dy projektplane dhe të merrte për to mendimin e njerëzve të minierës.

Ora nuk kishte rënë ende pesë, por atij i dukej sikur nuk do të arrinte dot në kohë dhe nuk iu ndenj më. I hodhi një vështrim pamjes së uzinës, kurorës së maleve, lumit që lëvizte me vrull dhe vendosi të kthehej në zyrat e drejtorisë. Kur arriti, ora ishte pesë dhe, sa hyri në dhomë, e ndjeu veten të mbështjellë me vështrime pyetëse. Fati ishte ulur diku mes tyre dhe pinte cigare. Me sa dukej po hahej me ndonjërin për ndonjë problem të minierës. (Ai nuk e kishte të vështirë as të hahej me minatorët). Maksit i zuri veshi një bisedë të tillë.

— Ju keni mundur të evitoni në maksimum pje-

rrësinë, kjo është një gjë e mirë. Po megjithatë, rendimenti nuk ka arritur kërkesën e minierës.

— Përse mendon se nuk e ka arritur?

— Për sot e ka arritur, po mendo pas një viti, kur uzina do të zgjerohet dhe do të kërkojë dyfishin e mineralit.

— Këtë mund ta zgjidhë vetëm mekanizmi, — tha Fati. — Por unë nuk kam haber andej. As Maksi nuk duhet të ketë haber.

— A e kenj parashikuar ju vendin për vendosjen e elektrovozit?

— Sigurisht, — tha Fati.

— Atëherë duhet të bëhen disa modifikime dhe të vendoset elektrovozi. Lokomotori nuk mund të ketë kapacitet të madh po të punojë me bateri. Në minierën e Pishkashit e modifikuan elektromotorin dhe e kthyen me sistem elektrik. Bateritë mund të shfrytëzohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

Fati e dëgjonte minatorin me nerva të tendosura, po pastaj i ra shpatullave me dashamirësi. Nga rrobat e minatorit u ngrit pluhur, por atij nuk i bëri fare përshtypje. Ai dukej i freskët, sikur gjithë atë ditë t'ia kishte marrë me gjumë. Pastaj ai iu drejtua kryeinxhinierit:

— Kot që druhet ai, — i tha. — Me siguri ka bërë një punë të mirë, por ende nuk ka fituar besim tek vetja.

Maksi e kuptoi se ata po flisnin për të.

— Pa na trego punën tënde, inxhinier. — Ai e vështroi në sy. — E ke pasur parasysh perspektivën?

«Sa i shqetëson perspektiva, — tha me vete Maksi. — Gjithnjë për të pyesin në fillim. Kjo do të thotë se ata e shohin të ardhmen në zhvillim dhe

nuk duan të bëjnë asgjë jashtë saj ose në kundërshtim me të».

Ai vendosi projektplanet mbi tryezë.

— Unë vërtet nuk jam i sigurt, — tha, — mbase jo nga saktësia shkencore, po, si të thuash... a do t'ju pëlqejë juve?

Minatorët ia dhanë gazit.

— Me sa duket duhet të punosh një vit në galeri që të fitosh sigurinë në vetvete, — tha xha Martini. — Po tani për tani kemi nevojë për inxhinier dhe jo për minator. Pa na i shpjego këto shkarravina.

Të tjerët qeshën dhe ai ndjeu të skuqej nga ajo e folur hapur e minatorit të vjetër. Ai nisi të fliste pa i ngritur sytë nga skicat, dhe në dhomë u bë menjëherë heshtje.

— Problemi i vetëm që më preokupoi, — ia nisi ai, — ishte se a duheshin hapur brembzbergje¹⁾ në çdo shtresë, apo vetëm në njërën shtresë.

Ai ngriti sytë dhe ndeshi në vështrimet e tyre të qeta, që dukeshin sikur e inkurajonin.

— Unë studjova galeritë, mjetet që kemi, mundësitë, kohën dhe hartova projektin e parë. Në këtë projekt unë jam për të hapur brembzbergje vetëm në një shtresë, sepse kjo bën të mundur që të realizohet në një kohë të shkurtër dhe kursen mjete dhe teknikë...

Të tjerët e dëgjonin me vëmendje dhe mundoheshin ta përfytyronin projektin në galeritë e minierës. Ai kishte parë gjithçka me syrin e njeriut nikoqir, që nuk do të harxhojë shumë, që nuk do t'ia vështirësojë punën minatorit. Por ai kishte kursyer më tepër se sa duhej.

1) Brembzbergje — punim i pjerrët.

— Po ajrimi? — pyeti papritur xha Martini. — Si e parashikon ajrimin projekti tënd?

— E di, — tha Maksi, i shqetësuar, — në këtë projekt, ajrimi nuk mund të jetë në nivelin e duhur...

— Nuk duhet kursyer në punën e ajrimit, — tha kryeinxhinieri. — Me sa duket e ke lënë mënjanë në këtë projekt perspektivën. Ajrimi ka të bëjë me shëndetin e minatorëve. Mbi të gjitha, partia na porosit të kemi parasysh shëndetin e njeriut.

— Këtu nuk rrezikohet shëndeti i njeriut, — u mundua të kundërshtonte një minator.

— Në fakt nuk rrezikohet, — tha kryeinxhinieri, — po vetëm vështirëson punën.

Ata nisën të grinden për këtë problem dhe ai i dëgjonte në heshtje, duke provuar një ndjenjë hutimi. Pastaj Fati tha:

— Djema, ai ka hartuar edhe një projekt tjetër. (Me djema ai kishte parasysh edhe xha Martinin, që ishte dy herë më i madh se ai).

Maksi nisi të skuqej. Projekti tjetër ishte i një niveli të lartë shkencor, por, në rrethanat reale, ai nuk mund të zbatohet në një kohë të shkurtër.

— Ky problem zgjidhet i tëri sipas projektit të dytë, — tha ai me një farë ngurrimi. — Në të janë hapur brembzbergje në çdo shtresë. — Ai vështroi minatorët. — Unë kam hapur brembzbergje në çdo shtresë dhe, jo vetëm ajrimi është i zgjidhur, por edhe perspektiva.

Ai nisi të parashtronte argumente dhe të shpjegonte me hollësi projektin. Minatorët e dëgjuan në heshtje dhe ai e kuptoi se ata ndiqnin çdo fjalë me vëmendje, duke u munduar të përfytyronin zbatimin e tij në minierë.

— Më duket se është fjala për shpenzime shumë

të mëdha, — tha kryeinxhinieri. — Tani për tani ne nuk na leverdis të shpenzojmë kaq shumë në M. Ne nuk mund të sjellim në një kohë kaq të shkurtër teknikën që parashikohet në zbatimin e këtij projekti. Ai vështroi inxhinierin me vëmendje. — Më kupton, Maksi?

— Të kuptoj, kryeinxhinier. — Maksi, për çudi, nuk e ndiente veten dhe aq të tronditur. Një farë zbrazëtire iu krijua në trup, por ai u mundua ta mbushte shpejt.

— Unë mendoj se ky projekt ka një të metë të rëndësishme, — tha Fati. — Problemin e mirëmbajtjes. Në këtë projekt mirëmbajtja rrezikohet dhe bëhet shumë e vështirë.

Ata hynë në hollësira. Minatorët kaluan dorë më dorë skicat, nisën të shënonin me thoin e gishtit të madh ndonjë vizë, diskutonin, qeshnin me ndonjë mendim të përciptë ose heshtnin kur ndonjëri propozonte diçka të diskutueshme dhe Maksi e kuptonte se ata e bluanin mirë mundësinë dhe pamundësinë e aprovimit. Ai dukej i drojtur, por atë kohë, ai që e njihte, e kuptonte se luftonte me veten dhe mendonte se nuk i falej drojtja në rrethana të tilla, prandaj gjëja e parë që duhej të bënte ishte: ta flakhte atë me guxim. Nisi të shfletonte edhe një herë me mend studimet që i ishin dashur të bënte për hartimin e projekteve. Ai solli ndërmend të gjitha studimet e bëra që ishin analoge me vendburimin e M, u mundua të futej në galeri dhe mendoi se, sikur të ishte futur me kohë në galeritë e tyre, atëherë do të kishte paraqitur një projekt të saktë dhe më të mirë. Papritur ai ngriti kokën. Dikush kishte hedhur fjalë për projektin e parë, aty duhej përpunuar diçka. Ai nuk e dëgjoi se çfarë pikërisht, po mendimi iu mbër-

thye në shtresat e nëntokës. Të tjerët e vunë re lëvizjen e tij dhe pritën në heshtje.

— E gjeta! — tha ai me vrull. — Më duket se e gjeta.

— Si? — thirri inxhinier Fati dhe kjo mbase ishte pyetja e të gjithëve.

— Ne mund të hapim brembzbergje vetëm në një shtresë por duke vendosur traverbangje¹⁾ lidhëse. Kjo bën të mundur uljen e kostos dhe siguron një sistem të mirë ajrimi.

— Në rregull, Maksi, — tha me entuziazëm inxhinier Fati. — Tani nuk mbetet tjetër veç të përfundosh një projekt origjinal me vlera të mëdha ekonomike.

Skicat kishin arritur përsëri në tryezë, vetëm se gjithë njolla dhe viza, të ndjekura nga vështrimet e minatorëve. Minatorët kishin arritur në të njejtin mendim dhe ai e ndjeu veten të sigurt.

— Për dy ditë, djema, — tha, (ai për herë të parë po u thërriste «djema»). — Për dy ditë, me siguri projekti i ri do të jetë gati dhe ju do të filloni nga puna.

* * *

Kur dolën, ishte bërë natë. Ata kishin ndezur nga një cigare dhe po drejtoheshin në lokalin e vetëm të M. M atij iu duk çuditërisht i rritur, një qytet industrial i rritur dhe me një kapacitet prodhimi të lartë. Fati po mendohej t'i tregonte perspektivën e

1) Traverbangje — galeri lidhëse.

minierës së re e të qytetit dhe në të gjithë qënien e tij të mbyllur ai ndiente gjakun t'i lëvizte me rrëmbim.

Ai përfytyroi rritjen e fuqishme të qytetit në rrethanat e ndërtimit të socializmit në të gjithë vendin. Dhe, kur ai ishte kredhur i tëri në këtë përfytyrim, larg, në gjysmerrësirën e qytetit, i zuri syri një siluetë të njohur.

— Kjo është e pabesueshme, — tha me gjysmë zëri, — ose unë ndiej gjithnjë nevojën e saj dhe më bëjnë sytë.

— Çfarë, Maksi? — e pyeti Fati. Maksi nuk mundi të shquante se në këtë pyetje, shoqëruar me një buzëqeshje, fshihej diçka.

— Asgjë, — tha ai, — vetëm një iluzion. Po nuk ishte vetëm një iluzion.

— Vërtet është e pabesueshme, — pothuajse thirri ai. As që mund ta merrte me mend se do ta takonte aq thjesht dhe papritur pas një pune të lodhshme, që e kishte bërë të ndiente plotësisht vetveten. Dhe natyrisht, pas një suksesi të përgjithshëm...

Ajo lëvizte nëpër shesh duke u munduar të gjente ndonjë njeri, me sa dukej për ta pyetur, po pa guxuar të futej në lokal.

— Ej, Tefta.

Ai nuk do të preferonte asnjë takim tjetër.

Ajo qëndroi në mes të rrugës, duke u kthyer ngadalë nga zëri. Po nuk iu hodh në qafë. Përkundrazi, eci me drojtje, por e vendosur.

— Si je, Tefta? — i tha Fati. — Të gjithë mirë?

— Mirë, Fat, ju si jeni? — Ajo ia nguli sytë Maksit.

— Pasi të sqaroheni, ejani në lokal, unë po ju pres atje, — tha Fati thjesht, pa asnjë ceremoni, por

në heshtjen që la pas, u vendos një gjendje solemne, e ndier dhe jo e zakonit. — Didona me siguri tani duhet të vijë.

Ai u largua duke u lëkundur dhe ata e ndoqën një copë herë me sy.

— Erdha vetëm për dy fjalë, — ia nisi ajo.

— Më mirë mos thuaj asgjë, Tefta, — tha Maksi. — Ose m'i thuaj vetëm nëse ato dy fjalë janë një e sharë e mirë. Por as që dua të më thuash se jam një idiot, që nuk kam haber nga dashuria.

— Erdha pikërisht të të them se je një idiot, që nuk ke fare haber nga dashuria.

— Atëherë unë jam i detyruar të të them se të kam dashur gjithë kohën, të kam dashur aq shumë, sa që nuk do ta duroja dot vetveten pa ty.

— A ta besoj një gjë të tillë?

— Sigurisht, — tha ai. — Sepse këtu nuk ka asnjë vajzë tjetër, me të cilën mund të bija në dashuri. Duhet të dish se këtu mund të biesh në dashuri ose me minierën ose me bregun e lumit dhe në një rrethanë të tillë...

— Maksi, je shumë i keq, — i tha ajo. Ajo e kuptoi se ai nisi të tallej. Dhe këtë e bënte si zakonisht kur e ndiente fajin.

— Edhe sikur të kishte vajza të tjera, — tha ai, — unë do të bija në dashuri vetëm me minierën. — Ajo ia nguli sytë duke vënë buzën në gaz. — Sepse minierën e re e projektova unë, ja me këto duar, dhe tani më duket shumë e çuditshme turbullira ime. — Ai dukej vërtet shumë i lodhur. — Po megjithatë... — Ai heshti dhe i hodhi duart në qafë sipas një zakoni të vjetër.

— Por, Maksi?

— Por, megjithatë, unë nuk mund të gjeja asnjë vajzë si ti...

Ata lëvizën nëpër rrugën që të shpinte në bregun e lumit. Ishte natë dhe deri aty ndiheshin si një oshëtimë e zgjatur uturimat e makinerive.

— Vërtetë nuk mund të jetohej në M? — e pyeti ajo.

— Jetohej, — Maksi ktheu kokën nga M. — Po me ty jetohej më bukur.

— Megjithatë, ti je një djalë i keq, egoist, kokëshkrep, — tha ajo.

— Jo, — tha Maksi. — Unë jam vetëm egoist. Po tani vetëm në dashuri jam egoist. A vendose të vish për fare këtu?

Ajo ia dha të qeshurit.

Ata kishin arritur në bregun e lumit. Tani oshëtimja e tij shkrihej me uturimën e makinerive. Prapa kishte mbetur qyteti. Ai qytet rritej me vrull në dimensione të pallogaritshme në një kohë fare të shkurtër. Dhe njerëzit që lëviznin të qetë dhe të sigurt futeshin në tablonë e një jete jo të zakonshme, po të mbushur me ngjyra dhe dritë...

RRUGË NË BARDHËSI

Jashtë nisi të binte një shi i imtë e i ftohtë dhe pastaj dëborë. Malet e bardha hidhnin një reflektim të kaltëryer në xhamat e mëdha të lokalit. Historiani ndiente të ftohtë. Porositi dhe një uzo tjetër, po nuk e ndjeu veten mirë, ndaj e këshillova të pinte konjak. Një historian e ka më të lehtë të rrëmojë në pluhurat e kohërave sesa të pijë dy lloj pijesh të nxehta në një lokal turistik, të ngjeshur mes maleve. Megjithatë, ai po qëndronte «si burrë» dhe vështronte nga një e çarë mali detin blu.

Ndodh nganjëherë, kur udhëton, që has njerëz interesantë, mundohesh të gërmosh në botën e tyre dhe pastaj të shkruash për ta. Në hotelin sipër lokalit, njerëzit, përveç historianit, nuk më ngjallën ndonjë interes. Ndërsa vendi përreth kishte një bukurri mahnitëse. Binte dëborë, megjithëse poshtë në qytete kishte ardhur pranvera.

— Me siguri atje poshtë njerëzit bëjnë banjë dielli dhe lahen, — tha historiani duke u dridhur nga të ftohtët. — Gjithnjë kjo puna e kohës më është dukur një fenomen i çuditshëm. Përse ndodh

një fenomen i tillë, ë? — Ai më vështroi në sy me një ndjenjë keqardhjeje e mërzie.

— Nuk e di, — i thashë. Unë nuk kisha aspak ndër mend të vendosja një heshtje të zyrtë, por edhe nuk po gjeja dot ndonjë mënyrë për t'ia hequr mendjen nga të ftohtët mikut tim historian. Tryeza jonë binte në kontrast me gjallërinë e lokalit.

Matanë xhamave u krijua një shtresë e trashë dëbore dhe njerëzit vërshuan jashtë, atëherë ndjeva kënaqësi dhe mendova të dilja edhe unë bashkë me historianin. Po të luanim me dëborë, do të flaknim plogështinë dhe do të ngroheshim. Mirëpo historiani nuk kishte ndër mend të dilte jashtë.

— Me siguri duhet të kem marrë ndonjë të ftohtë, — tha. — Dil ti, unë nuk besoj të mërzhitem vetëm.

— Më vjen keq, — i thashë.

— Jo, jo, dil, — tha ai. — S'ka pse të të vijë keq. Unë kam ftohtë ose më duket sikur kam ftohtë.

— Mua nuk më bëhet gjë po të qëndroj këtu, — i thashë me mirësjellje.

Jashtë nisi një betejë e vërtetë dhe në fakt mua mezi po më mbante vendi. Nga xhamat e mëdha të lokalit mund të shihje vetëm një pjesë të kësaj beteje, pikërisht atë ku një grup çamarokësh vendës luftonin me disa çifte të porsamartuara, që kalonin pesëmbëdhjetëditëshin «e mjaltit» ose pushimet. Një-ri nga çunakët depërtoi gjer në lokal dhe, kur unë e vura re, ishte vonë, sepse ai e kishte lëshuar topin e dëborës që iu ngjesh historianit në turinj. Edhe kjo i duhej. Ai ngriti fytyrën e zbardhur dhe me një pamje shumë qesharake më vështroi me habi. Unë u vërsula jashtë dhe e ndoqa çunakun, që vraponte duke më qëlluar me dëborë. Ai nuk e kishte parashikuar

se do ta ndiqja këmba-këmbës. Si e zura, e rrëmbeva në krahë dhe e lëshova para tryezës së historianit, duke pritur t'i jepte dënimin. Ai e kishte fshirë fytyrën dhe e vështroi djalin ftohtë.

— Përse qëllave, — i tha, — a e di se nuk është e hijshme të qëllosh me dëborë në një lokal publik?

— Unë nuk e kisha me të vërtetë, — tha. — Vetëm po luaja si të gjithë dhe as që më shkoi mendja se ju do të inatoseshit.

— Po pse zgjodhe pikërisht tryezën tonë? — i thashë. — Përse, ë? Më mirë të më qëllave mua, a nuk e sheh se ai ndien të ftohtë?

— Unë e vura re se kishte të ftohtë, — tha djali, — prandaj vendosa ta qëllaj, që të ngrohej ca.

— Që të ngrohej, ë? — ia ngërdhesha unë duke vështruar mikun tim si për t'i marrë leje që t'ia këputja nja dy të mira që të mos i vinte mendja më t'i ngrohte të tjerët me topa dëbore. — Që të ngrohej, ë?... — Unë nuk vura re asnjë shenjë hakmarrjeje në fytyrën e historianit.

— Sigurisht, — tha djali pa të keq. — A nuk e dini se po të lash trupin me dëborë nxelesh? Këtë e mëson që në klasë të dytë.

Historiani vuri buzën në gaz.

— Shejtan, — i tha. — Qenke tamam shejtan.

— Nuk besoj, — tha djali. Ai ishte aq i vogël, sa të vinte keq ta qëllave me pëllëmbë, po fliste me një zgjuarsiri të çuditshme.

— Nga je? — e pyeti historiani.

— Këndeje, — tha djali.

— Si këndeje?

— Ja, prapa shtëpizave të pushimit, — tha djali. — Po babanë e kam nga malet e Çipinit.

— Ka qenë ndonjëherë në Tiranë babai yt?

— Në Tiranë? — djali u habit. — Aha, në Tiranë! Nuk e di. Ai ka qenë bari më parë, ndërsa tani është kryetar kooperative.

Mua m'u duk sikur ai çunak po na vinte në lojë. Na vështronte me ca sy të zgjuar pa pasur fare frikë. Dhe siç ia kishte nisur miku im, as që do të mund t'i jepte një mësim të mirë. Jashtë dëbora kishte nisur të binte e shpeshtë dhe shumë e bukur, po klientët me sa dukej u lodhën dhe po ktheheshin në lokal. Edhe çunakët hynë në lokal. Ata mbanin në duar topa dëbore të ngjeshur mirë dhe erdhën në tryezën tonë.

— Lëshojeni, — tha më i madhi i tyre, një djalë leshverdhë dhe me fytyrë të djersitur.

— Nuk e lëshoj, — i thashë unë.

— Po nuk e lëshuat, do t'jua ngjeshim me topa dëbore, — tha ai.

Unë e vështrova historianin dhe doemos ndjeva të rrëqethem. Nuk do të ishte shumë e këndshme po t'i duhej të hante nja dy nga ata topat e ngjeshur, po nuk më vinte mirë të tërhiqesha pa ndëshkuar robin tonë.

— Do ta lëshosh, apo...

— Po sikur të mos e lëshoj?

— Do të bëhesh pishman!

— Kjo qenka një çetë cubash, ta hajë dreqi!
— i thashë historianit. T'i marrim emrin dhe t'i themi mësuesit...

— E ke kot, — tha kryetari «i cubave të vegjël», pa më lënë të mbaroja fjalën. — Mësuesi e do shumë Hodon... Pastaj sikur të na kishit qëlluar ju, ne nuk do të ankoheshim gjëkund...

— Ah, Kodo, e quajnë! — klitha unë.

— Jo, Hodo, — tha djali i vogël.

— Atëherë...

— Si, si, si? — u hodh historiani papritur, — Hodo the?

— Po, — tha djali.

— Dhe je nga malet e Çikës?

— Jo, të Çipinit, — tha djali. — Po ngjitur janë. Mos doni t'ju ndihmoj për ndonjë gjë? Babai im është rritur andej.

— Jo, jo, faleminderit.

Unë vura re i habitur se ai kishte ndryshuar menjëherë.

Historiani ishte i zgjuar dhe aspak frikacak. Me siguri emri Hodo i kujtonte ndonjë kryengritës të shekujve të kaluar.

Ata na kërkuan ndjesë me mirësjellje dhe vendosën të largoheshin, po mua m'u kujtua diçka dhe i ndala. Leshverdhi e kuptoi se e kisha me të.

— Vërtet nuk keni frikë fare nga mësuesi?

— Jo, — tha leshverdhi. — Mësuesi na do shumë dhe na vjen turp po t'i ankohet njeri për ne. Por, po ta dinit ju këtë, atëherë...

Ata dolën si një tufë zogjsh çamarokë duke mbajtur me kujdes topat e borës që pikonin. Ne i ndoqëm me sy dhe, kur ata nisën të zvogëloheshin në rrugën e bardhë, historiani u kthye nga unë.

— Me siguri ke dëgjuar për kryengritjen e himariotëve të vitit 1537, — tha. — Unë po kërktoj në këto anë ngjarje dhe legjenda për të. Kanë kaluar shumë kohë që atëherë, po legjendat ruhen. Vërtet nuk ke dëgjuar gjë për këtë kryengritje? Është fjala vetëm për disa dekada pas vdekjes së Skënderbeut.

— Di se pas vdekjes së Skënderbeut nuk ndodhi asnjë kryengritje, — i thashë. — Vetëm se për dhjetëra vjet me radhë shqiptarët luftuan për të mbrojtur

atdheun, derisa më në fund u krye pushtimi, por edhe ky jo i plotë. Pas kësaj periudhe ndodhën shumë kryengritje, si ajo e Tanzimatit, e Rapo Hekalit, e Gjolek mandileziut, e Tafil Buz mustageziut... — Vura re se historiani po shkulej së qeshuri, aq sa klientët e tjerë të lokalit nisën të vështronin nga ne. Unë do të kisha gatuar ndonjë gjellë të çuditshme me njohuritë e mia për historinë dhe ai u qetësua vetëm pasi u ngjitëm në hotel. Vetëm më vonë munda të mësoj se himariotët nuk i kishte nënshtruar dot asnjë ushtri, as ajo prej 200 mijë vetësh, siç shënohet në veprën «Istorie generals des turks», me të cilën erdhi vetë sulltan Sulejman El Kanuni. Malet e Çikës e të Çipinit nga duhej të ishte ai djali i vogël me emrin Hodo, ishin bërë fortesat më të qëndrueshme të atyre kohërave...

Të nesërmen unë isha shumë i mërzitur, sepse rruga ishte bllokuar nga dëbora dhe makina do të vinte vetëm pas disa ditësh. Ne as që mund të lëviznim nga ai vend edhe i bukur, edhe i mërzitshëm. Nganjëherë, kur bukuria nuk bëhet për ta shijuar, të duket shumë e mërzitshme. Unë vendosa të shkruaja diçka dhe ta dërgoja në ndonjë farë mënyre në redaksi. Kur kisha përgatitur një shkrim me shënime udhëtimi, u hap dera e dhomës dhe hyri një djalë i vogël.

— Jam Hodoja, — tha.

— Aha, — ia bëra unë ftohtë. Ishte koha kur duhej të hanim drekë, po historianin e kishte zënë gjumi me libër në duar.

— Unë i tregova mësuesit rastin e djeshëm dhe ai tha se nuk kishim bërë mirë. Vërtet, unë nuk e dija se, kur tjetri nuk ka qejf të luajë, atëherë nuk duhet ta grishësh me zor të luajë. Më falni, ju lutem.

— Qenke djalë shumë i sjellshëm, — i thashë. Unë nuk e kuptoja se përse ai djalë edhe m'i ngrinte nervat, edhe më bënte të mos sillesha vrazhdë me të.

— Merreni si të doni, — tha ai.

— Si munde ta gjesh dhomën tonë? — i thashë.

— Fare lehtë, — tha ai. — Pyeta në sportel.

— Po ti as që e di se si quhem unë!

— Ata në sportel e dinin shumë mirë, — tha ai. — Unë vetëm u tregova se ç'kishte ndodhur. Ai hodhi sytë nëpër dhomë. — Po historiani fle? — pyeti duke vështruar nga ai.

Unë e mora me mend se ai duhej të ishte interesuar edhe për profesionet tona.

— Sapo e zuri gjumi, — thashë.

— Nuk po e zgjoj, — tha ai.

— Përse duhej ta zgjoje?

— Hiç, kot. Vetëm të dija si e ka hundën. Topat e borës zakonisht të dëmtojnë në hundë kur të bien papandehur.

Unë e vështrova gjatë. Çdo gjë që bënte ai djalë më dukej e pazakontë, sikur kërkonte të na vinte medoemos në lojë. Ai sillej tamam si një njeri i sjellshëm dhe me edukatë, por unë s'mund ta besoja se në ca male të ashpra, të mbuluara me dëborë edhe në pranverë, të hasja një fëmijë të tillë. Po kjo ishte fare e vërtetë. Mua m'u kujtuan djemtë e tjerë dhe mendova se njerëzit e këtyre anëve janë shumë të mirë, të sinqertë dhe shumë të zgjuar. Megjithatë, unë dija shumë pak për ata, prandaj vendosa të pyesja historianin. Natyrisht, do ta kisha ca pisk, sepse ai do të më fliste për nja dhjetë shekuj më parë, po fundja do të mësoja diçka. M'u kujtua papritur shkrimi që duhej dërguar në redaksi dhe men-

dova t'ia besoja këtij djali. Po të ishte aq mendjehollë sa dukej, do t'ia gjente rrugën për në Tiranë.

— Hodo, — i thashë, — a mund të të besoj një detyrë?

— Sigurisht, — tha ai.

— Në qoftë se nuk e kryen dot, më mirë ma thuaj.

— Unë do të mundohem, — tha ai me modesti.

Mua vazhdonte të më vinte çudi me mënyrën e tij të të folurit. Ai fliste sikur të ishte i rritur. Në raste të tilla mendja të shkon edhe tek ndonjë «liliput» që nuk ia dallon dot moshën.

— Hodo, sa vjeç je ti?

— Besoj njëmbëdhjetë, — tha.

— Përse vetëm beson? — i thashë me habi.

— Sepse nëna thotë ndryshe dhe gjyshja ndryshe.

— Si thonë ato?

— Nëna thotë se jam dhjetë, ndërsa gjyshja se jam njëmbëdhjetë. Me sa duket kam lindur nga fundi i dhjetorit ose fillimi i janarit.

— Po ti kujt i beson më shumë? — e pyeta.

— Natyrisht, gjyshes, — tha ai si për inat.

— E përse gjyshes? — i thashë unë. — Ty nuk të ka lindur gjyshja.

— Jo, — tha ai, — por ama nënën e ka lindur gjyshja...

Unë vura buzën në gaz. Mbeta plotësisht i kënaqur nga këto përgjigje dhe vendosa t'ia besoja shkrimin.

— E mora me mend, — tha ai. — Më ka qëlluar të përcjell edhe shkrime të tjera që kur isha i vogël.

— Ashtu! — u habita unë. — Po kur e quaje veten të vogël?

— Vitin e kaluar, — tha ai.

Asnjëherë nuk më kishte qëlluar të habitesha
kaq shumë me një fëmijë.

— Po pse vitin e kaluar? — i thashë.

— Sepse isha në fillore, — tha ai.

— Po tani ku je?

— Në të gjashtën dhe të shtatën, — tha ai. —
Ndërsa vitin e kaluar isha në të katërtën dhe të
pestën. Po fjalën e kam vetëm kur isha në të ka-
tërtën.

Mbeta një copë herë i habitur me vështrimin në
sytë e tij të çiltër dhe të vëmendshëm. Nuk më mbe-
tej tjetër veç të besoja se ai ishte një fëmijë i rrallë,
natyrisht jo vetëm për përgjigjet e tij të sakta, si të
qe i rritur dhe me kulturë, por edhe kur mendova
mundësinë e kapërcimit të dy klasëve përnjëherë,
brenda një viti. Unë mendova mësuesin e tij që, siç
kishte thënë djali leshverdhë, e donte shumë. Me sigu-
ri ai mësues duhej të ishte njeri i talentuar dhe i
dashuronte edhe profesionin edhe fëmijët. Nuk ishte
rasti dhe koha të mendoja se si lindin njerëzit që më
vonë bëhen shkencëtarë dhe gjeni, por e përfytyrova
atë pas dhjetë ose njëzet vjetësh, duke dhënë lek-
sione, apo duke gërmuar në të fshehtat e shkencës.
E përfytyrova midis kolegëve akademikë duke zbër-
thyer teori të vështira. A kishte gjë më të bukur
për një djalë njëzet apo tridhjetëvjeçar? M'u kuj-
tuan ca djem e vajza që mezi hedhin këmbët nëpër
rrugët e shkollës dhe të kulturës shkencore për
njohjen e fenomeneve të ndryshme. Kisha krijuar një
bindje se ata dinin çdo gjë të kotë dhe pa asnjë
vlerë, që s'i hyn kujt në punë, dhe as që e vrasin
mendjen se në jetë dhe në rrugët që mund të ndje-
kin ka gjëra më të bukura. Dhe që të ndjekësh një

rrugë virtuoze mjafton të edukosh në vetvete dashurinë për më të mirën, më të vlefshmen dhe të flakësh maninë për të mësuar dhe për të ditur atë që s'ka asnjë vlerë dhe që pas disa vitesh të krijon një zbrazëtim të padurueshme.

Në ç'labirinte do të futej ky djalë pas aq vitesh?

E përcolla deri jashtë. Ai ngrii jakën e gozhupit dhe picëroi sytë e tij të zgjuar. Dëbora e bardhë që kishte mbuluar gjithçka na vrau sytë. Unë vendosa t'i bëja edhe një pyetje:

— Hodo, — nisa, — ç'do të bëhesh kur të rritesh?

— Shkencëtar, — tha.

Dhe unë përsëri mbeta shumë i habitur. Ai e dihte mirë se ç'do të bëhej kur të rritej.

— Pandeha se do të thoshe shkrimtar ose aviator.

— Jo, shkencëtar, — tha. — Këtë ma ka thënë mësuesi.

— Po kjo nuk varet nga mësuesi, — i thashë.

— Natyrisht, — tha, — ndryshe, mësuesi do të më thoshte edhe çfarë shkencëtari do të bëhem. Por ai nuk është ende i sigurt se çfarë shkencëtari mund të bëhem.

Dëbora ndrinte nën rrezet e diellit, që i binin shkarazi, dhe reflektonte një bardhësi të shkëlqyer. A kishte vërtet diçka të jashtëzakonshme te ky fëmijë? Vërtet të gjitha ato fjalë dhe mendime aq të qarta i përkisnin një fenomeni jo të zakonit, apo ishin edukuar me kujdes dhe durim.

Me siguri ishte kjo e fundit.

— Hodo, a do të të qeras me ndonjë gjë?

— Jo, njëherë tjetër, — tha. — Tani mirupafshim.

— Mos të të humbasë shkrimi, — i thashë.

— Nuk do të më humbasë, — tha. — Nesër në drekë me siguri do të ketë arritur.

Ai iku duke lënë gjurmët e tij të vogla në qindra të tjera. Unë e ndiqja me sy tek lëvizte ashtu rondokop, i mbështjellë me gozhup, nëpër dëborën e shkelur.

Kur u ktheva në dhomë, historiani ishte ngritur.

— Erdhi Hodoja, — i thashë. — Deshi të dinte si e kishe hundën.

Historiani vuri buzën në gaz.

— Ah, Hodoja, — tha. — As e merr dot me mend se midis mijëra kryengritësve shqiptarë ka pasur shumë me emrin Hodo.

— Besoj, — i thashë, — por po mendoja se mund të ketë edhe shumë Hodo shkencëtarë.

— Askujt nuk i lejohet të kalojë jetën pa bërë diçka të vlefshme.

Më kishte kuptuar plotësisht...

Makina erdhi vetëm pas tri ditësh dhe shoferi më solli gazetën. Unë e kuptova se Hodoja e kishte kryer më së miri detyrën. Shënimet e mia ishin botuar në një vend të dukshëm. Ne vendosëm të nisehim që atë ditë. Makina priste mbi dëborë dhe, ndërsa unë po ndahesha me historianin, shoferi diç po bisedonte me një njeri. Ai ishte i gjatë, me fytyrë edhe të butë, edhe të ashpër dhe me sy të rrudhur. Me sa dukej po i lutej ta merrte në Tiranë.

— Nuk mundem, — i tha shoferi. — Ne nuk mbajmë bileta dhe s'mund t'i shkel rregullat.

Njeriu qëndroi shumë i dëshpëruar dhe nuk i vinte të largohej nga makina. Mbase ishte e vetmja

makinë që do të shkonte në Tiranë. Papritur dëgjova një zë të njohur.

— Mësues, e rregulloj unë këtë punë.

— E si do ta rregullosh?

— Na lër rehat, mor piciruk, — i tha shoferi.

— E rregulloj unë, — nguli këmbë Hodoja duke e vështruar shoferin me qesëndi. — Ke për të parë.

Djali erdhi drejt nesh dhe unë vura buzën në gaz. U ndava me historianin dhe të tre hipëm në makinë.

— Përse do të shkoni në Tiranë? — e pyeta mësuesin.

— Bëhet një konkurs, — tha ai. — Hodoja do të marrë pjesë në konkurs.

Mësuesi dukej njeri i qetë. Megjithatë, vura re se ai mendohej të përgjonte me një farë nervozizmi çdo sjellje të djalit. Unë e pyeta se nga ishte dhe u çudita kur tha se nuk ishte andej. Ishte nga Vlora. Sigurisht, në fillim ishte mërziur kur e kishin emëruar aq larg. Por po i bëheshin gati 20 vjet në detyrë dhe ai ndihej i kënaqur. Ishte martuar atje me një vajzë të mirë nga fshati, edhe ajo mësuese, dhe kishte kaluar një jetë të qetë, të bukur. Tha se e donte profesionin dhe fëmijët, dhe se koha kishte kaluar aq pa u kuptuar, sa tani i vinte çudi. Gjatë gjithë bisedës nuk ishte vështirë të zbuloje shpirtin e atij mësuesi të thjeshtë. Dukej njeri i thellë dhe i pastër, zemërtartë. Ai ishte nga ata njerëz që dinë të jetojnë kudo dhe t'u bëjnë ballë të gjitha furtunave të jetës.

— Nxënësit tuaj m'u dukën shumë të zgjuar, — i thashë unë.

— Po, — tha ai. — Kjo është natyrë e tyre, po mua më është dashur ta drejtoj dhe përpunoj zgjuarsinë e tyre. Gjithnjë jam munduar që ata të fitojnë

atë që duhet, që do të vlejë për diçka në të ardhmen, dua që ata të mos mbeten njerëz të rëndomtë, pa kurrfarë vlere, sa për të kryer një punë dhe aq. Ai vështroi përtej xhamave të makinës hapësirën e bardhë të dëborës. — E përse të mos jetë e mundur një gjë e tillë kur të gjitha rrugët janë të bardha?

Ai heshti ca dhe e vështroi Hodon në sy.

— Po bëjnë edhe çapkënlëqe, — tha, — dhe ndonjë që nuk i njej i pandeh për rrugaçë.

Mua m'u kujtuan përsëri fëmijët, që në fillim më ishin dukur si cuba të vegjël.

— Jo, janë të mirë, — i thashë, — të gjithë janë të mirë. Kam pasur rastin t'i njoh.

— Oh, me siguri kanë bërë ndonjë çapkënlëk. — Ai vërtet dukej i shqetësuar.

— Jo, jo, përkundrazi... — unë mendova të ndërroj bisedë dhe iu drejtova Hodos:

— Do të fitosh, Hodo?

— Besoj, — tha djali. — Mua nuk më duket e vështirë të fitosh në një konkurs. Puna është që të mos shkosh pa u përgatitur. Por jam i sigurt se në konkurse të tilla do të fitonin të gjithë shokët e mi.

Makina uturiu dhe ai vend madhështor me një pamje mahnitëse mbeti pas ciflave të dëborës...

PLAKU I NJË QYTETI TË HIRTË

Në një lokal shërbente një kamerier plak. Kur nuk kishte shumë klientë, ai qëndronte një copë herë pas dritareve të mëdha me perde të tejdukshme dhe vështronte shiun që qëmtonte ngadalë mbi kalldrëmet me gurë të latuar të qytetit. Nganjëherë pas shpatullave të tij afrohej një vajzë, ajo ishte ndihmësja dhe mundohej të dallonte atë që vështronte plaku në atë qytet të çuditshëm. Në fakt qyteti ishte i tillë. Shtëpitë e gurta ngriheshin përpjetë si kulla të ftohta dhe, kur binte shi, mezi shquheshin nëpër ngjyrat e hirta. Në qytet kishte rrugë të ngushta, të kalldrëmta, që u përkisnin edhe kohërave shumë të lashta, edhe mesjetës. Kalldrëmet e tyre ishin zhveshur, megjithatë njerëzit kishin riparuar një pjesë të mirë të tyre dhe ishin munduar t'u jepnin gurëve ngjyrat origjinale.

Në këtë qytet, pra, banonte kamerieri plak dhe nuk mund të thuhej me saktësi nëse e kishte kaluar rininë aty.

Nga dritaret plaku as që mund të shihte pjesën e poshtme të qytetit, e cila shtrihej në një fushë me përmasa të mëdha. Në atë fushë kishte nisur të ngrinte krye një qytet i ri me ndërtime që i përkis-

nin arkitekturës së ditëve tona. Çdo gjë e re (duke përjashtuar lokalin luksoz ku shërbente plaku) vendosej në këtë fushë, e cila rrethohej me male të larta dhe të zhveshura. Rrugët në këtë qytet të ri, që mundohej t'i ngrinte katet barabar me themelet e kullave të qytetit të vjetër ishin të drejta, të asfaltuara dhe pothuaj pa njerëz. Njerëzve u pëlqenin më shumë kalldrëmet dhe shiu që shtrohej mbi ombrella, si një mysafir fjalëshumë dhe i mërzitshëm.

Kjo e çudiste vajzën, ndërsa plakut i dukej fare e natyrshme. Vetëm klientët që vinin në lokal i dukeshin atij të çuditshëm. Ai ishte një lokal i klasisit të parë dhe në të vinin shumë klientë nga qytetet e tjera. Vajza ishte mësuar me klientët. Ata gjithnjë sillnin diçka të re dhe të freskët në lokal dhe kjo i pëlqente.

Në fillim edhe vajza ndiente njësoj si plaku. Qyteti i dukej i zakonshëm, kurse njerëzit të veçantë.

Në atë lokal kishte ardhur disa vjet më parë, kur ishte ende një vajzë e parritur mirë dhe ishte caktuar të shërbente si ndihmëse e plakut. Atëherë gjithçka që bënte ai plak e tërhiqte. Plaku i ishte dukur i mirë dhe i sjellshëm. Kishte një të ecur plot ceremoni dhe të kujtonte ata shërbëtorët e salloneve aristokrate në disa filma. Me sa e mernte me mend ajo, rininë plaku e kishte kaluar jashtë shtetit dhe profesionin e kishte mësuar në ndonjë lokal luksoz, ku shërbehej me ceremoni dhe fati i klientelës së lokalit varej nga kjo mënyrë shërbimi. Pra, ai i ishte dukur një kamerier plak «aristokrat» i mirë dhe me kulturë profesionale të një niveli të lartë. Ajo kishte rënë nën pushtetin e sjelljes së tij dhe në mënyrë të pavetëdijshme u nënshtrohej të gjitha qortimeve dhe ashpërsisë së tij të ftohtë.

Kohët e fundit ajo kishte nisur ta ndiente veten të rritur dhe, kur ndonjë nga klientët e vështronte në sy dhe në mënyrë që i dukej e pakuptueshme, atëherë skuqej dhe i merrej fryma. Njëkohësisht ajo ndiente vështrimin e ftohtë, të hirtë dhe shumë të kuptueshëm të plakut dhe i ndrydhej diçka përbrenda. E bindur si një fëmijë e edukuar mirë, nxitonte të futej pas dyerve me xhama akulli, që komunikonin me sportelet e kuzhinës.

Pra, plaku i sjellshëm «aristokrat» kishte vendosur pushtetin e tij të ftohtë edhe në botën e ndjenjave të saj plot ngjyra. Plaku kishte arritur t'u hidhte ndjenjave të vajzës mantelin e tij të hirtë, si ato muret e gurta të qytetit, dhe erdhi një ditë që asaj iu duk shumë i neveritshëm.

Kur vinte vjeshta dhe mbi kalldrëme shirat ia nisnin një ritmi monoton dhe të mërzitshëm, në lokal klientët nisnin të rralloheshin, megjithëse kamerieri plak shërbente me ceremoni. Kjo e bënte vajzën të ndiente një farë zbrazëtie. Tabloja e hirtë zinte vend për një kohë të gjatë në sytë e saj të zes dhe ata dukeshin sikur do të mbusheshin me lot. Kjo donte të thoshtë se fati i klientelës së lokalit të tyre nuk varej aspak nga mënyra e të shërbyerit si në ato lokalet jashtë shtetit, ku kishte punuar kohë më parë plaku. Mbase për këtë arsye ai plak i pandehte klientët jo të zakonitë...

*
* *

Dera krisi lehtë dhe në lokal u fut një njeri. Ai i hodhi një vështrim sallës së zbratur dhe të pastër

dhe pyeti me drojtje dhe në mënyrë të natyrshme vajzën që ishte kthyer nga ai:

— Mbyllur është?

Vajza nuk mundi të përgjigjej menjëherë dhe e ngurosi vështrimin në fytyrën e tij të hequr dhe të lagur me leshra të shpupurisura, që i vareshin në ballin e gjerë dhe i jepnin një pamje të çiltër.

A nuk e dinte ai se në vjeshtë vijnë shumë pak njerëz në lokal? Natyrisht, ai nuk mund ta dinte. Prandaj e pandehi të mbyllur. Dhe vajza nuk mund t'u jepte udhë mendimeve. Kishte ardhur një njeri. Mbase vinte nga kryeqyteti, pra një klient që e zhvendoste krejt tablonë e hirtë dhe të ftohtë që kishte zënë vend për një kohë aq të gjatë në vështrimin e saj të mjegullt. Dhe padyshim ai sillte nën gozhupin e lagur freskinë e një vendi të largët. Sa larg ishte ai vend? Hë, pra, klient, se këtu... Ua! Po pse po ikën ai?... Ah! Ka harruar t'i thotë se lokali nuk është mbyllur; sipas rregullit, ajo nuk ka të drejtë t'u thotë asgjë klientëve...

Këtë të drejtë e ka vetëm plaku:

— Urdhëroni, urdhëroni, — plaku iu drejtua me napolin e tij ceremonial, duke e vështruar ftohtë ndihmësen e tij. Mos donte t'i thoshte që ajo të futej pas dyerve me xhama akulli? Jo, ajo vetëm duhej të kryente shërbimin që i takonte si ndihmëse, dhe nxi-toi të servirte bukën, ujin dhe takëmet e të ngrënit; kalimthi dëgjoi hyrjen e ceremonisë:

— Nga vini? — Pyetja ishte e ftohtë dhe vetëm sa për të plotësuar etiketën e lokalit.

— Nga larg. — Zëri i tij ishte i ngjirur, pak i habitur por vështrimi shumë i kthjellët.

— Çfarë jeni, thatë? — Klienti s'kishte thënë asgjë, po kështu e kishte zakon të pyeste plaku. Pra-

ndaj atij i erdhi për të qeshur dhe i hodhi sytë në fytyrën e ulur të vajzës. Vajza e ndjeu vështrimin e kthjellët të klientit dhe padashur e kryqëzoi me të.

— Një lloj zogu, — tha klienti duke rrudhur ballin.

— Aha!... — ia bëri plaku. — Si?... — Pyeti prapë dhe vajza e kuptoi se ai as që e kishte mendjen në ato që i thoshte klienti. Natyrisht, plaku e kuptoi se ai i kishte thënë diçka jo të zakonshme dhe qëndroi të sqarohej: — Domethënë?... — Plaku u ngatërrua dhe vajza vuri buzën në gaz. Klienti e vuri re dhe buzëqeshi edhe ai. Padyshim atij i bëri përshtypje sjellja e plakut. Vajza iu afrua tryezës së tij me sy të ulur dhe përbrenda e digjte kërshëria të dinte se çfarë ishte ai njeri. Ai kishte thënë se ishte një lloj zogu. Sigurisht, ai nuk mund të ishte i çmendur dhe as gënjente, po atij nuk i kishte pëlqyer t'i jepte sqarime plakut. Ai duhej të ishte një njeri që endej si një zog i lirë. Vajza ndjeu nderim për të dhe diçka të afërt me zilinë; sa dëshirë kishte edhe ajo të endej si një zog i lirë dhe ta braktiste atë kafazin e saj me xhama akulli! Ku endej ai? Vajza as që mund ta merrte me mend...

Ai hante i qetë dhe herë-herë vështronte qytetin që dremiste nën shiun e imtë...

Kur erdhi një herë tjetër, ajo ndjeu të skuqej dhe nga vështrimi i ftohtë i plakut u inatos. Dhe nuk nxitoi të futej pas dyerve me xhama akulli. Në lokal kishin ardhur edhe ca klientë të tjerë dhe plaku atë e la një copë herë të priste. Ai përsëri ishte i lagur dhe gozhupi i ishte fryrë nga uji...

Gjithnjë kur vinte ai, vajza e shihte plakun t'i

afrohej me një vështrim të ftohtë dhe mirësjellje të shtirur. Sigurisht, ai njeri që vinte në një lokal të klasit të parë, i lodhur dhe i lagur, nuk mund t'i linte përshtypje të mirë kamerierit plak «aristokrat». Po kjo as që e mërziste djalin. Pas shpatullave të plakut lëvizte vajza dhe ai e vështronte me një palë sy të ngrohtë. Ajo asnjëherë nuk i ngrinte sytë dhe vetëm lëvizte pas shpatullave të mbushura të kamerierit plak. Pastaj ai hante i qetë, me oreks të plotë dhe, kur mbaronte, ngrihej dhe largohej me drojtje. Ai të linte me të vërtetë përshtypjen e një zogu dhe vajza, sa herë largohej ai me çapin e drojtur dhe duke u lëkundur, mendohej të gjente se ku do të «fluturonte» atë ditë. Atë ditë ai nuk do të fluturonte asgjëkund. Do të dilte në rrugët e ngushta e të kalldrëmta dhe do të ngjeshej mes njerëzve të atij qyteti ngjyrë hiri.

Ai ishte gjeolog, pra nuk e kishte keq kur e quajti veten një lloj zogu; me ekspeditën e tij kërkimore i ishte qepur një minerali dhe e kishte zbuluar. Tani kishte ardhur koha të piketohej miniera. Qyteti atij nuk i bënte përshtypje të veçantë. Për të ishte i natyrshëm dhe i bukur; atë e habiste puna e njerëzve për të ruajtur arkitekturën e lashtë. Ai mendonte se njerëzit kanë bërë mirë që e kanë ruajtur arkitekturën e lashtë.

Nganjëherë mernte urbanin dhe zbriste poshtë, në fushë. Aty ishte një pamje fare e zakonshme, rrugë të gjera dhe të asfaltuara dhe ndërtesa shumëkatëshe. Vetëm njerëz nuk të zinte syri aty dhe për këtë i vinte çudi. Edhe aty duhej të lëvrinin njerëz. Aty duhej të ngriheshin parqe, vende çlodhjeje, stadiume; në fakt aty kishin nisur të ngriheshin, po njerëzit ende nuk ishin mësuar me to. Pastaj atij i kujtohej

vajza që lëvizte nëpër lokal me sytë të mbërthyer në shpatullat e kamerierit plak «aristokrat».

«Ai është një plak i çuditshëm», — mendoi. A e dinte vajza se në këtë pjesë të qytetit së shpejti do të shkarkonin materiale ndërtimi dhe pas ca vitesh furra gjigande do të shkruinin mineralin e çmuar që ruanin malet përreth? Natyrisht, vajza nuk mund ta dinte. Ajo nuk kishte si ta dinte, se vështrimi i saj ishte mësuar të mbështetej vetëm pas shpatullave të plakut, ose të shkrihej me vështrimin e plakut në ngjyrat e hirta dhe të ftohta të kullave të gurta të qytetit.

Në lokal nuk kishte shumë njerëz dhe gjeologu erdhi përsëri i lagur dhe i drojtur. Plaku qëndronte më këmbë pranë dritareve të mëdha dhe vështronte shiun që në atë qytet, zgjaste me javë të tëra. Gjeologut iu desh të priste një copë herë. Vajza, si u end ca nëpër sallë, iu afrua e drojtur e me sy përdhe dhe nisi të pastronte tryezën me një pecetë të bardhë borë. Gjeologu u mundua të kapte vështrimin e saj, po vajza i mbante sytë ulur në pecetën e bardhë dhe ai mendoi se nëpër të lëvizte përfytyrimi i plakut. Papritur ai vuri dorën sipër pecetës së bardhë dhe ajo u ndal menjëherë. Atëherë vajza ndjeu nëpër të gjitha qelizat një vështrim që e rrëqethi...

— Kështu i mban gjithnjë sytë?

— Po.

Vështrimi i ftohtë i kamerierit plak «aristokrat» zuri vend në tryezë, si një send i neveritshëm, dhe gjeologu ndjeu një të dridhur të lehtë.

Midis tyre kështu u shpall luftë, një luftë e heshtur, sigurisht, e pakuptueshme dhe e ftohtë... e atëherë plaku nisi t'i shërbente të fundit. Vinin nje-

rëz, iknin dhe gjeologut që i gërvinin zorrët i duhej të priste shumë.

«Më mirë, — mendoi njëherë duke nxjerrë nga xhepi (sigurisht jo revolver) një pako të vogël me biskota. — Kështu mund të qëndroj më shumë kohë në lokal».

Dhe gjeologu mbeti shumë i kënaqur nga kjo sjellje e kamerierit plak «aristokrat», madje iu duk sikur ai dinte t'i kuptonte të tjerët.

Kur nuk i duhej të ngjitej në male, atëherë qëndronte në atë qytet të hirtë dhe hynte i pari e dilte i fundit nga lokali. As që vinte re se ushqimi që i servirnin ishte më i keqi. Edhe sikur ta vinte re, me siguri as do të bënte fjalë. Vetëm po të mos bënte fjalë ai do të kishte mundësi ta shikonte vajzën sa të donte.

Megjithatë, kjo nuk mund të zgjaste shumë. Plaku, natyrisht, do ta kuptonte se klienti i tij i bezdisshëm ishte shumë i kënaqur, prandaj do të ndryshonte takt. Dhe ai ndryshoi takt. Vendosi ta hiqte qafe, gjithnjë me mirësjellje, duke i shërbyer me ato ceremonitë e fryra aristokratike, që të kujtonin sallonet nëpër filma. Pra plaku nisi t'i shërbente të parit, nisi t'i shërbente me buzëqeshje të shtirur, sikur t'i shërbente një të njohuri të vjetër, dhe padyshim duke mos e ndërruar cilësinë e ushqimit.

«Epo, faleminderit, o plak!» Dhe gjeologut përsëri i ngjalli kënaqësi kjo gjendje. Padashur, për një çast pandehi se plaku ishte një njeri zemërmirë dhe i kishte kuptuar ndjenjat e tij. Po ta pyeste ai atë çast, atëherë gjeologu me siguri do t'i fliste për uzinën, për qytetin. Po plaku nuk e pyeti dhe ai e pa të udhës të mos bisedonte me të për asgjë. Kështu gjeologu hante me oreks dhe mundohej të kapte vështrimin e vajzës...

Në kalendarin kronologjik të qytetit kishte ndryshuar diçka. Ndërtimi i uzinës kishte mbushur zbrazëtirën e lokalit. Megjithëse ishte vjeshtë dhe në qytet binte një shi i mërzitshëm, në lokal kishin nisur të vinin shumë njerëz. Këtë padyshim kamerieri plak «aristokrat» as që mund ta priste. Ai nisi ta kishte të vështirë të ruante pamjen e vet ceremoniale dhe i duhej të lëvizte shpejt dhe pa u kujtuar dot gjithnjë se pas shpatullave të tij të mbushura qëndronte i lirë vështrimi i vajzës. Vështrimi i saj kishte nisur të lëvizte jo më vjedhurazi dhe nganjëherë vendosej në tryezën e gjeologut. Kjo padyshim e kënaqte gjeologun. Por ai ishte zhgënjyer me sjelljen e plakut dhe me besimin te kalendari kronologjik i lokalit. Në lokal tani vinin shumë njerëz dhe ai duhej t'u lironte vendin. Me siguri plaku ishte një kamerier mendjehollë. Dhe për herë të fundit gjeologu u ngrit i inatosur dhe doli pa drojtje, i ndjekur nga dy sy të zes, që e vështronin me keqardhje, dhe padyshim edhe nga vështrimi i kënaqur i plakut.

Nuk u duk për një kohë të gjatë në atë lokal të klasit të parë, ku shërbente një kamerier plak «aristokrat» shumë i çuditshëm.

Ai ngjitej nëpër rrugët e kalldrërta dhe ngjeshaj nën tufën e ombrellave. Vetë nuk mbante ombrellë. Në male ajo as që mund t'i hynte në punë. Sa herë zbriste në qytet dhe futej mes njerëzve që pëshpërisnin nën ombrella, e merrte malli për erën e malit. Megjithatë, gjeologu nuk vendoste dot të ngjitej në mal.

Një ditë ai hyri përsëri në lokal dhe u gjend ballë për ballë me vështrimin e ftohtë të plakut.

«Të hëngërt dreqi, o klient i çuditshëm!»

Pas shpatullave të plakut e vështruan dy sy të ngrohtë dhe ai u ishte shumë mirënjohës. Në lokal kishin ardhur shumë njerëz, njerëz të rinj, që ai i njihnte dhe nuk mund të mos shkëmbente vështrime e përshëndetje me ta. Ata ishin piketuesit e minierës. Tani diku në malet e atij qyteti kishin nisur të gërvinin sondat. Kishin ardhur edhe ndërtuesit e parë të uzinës, që e njihnin gjeologun dhe herë pas here i buzëqeshnin.

«E, ç'njeri na qenke ti, o gjeolog?!»

Kamerieri plak «aristokrat» kishte shumë punë. Në të gjithë qenien e tij përplaseshin vështrime punëtorësh. As që kishte ndodhur ndonjëherë që në atë lokal të klasit të parë të vinin aq shumë njerëz dhe aq zhurmëmëdhenj, të cilët sikur e kishin bërë me fjalë që të shpartallonin pamjen ceremoniale të plakut.

— Ore, mbi vezë ecën ti?!

Gjithë jetën plaku kishte shërbyer në ambiente të tilla dhe tani i vinte çudi që për herë të parë nuk po e ndiente veten të sigurt në të. Ai iu afrua tryezës së gjeologut duke u munduar të ruante pamjen ceremoniale, sikur të donte t'i tregonte se me të kishte të tjera hesape. Gjeologu vuri re se vajza nuk nxitoi kokulur matanë dyerve me xhame akulli, si zakonisht.

Plaku kishte vendosur në tryezë vështrimin e tij plot mirësjellje.

«Do të të shërbej shpejt e shpejt, o klient, dhe ti do të këpusësh qafën. Ndryshe, këta klientë do të të hidhen si ujgër të uritur». Plaku i hodhi një vështrim sallës dhe menjëherë dëgjoi zëra.

— Një poç verë, usta!

— Usta, na vdiqe!

Pra, plaku do ta hiqte qafe gjeologun, duke i shërbyer të parit. Klientët gjithnjë i ishin dukur jo të zakon të, por këta ishin me të vërtetë të jashtëzakonshëm. Po plaku nuk e dinte se ata nuk ishin vetëm klientë, dhe këtë e kishte të vështirë ta kuptonte. As që pyeti më për ta, po vendosi të hiqte qafe gjeologun. Qëndronte para tij i fryrë, i pakuptueshëm, i ftohtë. E dinte se, me t'i servirur porosinë, gjeologu do të përpigjej të hante ngadalë, po kjo nuk mund të zgjaste shumë dhe doemos, më në fund, do të ngrihej dhe do të largohej i mundur. Dhe mbase nuk do të kthehej më. Në male miniera ishte pike-tuar dhe atij i duhej të fluturonte gjatë...

Po nëpër të hapurën e dyerve me xhame akulli gjeologu ndjeu vështrimin e ngrohtë të vajzës.

«Unë do ta marr vajzën tënde, o plak!»

Dhe ai mendoi t'ia hidhte plakut. Nisi të porosiste shumë dhe herë pas here. Dalngadalë tryeza u mbush plot dhe u kuptua që plaku nuk mund të matej me të. Ai kishte borxh të porosiste gjithë kuzhinën vetëm që t'ia hidhte plakut. Punëtorët e vështronin me habi. Ata nuk bënë zë kur porosiste gjeologu, po, ama, kur plaku largohej nga ai...

Dhe plaku rendte tryezë më tryezë dhe në fytyrë i lëvrinin pa rregull bulëza djerse, ndërsa gjeologu e vështronte i kënaqur. Pamja ceremoniale, e fryrë dhe e neveritshme e atij plaku kishte nisur të tronditej.

«Me këta klientë nuk di as si të sillem», — mendonte ai i shqetësuar, duke u munduar të ruante sadopak atë pamje. Natyrisht, edhe duke vështruar me bisht të syrit në kishte ndër mend të ngrihej gjeologu, që pastaj të thërriste vajzën ta ndihmonte për të vendosur përsëri pamjen aristokrate.

Gjeologu u ngrit vetëm kur në lokal kishin mbetur shumë pak njerëz. Hodhi çapin e gjatë nëpër sallë dhe atëherë ndjeu krisjen e lehtë të dyerve të «burgut të akullit» të vajzës dhe ktheu kokën.

«Po ikën, gjeolog?»

«Po, po iki».

Vajza qëndronte më këmbë me vështrimin e ngurosor në sytë e tij të qetë. Ndërsa vështrimi i ftohtë i plakut ishte shumë i shqetësuar...

«Megjithatë do të kthehem prapë».

Mbi qytet shiu nuk kishte pushuar dhe ngjyrat e hirta dukeshin sikur kishin zënë një vend të përjetshëm mbi kalldrëme dhe në shtëpitë e gurta, që ngrinin përpjetë kullat e tyre të larta. Megjithatë, në faqet e maleve dhe në qytetin e ri që kishte ngritur kokë në fushë, dielli, që kushedi se nga bridhte nëpër shtëllungat e reve, kishte gjetur kohë t'u hidhte vështrimin e tij të ndezur. Nga faqet e maleve vinin gjëmimet e minave që shponin galeritë.

Dhe nga dritaret me xhama të kthjellët dy sy të ngrohtë vështronin poshtë në fushë. Vështronin si në ëndërr furrat dhe metalin që do të shkiste duke përhapur ngjyra purpuri...

VOZABËRËSI DHE VAJZA E VRARË

Qyteti ishte i vogël dhe me shumë banorë. Në atë qytet kishte lindur vozabërësi. Ishte dimër, një dimër i ftohtë dhe qyteti ishte tkurrur dhe ishte bërë më i vogël. Malet zbardhnin dhe dukeshin të mëdha dhe të kthjellta. Dukej sikur në ato male nuk kishin banuar kurrë njerëz. Megjithatë, nga qyteti kishin vajtur atje shumë njerëz. Nuk kishin marrë asgjë me vete dhe kishin ikur; kur zbritnin në qytet ishin me pushkë.

Atë mëngjes që vozabërësi u ngrit vonë, gjermanët nuk kishin shumë që kishin ardhur. Ata shkollin poshtë e lart nëpër qytet dhe bisedonin me zërat e tyre të çuditshëm. Në qafë u varej një automatik i zi dhe nën helmetë vështronin sytë e tyre të ftohtë... Vozabërësi i shihte nga dritaret e hapura të punishtes. Ata kalonin gjithnjë para punishtes së tij, por asnjëherë nuk kishin hyrë brenda.

Kur erdhën në fillim, kishin hipur në vargane kamionash dhe lëviznin nëpër rrugën kryesore që të shpinte në Tiranë. Herë pas here ndonjëri prej kamionave ndalej dhe nga spondet lëshoheshin breshëri plumbash mbi njerëzit, sikur donin të tregonin

se ata, gjermanët, kishin ardhur. Po njerëzit i vështronin në heshtje dhe mendonin se atje, në male, ua kishin prerë rrugët dhe ua kishin skuqur hundët.

Një kolonë kamionash u ndal në atë qytet dhe në kalldrëm u hodhën ushtarë gjermanë. Ata rrethuan gjithçka dhe trokëllimat e patrullave nisën të shoqëronin këngët e çjerra të mejhaneve. Atëherë kishte shumë mejhane. Shumë kohë dyqanet mbetën mbyllur dhe, vetëm si u mësuan ca me gjermanët, nisën të hapeshin dhe qytetit sikur iu çlirua fryma. Po vozabërësi nuk e mbylli punishten e tij të vogël. Ai i vështronte ftohtë patrullat, ngrihej çdo mëngjes dhe hapte punishten. Ai mendonte se nuk kishte punë fare me gjermanët dhe ata nuk i thanë asgjë. Kur erdhën në fillim ata thanë se, po të mos i ngacmonin, askujt nuk do t'i bënin gjë.

Atëherë ishte dimër, një dimër shumë i ftohtë dhe qyteti mezi merrte frymë. Gjermanët thanë se në male nuk kishte më partizanë. Partizanët ishin bërë «kaput» në male thanë ata. Gjermanët e kishin futur qytetin në thonj të hekurt.

Po një mëngjes patrullat kishin shkelur mbi trakte dhe njerëzit kishin psherëtirë të lehtësuar. Ajo ishte një psherëtimë e gjatë, që doli si një rrymë e ngrohtë ajri nga shumica e shtëpive të qytetit. Edhe vozabërësi sikur u lehtësua dhe sikur e zbuti ca pamjen e tij të zymtë.

Atë dimër vozabërësi nuk kishte pasur shumë punë dhe herë-herë mendonte ta mbyllte punishten. Ai do ta kishte mbyllur me kohë sikur të mos e prisnin fëmijët, sepse vozabërësi kishte shumë fëmijë në shtëpi.

Atë mëngjes dimri që vozabërësi u ngrit më vonë se herët e tjera, ndodhi diçka jo e zakonshme. Ma-

let hidhnin gjithnjë vështrimin e tyre të kthjellët mbi qytet, po që andej nuk kishte zbritur njeri. Dhe atë mëngjes dimri një skuadër gjermanësh kaloi duke trokëllitur këpucët me gozhda nëpër rrugët e kalldrëmta të qytetit. Ata mbanin në duar një trup gjysmë lakuriq dhe vozabërësi që i vuri re, u drodh dhe ngadalësoi hapat. Gjermanët kaluan para tij me një çap kryeneç dhe ai nuk mundi të shquante mirë atë që mbanin në duar. Eci ngadalë, me mendjen tek trupi që mbanin ata në duar. Në punishte arriti i hutuar dhe vendosi ta mbyllte herët. Kur zhveshi përparësen dhe po bëhej gati të dilte në derë, u dha një veturë. Dy gjermanë hynë brenda derës dhe morën qëndrim gatitu. Atë dimër edhe herë të tjera gjermanët hynin brenda dyerve dhe merrnin qëndrim gatitu. Vozabërësi i vështroi me habi dhe me një farë frike. Nga vetura doli një oficer dhe hyri brenda në punishte. Pas tij hyri një civil, që nuk ishte gjerman.

— Padroni ti? — i tha me një shqipe të çalë gjermani.

Vozabërësi ndjeu vështrimin e tij të shpëlarë dhe priti me ankth, duke u munduar të kuptonte se ç'i kishte shtyrë gjermanët ta vizitonin papritur. Mendja i vente tek trupi gjysmë lakuriq që mbante ajo skuadër në duar. Ai me siguri duhej të ishte një trup i vranë. Ai nuk duhej të ishte trupi i ndonjë gjermani.

— Unë jam vozabërës, — tha ai duke vështruar mënjanë gjithnjë me frikë dhe me habi. — Ky është një dyqan i vogël vozash.

— Kupton, — tha gjermani, — Shumë fitoj?

— Jo, pak, — i tha vozabërësi. — Njerëzit nuk

kanë ç'të mbajnë në voza dhe fshatarët nuk mund të futen në qytet. /

— Kjo janë keq, — tha gjermani.

— Për mua keq, — tha vozabërësi. Ai priti që oficeri të urdhëronte ata që qëndronin te dera ta pushkatonin. Oficeri e vështroi ftohtë dhe tundi kokën sikur të pranonte gjendjen e tij.

— Ne ndihmoj, — i tha oficeri. — Ju është mik joni dhe ne ndihmoj.

Vozabërësi e vështroi me habi dhe mosbesim. Atëherë gjermanët premtonin të ndihmonin ata që u lëpinin çizmet.

— Pëlqen ju fitoj para?

— Epo, — ia bëri vozabërësi duke vështuar dy gjermanët që qëndronin palëvizur në të dy anët e derës.

— Ju është mik joni dhe ne ndihmoj, — tha prapë oficeri. — Kur gjithë jo hapën dyqanet, ju hapën. Këtë ne pëlqej.

— Unë dua të punoj, — i tha vozabërësi. — Të tjerët kishin frikë dhe nuk i hapën, kurse unë dua të punoj.

— Po, — tha oficeri, — njeriu don punoj. Partizanët nuk don punoj. Partizanët tani kaput. Ne kaput partizan. S'ka ma partizan.

Vozabërësi e vështroi me neveri dhe priti të vazhdonte, po gjermani heshti një copë herë, pastaj i tha:

— Ju është burrë i ri dhe nuk është partizan. Në këtë qytet burra të rinj është partizan. Ju nuk dua luftën. Ata duan, po tani ne kaput. Ne kaput partizan. Ti nuk ndërtoj ma voza. Ti ndërtoj... — Gjermani nuk e gjeti dot fjalën që i duhej, dhe vështroi civilin që nuk ishte gjerman. Ai nuk dinte

asnjë fjalë gjermanisht, por e dinte mirë qëllimin e kësaj vizite.

— Arkivole, — tha ai që nuk ishte gjerman.

— Po unë jam vozabërës!

Oficeri e vështroi shumë ftohtë dhe vozabërësi mendoi i shqetësuar se do të urdhëronte ta pushkatonin...

— Rruht! — thirri oficeri. Të dy ushtarët gjermanë morën qëndrim gatitu. — Ti më parë bërë arkivole. Kur kolera në qytet, ti bërë arkivole.

«Përse i duan arkivolet këta, ë? — mendoi vozabërësi. Me siguri i duan për vete. Këta gjithnjë kthehen të rraskapitur nga malet dhe për shumë duhen porositur arvikole».

Vozabërësi buzëqeshi dhe tha me zë:

— Atëherë askush nuk i vështronte si i kishim bërë.

— Pra bërë arkivole, — tha oficeri. — Baba yt fiton para dhe bërë hapur duqanin. Tani ti bërë arkivole dhe fiton shumë para. Ti hapur fabrika. Unë tani dërgoj punëtorë.

Vozabërësi u lehtësua nga këto fjalë. Ai ishte një burrë ende i ri që bënte voza, dhe gjithë jetën kishte punuar për të ushqyer fëmijët, që këto vitet e fundit ishin shtuar shumë dhe asnjëherë nuk kishte menduar se mund të hapte fabrikë. Ai e përfytyroi veten midis punëtorëve që do të punonin për të, dhe mendoi se nuk mund të bëhej një zotëri i mirë.

— Voza s'bën ma, — tha gjermani. — Njeriu s'ka ç'të futë në voza. Arkivole, po, njeriu ka të futë.

«Këta duan t'i varrosin ushtarët me salltanet, — tha me vete vozabërësi. — Po të mos i varrosin me salltanet, atëherë ata do të ngrenë krye.

Vozabërësi buzëqeshi për të tretën herë dhe tha:

— Mirë.

Gjermanët te dera qëndronin pa lëvizur, si dy statuja, dhe vozabërësi e mori me mend se, sikur të thoshte ndonjë fjalë tjetër, ata do të shndërroheshin në dy mekanizma vrasës. Ai që nuk ishte gjerman mori frymë i lehtësuar.

— Po unë s'kam material, — vazhdoi me gjysmë zëri vozabërësi duke ndier t'i lëviznin pikla të ftohta djerse.

— Jap ne material, — tha gjermani.

— Atëherë në rregull, — tha vozabërësi.

Gjermani e nderoi ftohtë, siç do të nderonte një zotëri të huaj, ndërsa ai që nuk ishte gjerman, i dha dorën. Ata dolën dhe vozabërësi i ndoqi një copë herë me sy. Kur makina u largua nëpër rrugën e kalldrëmtë, ai nuk mendoi më për ta dhe e mbylli punishten.

Në rrugë bënte ftohtë. Atë dimër në të gjitha rrugët bënte ftohtë dhe njerëzit ishin si të mpirë. Malet rreth e rreth kishin nisur të humbisnin nën retë ngjyrë hiri dhe vozabërësi mendoi se së shpejti do të binte shi. Ai do të ishte një shi i imtë dhe i ftohtë. Vetëm në rrugë vozabërësit nisi t'i kthellohej biseda me oficerin gjerman. Kishte pranuar të ndërtonte arkivole. Oficeri i tha se të gjithë partizanët «kaput». Ai nuk kishte shumë lidhje me partizanët, por ata për të gjithë njerëzit e atij qyteti ishin shpresa, që i bënte të duronin dimrin dhe urinë. Të duronin edhe gjermanët.

Gjermanët lëviznin nëpër rrugë duke lëshuar trokëllimën monotone të hapave në kalldrëm, dhe bisedonin me zërat e tyre të çuditshëm si tingëllimë

metali të ndryshkur. Atë dimër gjermanët u bënë shumë të egër dhe zërat e tyre metalikë flisnin vetëm për vdekjen. Mos i donin arkivolet për të fshehur vdekjen ata?

Vozabërësi u kujtua se para disa orësh një grup gjermanësh mbanin një trup gjysmë lakuriq dhe nxi-toi në sheshin kryesor të qytetit. Aty ishin mbledhur shumë njerëz. Njerëzit vështronin në heshtje diçka që ishte vendosur në mes të sheshit. Vozabërësi u zgjat mbi supet e të tjerëve dhe pa larg, në këmbët e disa ushtarëve, trupin gjysmë lakuriq të një vajze të vrarë. Trupin e kishte të bardhë dhe vendet rreth plagëve ishin mavijosur.

— Ç'është? — pyeti vozabërësi.

— Partizane, — se kush tha. — Me sa duket, ajo që hodhi traktet. Traktet thonë se partizanët janë gjallë dhe së shpejti do të sulmojnë në qytet. Ndërsa këta thonë se i kanë vrarë të gjithë dhe do t'i sjellin në shesh t'i shohim ne.

— A thua t'i kenë vrarë të gjithë? — pyeti vozabërësi.

— Jo, jo... — tha tjetri. Ai ishte një plak dhe në sytë e rrudhur i bulëzonin lot. Me siguri lotët e tij ishin të hidhur. Në atë qytet nuk kishte shumë njerëz të rinj. Aty kishte vetëm pleq, gra dhe shumë fëmijë. Atë dimër në qytetet tona mbetën shumë pak njerëz të rinj.

— Ata nuk mund t'i vrasin të gjithë, — tha plaku me zë të ngjirur. — Duan vetëm që ne të humbim besimin.

— Ata e kanë lënë pothuaj lakuriq, — tha vozabërësi.

— E kanë lënë, — tha plaku. — Një grua deshi ta mbulonte, po ata e qëlluan. Do ta lënë pa varro-

sur një javë. Ata duan të na kallin tmerrin dhe kjo do të thotë se ata kanë frikë.

— A nuk mund t'u lutemi të paktën të mos e lënë të zhveshur? — tha vozabërësi.

Plaku e vështroi me sytë e tij të rrudhur që pikonin lot të hidhur, e vështroi ftohtë dhe vozabërësi ndjeu të rrëqethej. Atë dimër gjermanët edhe në qytete të tjera lanë vajza gjysmë lakuriq në mes të shesheve. Ata e dinin se njerëzit e këtyre qyteteve nuk e duronin dot turpin...

— Është dhënë urdhër që të pushkatohet kush do të guxojë të varrosë, — se kush tha.

Vozabërësi ishte bërë i zymtë dhe nuk e vështroi dot vajzën e vrarë. Të gjithë njerëzit nuk e vështrojnë dot vajzën e vrarë. Vetëm gjermanët me automatikët varur në qafë e vështrojnë me ata sytë e tyre të shpëlarë dhe të ftohtë. Vozabërësi ua nguli sytë. Ua nguli fort dhe me siguri, sikur ta shihnin ata që i erdhën në punishte me oficerin, do të mendonin se ai i maste me sy që t'u bënte arkivolet. Atë çast atij i lindi dëshira të bënte shumë arkivole për ta. Por ai e dinte se në luftë arkivoli është një salltanet. Megjithatë, ai ua nguli sytë fort dhe i mati shumë herë, derisa ua mësoi përmasat mirë dhe derisa ata u larguan duke trokëllitur me hapat monotone dhe duke biseduar me zërat e tyre metalikë. Kur ikën ata, njerëzit mund të afroheshin, por asnjë nuk lëvizti. Ata nuk ishin mësuar t'u afroheshin vajzave gjysmë lakuriq edhe kur ato ishin të vdekura. Njerëzit nuk kishin të drejtë as ta varrosnin dhe as ta mbulonin. Ata rrinin një copë herë duke vështruar njëri-tjetrin dhe largoheshin kokulur. Atë dimër njerëzit u larguan shumë herë kokulur nga sheshet kryesore të qyteteve.

Vozabërësi e hetoi sheshin sikur të mos e kishte parë kurrë. Pastaj u largua edhe ai kokulur, sikur të numëronte me mend gurët e kalldrëmit. Në vështrimin e tij të mjegullt kishte zënë vend trupi i vajzës së vrarë. Duke ecur ndiente vështrimet e ftohta, vështrimet e padukshme dhe të egra të pushtuesve. Atë dimër ato vështrime shndërroheshin papritur në kërkëllima armësh dhe, kur e mendoj një gjë të tillë, vozabërësi u rrëqeth dhe ndjeu frikë se mos ndokujt i shkrepej të qëllonte në errësirë. Me vete tha:

«Paskam frikë».

Aj eci shumë nëpër rrugica, eci si një i dehur që e ka mendjen në rregull.

Kur mbërriti në shtëpi, ishte bërë natë dhe ai hyri shumë i heshtur dhe i zyrtë. Fëmijët kishin rënë të flinin. E shoqja i kishte mbuluar me të dy batanijet e arnuara që kishin, se atë natë bënte shumë ftohtë.

— Ç'u bëre? — i tha. Ajo ishte një grue ende e re. Ai e donte shumë.

— Kishin vrarë një vajzë, — i tha.

— Një vajzë?

— Po, — i tha. — E kishin vrarë dhe e kishin lënë në mes të sheshit pa e varrosur.

— E zeza ajo, — tha e shoqja.

— Ata do ta lënë një javë pa varrosur dhe do të pushkatojnë të parin që do të mundohet ta varrosë.

E shoqja vështrroi fëmijët që flinin nën dy batanijet e arnuara dhe u mundua të kuptonte nëse mërddhinin. Ata flinin të qetë, sikur jashtë të mos bënte ftohtë dhe sikur të mos kishte ndodhur gjë. Por atë dimër edhe fëmijët e dinin se jashtë ndodhnin shumë gjëra. E shoqja i tha:

— A është e vërtetë se partizanët u shfarosën të gjithë?

Vozabërësi e vështroi në heshtje. Sikur ajo ta kishte pyetur ndonjë natë tjetër, ai do ta vështronte me habi. Nuk e dinte se edhe e shoqja mendonte për partizanët. Ai i tha:

— Jo. Ato janë fjalë që përhapin armiqtë.

— Mbase është e vërtetë, — i tha e shoqja.

— Nuk mund të jetë e vërtetë, — tha ai. — Sot ata më thanë t'u ndërtoj arkivolë. Kjo do të thotë se ata po lënë shumë të vrrarë. Kush ua vret ushtarët atyre, ë?

— Megjithatë, këtë dimër partizanët nuk janë ndier në qytet, — tha e shoqja.

— Janë ndier, — tha ai. — Gjermanët e kanë rrethuar krejt qytetin, që ai të mos ketë asnjë lidhje me malet, megjithatë ata janë ndier. A nuk është partizane ajo vajza që kanë lënë në mes të sheshit pa varrosur? Ata duan të na futin tmerrin me trupin e saj gjysmë lakuriq dhe të shpuar nga plumbat.

Vozabërësi u ngrit me vrull. Jashtë kishte nisur të binte shi, një shi i imtë dhe i ftohtë. Vozabërësi mendoi se ishte vonuar shumë. Shiu tani lagte dhe ftohte trupin e zhveshur të vajzës në sheshin kryesor të qytetit. Ai iu afrua fëmijëve, hoqi njëren nga batanijet dhe u bë gati të dilte jashtë, po ndjeu vështrimin e shqetësuar të së shoqes dhe u kthye. Ishte një vështrim i thellë, i mbushur me ankth dhe me një milion pyetje.

— Nuk do të ndodhë gjë, — i tha ai.

Fëmijët lëvizën nën batanije, po ai nuk i vuri re. U largua nëpër errësirë, duke u lagur në shi, me një lopatë bishtshkurtër dhe me batanijen e palosur

nën xhaketë. Bënte ftohtë. Në atë të ftohtë, shumë njerëz largoheshin nëpër errësirë duke mbajtur ndonjë gjë nën xhaketë. . .

Vozabërësi u afrua në sheshin kryesor dhe që larg vuri re trupin e vajzës së vrrarë. Ai zbardhte në errësirë dhe lagej nën shiun që binte. Vozabërësi u bë i vëmendshëm dhe hetoi me kujdes gjithçka. Në periferi të qytetit u lëshuan një tufë krismash. «Po pushkatojnë, — tha me vete. — Po pushkatojnë ndonjë që ka guxuar të varrosë vajzën».

U dëgjuan gjëmime të forta dhe ai mendoi se andej po ndodhte diçka e pakuptueshme. Vozabërësi shquajti një togë ushtarësh gjermanë që u vërsulën me vrap nëpër errësië. Ai u shtri në kalldrëmin e lagur dhe u hoq zvarë deri tek trupi i vajzës së vrrarë. Gjënimet fryheshin dhe jehonin nëpër atë natë dhe kalldrëmi dridhej. Atë dimër gjermanët shkruan fatin e tyre dhe ngryseshin të shqetësuar në qytetet tona. Qytetet tona nuk mund të qëndronin të qeta, megjithëse në kalldrëme përgjonte gjithnjë vdekja. . .

U bë heshtje dhe vozabërësi mbeti i habitur. Ishte një heshtje e thellë që të shponte veshët. Vozabërësi vështroi rreth e rrotull me habi. T'i kishin gjëmuar veshët? Ai preku trupin e vajzës. Ishte një trup i ftohtë dhe i lagur dhe vetëm tani vozabërësi mundi të dallojë fytyrën e saj, një fytyrë të bukur, të cilën vdekja nuk kishte mundur ta shëmtonte. Vajza kishte vënë buzën në gaz. Vozabërësi ishte lagur i tëri dhe e mendoi se nga çasti në çast sheshi mund të mbushej me gjermanë. Prandaj nxori batanijen, e mbuloi vajzën dhe pastaj nisi ta tërhiqte zvarë, duke u ndalur për të marrë frymë dhe për të përgjuar. U afrua zvarë dhe me kujdes deri

tek një mur i bardhë, mes të cilit nxinte si një deriç-kë rrugica. Atëherë u ngrit më këmbë, e mori vajzën e vrarë në duar dhe u fut në rrugicë. Ktheu kokën pas dhe vështrroi sheshin. Iu duk sikur në shesh njerëzit e vështronin me sy të përlotur dhe ai vuri re se psherëtinin të lehtësuar. Kur ktheu kokën prapë, kuptoi se njerëzit nuk mund të vinin në atë orë në shesh, por ai ishte shumë i tronditur. Njerëzit me siguri përgjonin me ankth matanë dritareve natën e lagur dhe ndienin dhembje zemre.

Vozabërësi ndreqi vajzën në duar dhe nxitoi nëpër rrugicë. Vajzës iu var koka pak prapa dhe ai shqoi buzëqeshjen e saj. Ai u mundua ta ndreqte dhe iu duk sikur i qeshën edhe sytë.

«Ke vdekur dulke qeshur, — tha me vete, — prandaj dukesh sikur je gjallë».

Vajza vetëm kishte vënë buzën në gaz dhe ai e vështrroi një copë herë.

«Ç'mendoje para se të vdisje?» — tha. Ai lëvizte nëpër rrugicë me çapa të shkurtër dhe të shpejtë, pa u kujtuar se shkelte nëpër baltë dhe ujë. Pikat e shiut binin mbi fytyrën e vajzës dhe ajo buzëqeshte sikur të ndiente një kënaqësi të çuditshme.

«E kujt mund të jetë kjo vajzë?»

Rrugica nisi të ngatërrohej nëpër ca rrugicëza më të ngushta dhe pothuaj të padukshme dhe ai e kishte të vështirë të ecte. Nata e kishte lagur dhe e mundonte shumë, por ai nuk kishte kohë të ndalej.

Ai e ndreqi më mirë vajzën në duar dhe e vështrroi në fytyrë.

«Pse erdhe tek unë?» — iu bë sikur foli ajo.

Iu duk sikur nga pas i ishin qepur gjermanët. Ata duhej ta ndiqnin me kujdes dhe ai ndjeu pikëla të ftohta djerse. Ndjeu vështrimet e tyre të vëngërta

dhe mendoi të shpëtonte duke u ngatërruar nëpër gjithë ato rrugicëza. Shiu qëmtonte ngadalë dhe duke sikur binin pika akulli të shkrirë. Vozabërësi e ndjeu se do ta kishte të vështirë të arrinte deri në varreza. Atij kishte nisur t'i mpihej i gjithë trupi dhe kyçet po e tradhtonin. U rrëzua përdhe në mes të baltës me gjithë vajzën e vranë. U mundua të ngrihej, po mundi vetëm të shtrihej në rrugicë. Ndjeu kapitje, ndjeu sikur nga lart i binin cifla të rënda plumbi dhe mendoi se do ta kishte të vështirë të ngrihej. Ai vështroi vajzën. Ajo vetëm buzëqeshte. Vozabërësi nuk mundi ta hiqte vështrimin nga fytyra e saj dhe ajo vazhdonte të buzëqeshte.

«Erdha, — tha nën zë. — Në qytet ata thonë se partizanët janë shfarosur të gjithë».

Vozabërësi gulçonte.

«Sikur t'i kishin shfarosur, nuk do të kërkonin t'u bëja arkivole». E pa edhe një herë në sy dhe iu duk sikur vajza përsëri vuri buzën në gaz. Në fytyrën e saj binin pika shiu dhe ajo mori një hije të trishtuar.

«Vajzë, — tha me zë të mekur, — shokët e tu janë larg dhe nuk kishte kush të të varroste». Vajza me buzën në gaz dukej sikur thoshte:

«Jo, janë afër».

Ishte natë, një natë e ftohtë, e lagët dhe njeriu trullosej dhe harronte se ishte njeri. Vozabërësi mbloodhi të gjitha forcat dhe mundi të ngrihej më këmbë. Pati frikë të hidhte hapin e parë, pati frikë se, po të ecte, mund të rrëzohej dhe do ta kishte të vështirë të ngrihej përsëri. Vozabërësi e hodhi hapin e parë, hodhi edhe të dytin dhe nisi të lëvizte me vështirësi nëpër natën e zezë. Ai dukej si një qenie e çuditshme, e qullur, si një amebë vigane, pa for-

më dhe pa trajtë. Lëvizte me plogështi duke hedhur hapa të mëdhenj, që nguleshin fort në tokën e lagur dhe shkuleshin që andej me zhurmë. . .

Vozabërësi arriti me shumë mundim në një fushë të hapur dhe e kuptoi se kishte arritur te varrezat. Pikat e shiut trokisnin lehtë në bar dhe dukej sikur i lëshonin një psherëtimë të zgjatur.

«Shiu do ta ketë zbutur tokën dhe unë do ta kem në lehtë», — tha me vete.

Ai e kishte humbur arsyen dhe vepronte vetëm me mendimin e fiksuar që në fillim për të varrosur vajzën e vrarë. Vajzën e mbështolli me kujdes me batanije, e lëshoi lehtë mbi bar dhe pastaj nisi të hiqte plisa dheu me lopatën bishtshkurtër. Nën batanije vajza dukej sikur nuk kishte vdekur, po flinte duke mërdhirë. Vozabërësi rrëmonte ngadalë duke hequr dheun me kujdes. Iu bë sikur matanë fushës trókëllinë hapa me gozhdë dhe ai ndjeu një rrëqethje të lehtë. Megjithatë vazhdoi ta hiqte baltën dhe ta vendoste në të dy anët e varrit. Larg, në periferi, andej nga duhej të ishin këmbët e maleve, u ngritën gjëmime dhe atij iu dukën të njohura. Gjëmimet ishin të zgjatura dhe të pandërprera dhe ai dyshoi se i bënin përsëri veshët. Vajza tani sikur kishte zënë ngroh-të nën batanijen e lagur.

«Si e ke emrin, moj vajzë?»

Ai ndjeu dhembje trupit, një dhembje të fortë, sikur ta kishin përshkuar téjpertej me thikë.

«U lodha», — tha.

Vendosi të çlodhej ca, sepse e kuptoi që nuk do të kishte më fuqi të hapte varrin. Rreth e rreth errësirë dhe shi. Vajza flinte nën batanije dhe ai e vështronte me dashuri.

«Aty je ngrohtë, — i tha — Ata qenër. . . ata. . .»

Ai e kishte të vështirë të fliste me zë, megjithëse i dukej sikur fliste me zë të lartë.

Mbi bar gjithnjë pikonte shi, fijet e ngopura me ujë pëshpërisnin ngadalë dhe pëshpërima e tyre zgjatej deri larg në murin e zi të errësirës. . .

Vozabërësi hapi më në fund, një varr jo shumë të thellë, iu afrua vajzës dhe ia largoi cepin e batanijes nga fytyra. E vështroi gjatë, me dhembje dhe nisi të dridhej e të gulçonte. Nuk guxonte më ta merrte në duar.

«Po të ishin shokët e tu, do të të varrosnin sipas ligjit partizan, — tha, — do të të varrosnin nën breshërinë e armëve. Sa keq që nuk kam një pushkë!» Ai u mundua të mblidhte veten, mirëpo tani që u mësua me atë vajzë, i vinte keq ta varroste.

«E paskam të vështirë të të varros, moj vajzë», — i tha.

Në periferi gjënimet u bënë më të forta dhe atij përsëri iu duk se ato ishin të njohura. Vozabërësi nisi të lehtësohej, sikur të mos kishte hequr fare atë natë, dhe mendja iu kthjellua. Shiu tani kishte pshuar dhe errësira nuk ishte dhe aq e zezë, megjithatë, ai e mbështolli vajzën mirë me batanije. Pastaj e mori me kujdes dhe e vendosi në varr. . .

Kur në fushën e hapur ishte ngritur një varr, mbi plisat e barit po varej mugëtira. Gjënimet ishin të largëta, po gjithnjë të forta dhe vozabërësi u mundua të orientohej nëpër fushë. Ndihej përsëri i lodhur. Në mugëtirë vuri re silueta njerëzish. Nga helmetat në formë trapezi ai dalloi që ishin gjermanë, po nuk ndjeu frikë. Larg gjënimet shtynin lindjen e një mëngjesi të kthjellët.

SYTË E KALTËR TË MADELËS

Madela është mbështetur në parmakë dhe vështron vetëm detin. Ai duket si një masë e madhe, e zezë, dhe i inatosur. Nganjëherë përplasat me forcë në murin e gurtë dhe thërmohet, duke lagur fytyrën e saj të errësuar. Unë thith cigaren dhe mundohem të mbledh mendimet. Larg vozit, duke u lloçoçitur, një «gjuajtës», po Madela nuk i ngre sytë.

Unë gjithë atë ditë ndenja me Madelën; kur ujërat nisën të llufisin ngjyrat e perëndimit, u afrua një njeri i shkurtër, i shëndoshë dhe tullac, me një pamje si i zënë në faj. Madela i tha se do të rrinte dhe ca dhe unë e kuptova se ai ishte i ati. Unë dikur e kisha njohur të atin, ndërsa tani m'u duk si një njeri tjetër. I thashë Madelës të shkonte më mirë, por ajo u mbështet në parmakë dhe nisi të vështronte detin që shkërmoqej nëpër gurë. I ati ndenji dhe ca, pastaj u largua si i drojtur në mugëtirë. . .

— Nuk do të më zemërohet, — thotë pastaj ajo.
— Ke për të parë.

— Mund të zemërohet ajo, — i them unë.

— As ajo, — thotë Madela. — Shumë-shumë mund t'i thotë ndonjë fjalë kur të bien të flenë. Por atëherë as që ka rëndësi dhe nuk më prish punë.

Madela vështron detin sikur të kërkojë diçka që ka humbur në ujërat e errësuara. «Gjuajtësi» është futur diku në port, midis vaporëve dhe dritëzave që po ndizen. Unë mundohem të arrij mendimet e saj. Vetëm pas shumë vjetësh e gjeta përsëri dhe e kam të vështirë të kuptoj ç'mendon ajo...

Atëherë ajo ishte një vajzë e vogël dhe rrinte gjithnjë me mua, që s'isha veçse dy vjet më i madh. Ne loznim dhe më shumë ziheshim, po e donim fort njëri-tjetrin dhe shpejt pajtoheshim për të lojtur e për t'u zënë sërish.

Kur ndërtonte ura, asaj i pëlqente të vërshëllente një melodi që më ngrinte nervat. Dhe unë ia prishja urën. Ndërsa më vonë, kur unë nisa të montoja nëpër lartësi, e vërshëlleja melodinë duke pandehur se e kisha sajuar vetë. Unë kisha harruar se ishte e saj. Megjithatë, Madelën as që mund ta harroja. Natën nga ujërat e errësuara ngrihej vizioni i kaltëryer i një vajze të vogël.

«Andi, unë dua të ndërtoj ura dhe ti kot m'i prish».

«Pse nuk ndërton minare?»

Ajo më vështronte me habi. Pastaj thoshte:

«Urat hyjnë në punë dhe unë dua të ndërtoj atë që u hyn në punë njerëzve».

Vizioni gjithnjë më vështronte me dy sy të kaltër si deti, me dy sy të gëzuar si deti, dhe ajo ishte Madela që ngrinte ura me currilat e rërës së lagur dhe vërshëllente një melodi që më ndoqi pas gjithë jetën.

Kur unë ia prishja urën, asaj i mbusheshin sytë me lot, që i shkisinin si kokrriza në guriçkat e bardha të bregut, dhe unë pandehja se do të linin pika blu.

«Madela, — i thashë njëherë i habitur, duke e

vështruar me vërejtje, — ty sytë të duken tamam si dy copa deti. — Ajo më vështroi me habi. — Sa keq që leshrat nuk i ke të gjelbra!»

«Përse Andi?!» — pyeti me kureshtje.

«Sikur t'i kishe të gjelbra, do të të dukeshin si leshterikë».

Ajo mori një pamje të pikëlluar.

«Ti bëhesh djalë i keq, Andi. A e di se bëhesh një djalë i keq?»

Atëherë unë ika larg në det. Kur u ktheva, ajo nuk ishte më në bregun e bardhë. E kërkova në shkëmbinjtë dhe guvat, u zhyta thellë në ujin e dallgëzuar, po s'e gjeta dot.

E gjeta vetëm pas shumë vjetësh, të rritur dhe të bukur, mbështetur në parmakët e ndërtuar në të njëjtin breg. Vetëm se sytë nuk i ka më të butë si deti, po të egër si deti...

A i kujtohen të gjitha këto Madelës?

— Atëherë pandeha se ishe mbytur, — nis unë, kur ajo i heq sytë nga uji dhe vështron dritëzat që ndizen një nga një në port. — Të kam kërkuar gjithë ditën nëpër guvat dhe shkëmbinjtë thellë në det duke qarë. Kur erdha në shtëpinë tënde dhe s'gjeta njeri, atëherë mendova se diçka kishte ndodhur.

Ajo më vështron një copë herë në heshtje dhe unë vë re se në fytyrën e zbetë i ka zënë vend një buzëqeshje e hidhur.

— Më thirri gjyshja, — ia nis papritur ajo, — dhe në shtëpi mësova se nëna kishte ikur. A të kujtohet nëna?

Mua më kujtohet e ëma. Ajo leshrat i kishte të verdha dhe sytë të kaltër si të Madelës.

— Në shtëpi gjithëçka ishte e shqetësuar dhe ba-

bai dukej sikur e kishte zënë rrufa. Kur e kujtoj, edhe tani më vjen keq për të.

— Po për nënën?

— Nuk e di, — thotë ajo duke e hedhur vështrimin në ujin e shqetësuar. Një copë herë ndenjëm në heshtje dhe unë mendova se e kisha tepruar. — Me nënën nuk më lidh asgjë, — thotë ajo. — Mua gjithçka më lidh me gjyshen dhe me hijen e tim eti.

— Përse iku ajo?

— Unë gjithnjë e kam përfytyruar një nënë të keqe, — thotë ajo, — që nuk më donte, që nuk donte asnjë njeri. Megjithatë, gjithë jetën jam munduar të gjej se përse iku ajo.

Nga deti nis të fryjë një erë e fortë dhe dallgët coptohen më shpesh nëpër gurë, duke ia lagur fytyrën Madelës. Megjithatë, ajo nuk ka ndër mend të largohet dhe vështron ujërat e mbuiuara me shkumë të bardhë, sikur nën to të fshihet ajo që e ka munduar gjithë jetën.

Ajo tregon duke belbëzuar dhe unë e dëgjoj mbështetur në parmakë.

Të gjitha ato që po ndodhnin në shtëpinë e tyre Madela i vështronte në heshtje, si një vajzë e mirë që ishte, dhe mendohej të kuptonte, pse kishte ikur e ëma. Sikur të ishte zemëruar me të, mirë, por ajo as që e kishte qortuar ndonjëherë. Ajo nuk mundi të kuptonte gjë edhe kur e shpunë në një sallë jo shumë të madhe, në të cilën kishin zënë vend nga njëra anë njerëzit e të atit dhe nga tjetra të s'ëmës. E ëma vështronte vetëm atë. Megjithatë, Madela asnjëherë nuk e thirri «mami», se e kuptonte që këtë mund ta bënte vetëm kur të dilnin dhe të shkonin në shtëpi. Prandaj vështrimin e hiqte nga sytë e saj dhe e gjezdiste nëpër sallë dhe herë-herë e hidhte në profilin

e të atit. I ati përsëri dukej sikur e kishte zënë rrufa dhe vajza sepse mendonte që ai do t'ia plaste të qarit...

— Kur unë ndjeva mungesën e nënës në shtëpi, pyeta gjyshen, — thotë Madela duke lëpirë me gjuhë bulëzat e ujit të kripur që i shkisin nëpër fytyrë. (Ky ishte një zakon i saj i vjetër). — «Ka ikur», më tha ajo.

«Ku ka ikur?» — i thashë.

«Ka ikur për fare», — tha ajo. — Nuk na do më».

«As mua?! . . .

Madela hesht dhe vetëm ujërat lëvizin sikur të mos duan t'i lëndojnë kujtimet e viteve të kaluara; ato herë-herë copëtohen në beton dhe ciflat e lëngëta i përplasen, në fytyrë. Kujtimet lëvizin nëpër natë. Edhe unë nuk kam aspak ndër mend ta lëndoj dhe në qoftë se kujtimet do ta bënë të ndiente dhembje zemre, më mirë të hidhesha në det dhe të humbisja si atëherë nëpër shkëmbinjtë. Por ajo ka nevojë të bisedojë me mua, ajo e di se unë do ta kuptoj, megjithëse shumë gjëra mund të kenë ndryshuar.

Deti bën zhurmë dhe Madela i vërtit kujtimet mes oshëtimës.

Një ditë, në shtëpinë e tyre kishin sjellë një grua tjetër dhe sytë e kaltër të Madelës nisën të bëheshin të vëmendshëm dhe dalngadalë ta humbin butësinë. Njerëzit e shtëpisë mendonin se ajo po rritej. Gruaja që kishin sjellë ishte e qeshur, sikur në shtëpi të mos kishte ndodhur asgjë, dhe të gjithë e donin. Gjyshja i thoshte se ajo ishte një grua e mirë dhe duhej ta donte.

«Në vend të mamit ka ardhur kjo?» — e pyeti njëherë, kur mbetën vetëm.

«Po», — i tha gjyshja.

«Po mami ka vdekur?»

Gjyshja e kishte vështruar me një palë sy të butë. Ajo e kishte kuptuar se sa mund ta donte Madela gruan e mirë. Kur vinte ajo, Madela mbyllej në botën e saj ngjyrë deti e shumë të çuditshme dhe i afrohej të atit. Herë-herë ai largohej dhe Madelës nisi t'i dukej si një njeri i largët dhe u mësua pa të, me vetminë e saj.

Një ditë gruaja solli një fëmijë. Kur s'kishte njeri, Madela i afrohej dhe e vështronte, derisa vinte gruaja e mirë dhe i thoshte që ta puthte, se e kishte motër. Fëmija u rrit dhe të gjithë thoshin se ajo i ngjante shumë Madelës. Por ajo e dinte se nuk i ngjante aspak. Fëmija i kishte sytë e zinj dhe leshrat kre'l-a-krela e shumë të buta. Megjithatë, ajo e donte fëmijën dhe me kohë u mësua me të dhe me gruan e mirë, që sillej kot nëpër shtëpi, ose ndiqte programet e televizorit. Edhe njerëzit e shtëpisë u mësuan me gjendjen e Madelës dhe të gjithë e ngrinin në qiell mençurinë e saj. Gjithçka e lidhnin me faktin se ajo e kishte harruar t'ëmën.

Po njëherë, papritur, kur kishte mbetur vetëm me gjyshen, Madela e kishte pyetur.

«Përse iku mami?» — dhe e vështronte me sy këmbëngulës.

Gjyshja e kishte vështruar me habi. Pra, Madela nuk kishte harruar asgjë. Ajo nuk mund t'i shmagej pyetjes.

«Iku, — i kishte thënë. — iku, se kishte aset. Kishte aset gjithë këto të mira. Doemos, ishte mësuar në rrogözë dhe nuk i pëlqenin qilimat tanë. «Më zënë frymën», thoshte vroma».

Madela kishte vënë re se gjyshja ishte edhe e tronditur, edhe e inatosur.

«Vetëm për këtë iku?» — ngulte këmbë ajo.

«Doemos, përse tjetër? Erdhi budallaqë dhe i dhamë dhiplomë, i dhamë mend, po nuk i pëlqyen!» — Ajo kishte marrë një pamje të trishtuar. «Ç'të bësh, moj bijë. Të la bllac me mua korbën dhe as që pyeti më për ty. «Nuk e dua», — tha. Por a ka nënë të mos dojë evlatin?»

Madela e kishte vështruar qetë, por sytë e saj digjka fshihnin. Edhe ajo mendonte se nuk ka nënë të mos dojë fëmijën.

«Po si, — e pyeti ajo, — nuk ka ardhur asnjëherë të më shohë?»

Ajo kishte vënë re se gjyshe i kishte kaluar një e rreqethur e lehtë. Ajo ishte munduar ta hidhte fjalën gjetiu, po sytë e Madelës ishin shumë këmbëngulës dhe ishte detyruar të përgjigjej.

«Çoku ka ardhur ndonjëherë, — po vetëm sa për të pyetur se si je me shëndet. Ajo pyeste fqinjën, derisa pastaj iku në një qytet të largët dhe s'u pa më.»

«Po pse nuk më tregonit mua, gjyshe? A nuk duhej ta dija unë kur vinte mami të më shihte?»

Gjyshja ishte munduar ta sqaronte se ajo nuk vinte aspak që ta shihte dhe se as ajo nuk e dinte se kur vinte pikërisht, vetëm se fqinja e lajmëronte se kishte pyetur.

«Pse pyet? — i kishte thënë pastaj gjyshja. — Mos të ka zënë gjë në rrugë?»

«Jo, gjyshe, unë pyes kot, vetëm për të ditur...»

Madela u rrit pa u kuptuar fare dhe nga portreti i saj gjithnjë vështronin dy sy të vëmendshëm dhe të egër...

Deti gulçon në këmbët tona dhe herë-herë gjëmon sikur kërkon ta shkallmojë bregun e gurtë. Po

që të dy ne jemi të sigurt se ai shumë-shumë mund të na vërvitë vetëm një dush të ftohtë. Madela e vështron gjatë dhe me shumë vëmendje

— E di, Andi? — thotë befaz ajo duke u kthyer nga unë. Sytë i ka të lagur dhe çuditërisht të butë. Me siguri, nata që po pushtonte gjithçka dhe dritëzat e lëkundshme bënëin t'i dukeshin të butë. Mua nata gjithnjë më është dukur tinzare dhe mundohem vetëm të dalloj nëse sytë i ka të lagur me lot, apo me ujë të kripur. Por ata janë të butë, çuditërisht të butë, dhe më vështrojnë diku nga errësira, si ai vizioni i vajzës së vogël kur montoja në lartësitë. — Ke dëgjuar që thonë se të tërheq gjaku? Unë e njoha menjëherë nënën. . .

— Si? — thërras me habi. — Nuk e kishe parë asnjëherë gjatë gjithë kësaj kohe?

— Jo. E njoha në spital, — tregon ajo, pa e përfillur fare habinë time. — Isha në gjumë dhe ndjeva se më vështronte dikush. Kur hapa sytë, vura re një grua që më vështronte me sy të përplotur. Ndenjëm një kohë të gjatë në heshtje, duke vështruar njëra-tjetrën.

«Nuk më njeh?» — tha pastaj ajo.

«Të njoh» — i thashë.

«Madela, — tha ajo, — unë e dija se do të më njihje».

«Edhe unë e dija se do të vije». Asaj, me sa duket, i bëri përshtypje ftohtësia ime. Unë nuk ndieja asgjë për të. S'më vinte as keq as mirë. E vështroja drejt në sy si një grua fare të panjohur. Edhe ajo më vështronte. Më dukej sikur ajo kërkonte diçka tek unë. Megjithatë, unë mendimet i kisha të kthjellta, sado që gjithë ditën kisha pasur temperaturë. Gjatë gjithë kohës unë nuk kisha mundur ta takoja as-

njëherë. Vonë mësova se atë e kishin penguar të më takonte, pastaj ajo, duke qenë larg, nuk kishte më mundësi. Megjithatë, kur e kishte sjellë hera, ajo ishte përpjekur të paktën të më shihte. Kështu që ajo më mbante mend. Por unë kisha bindjen se ajo nuk më kishte dashur. Vura re se në pavion po hynin njerëzit e mi.

«E kuptoj që nuk më ke dashur, — i thashë, — po pse nuk ike nga unë që kur isha e vogël? Unë do ta kisha më lehtë».

Ajo as që u hodhi sytë njerëzve të mi që kishin qëndruar aty pranë.

«Vërtet mendon se nuk të kam dashur?»

«Unë nuk mund ta shpjegoj ndryshe një qëndrim të tillë».

«Nuk e ke kuptuar?» — pyeti ajo.

«Jo, — i thashë, — të paktën këtë nuk e kam kuptuar. E merrja me mend që jeta në shtëpinë tonë ishte ndërtuar mbi ca rregulla... dhe ti, një vajzë e drojtur dhe e mbyllur, nuk mund të mësoheshe me to».

«Më merrte frymën, — tha ajo duke u ngutur. — Unë gjithë kohën e ndjeva veten të huaj në atë shtëpi.»

«Mirë, — i thashë, të kuptoj. Po pse nuk ike që kur isha e vogël?»

Njerëzit e mi qëndronin mënjane, sikur të mos shihnin asgjë, por unë e ndieja se ata përgjonin me xhelozitë të gjitha lëvizjet e saj.

«Nuk munda ta dashuroj babanë tënd, — foli ajo me rrëmbim. — Madela, — ajo nisi të belbëzohte dhe të mundahej të gëlltiste lotët, — të vetmin gabim që kam bërë është se nuk munda ta dashuroja, nuk munda. Përse ta vuaja gjithë jetën këtë?»

Padashur m'u mbushën sytë me lot. Që kur kishte ikur ajo, unë nuk kisha qarë asnjëherë dhe kjo e bëri gjyshen të mallëkonte me zë të ulët. Lotët e asaj gruaje, lotët e nënës sime, më prekën shumë. Unë e kisha kuptuar shumë mirë nënën time. E kisha kuptuar, po desha ta dëgjoja gjithçka nga goja e saj. Kjo vërtet e mundoi, ndoshta e sfiliti, por jam e bindur se e lehtësoi. Në qoftë se e ndiente veten fajtores ndaj meje, në lotët e mi ajo pa se e kisha kuptuar...

Unë e vështroj në sy. Në të dy sytë e saj vë re diçka të butë, njerëzore dhe aspak të egër.

— Vërtet e ke kuptuar ti? — e pyes.

Unë e di që, pasi të më përgjigjet, gjithçka do të mbetet si më parë, kur e gjeta te parmakët duke vështruar detin.

— E kam kuptuar, — thotë ajo. — Në fakt, im atë në fillim u mundua të ndërtonte një jetë të gënjeshtër. Ne nuk kishim halle dhe për këtë ai ishte i bindur. Po kjo ishte një gënjeshtër, siç ishte dhe «foleja jonë moderne». Tani unë kam moshën kur ajo vendosi të ikte. Unë munda të vështroj matanë dritareve «të folesë» dhe aty pashë jetën të ziejë, ajo është si një det i gjerë, plot kaltërsi, ku shoh gjithnjë veten. Po për të nuk mund të ishte kështu. Ajo gjithnjë ishte vërtitur nëpër shtëpi pa ditur ç'të bënte, duke kaluar kohën kot dhe ndiente zbrazëtirë. Kjo nuk mund të zgjaste shumë. Ajo nisi të lëvizte, të kërkonte vendin e saj në jetën tonë të gjerë, jashtë katër mureve të folesë dhe, kur babai dhe njerëzit iu bënë pengesë, ajo nuk mundi të duronte. Dhe... iku.

— Iku duke të lënë ty, — i them unë duke e vështruar gjithnjë në sy. Sytë i ndritën duke lëshuar vezullime kaltëroshe. Butësia e tyre e përkohshme

humbi. — Përse nuk të mori dhe ty? A nuk është xy një veprim i pafalshëm?

— Andi, — thotë ajo me zë të qetë. — Unë asnjëherë nuk kam menduar të gjykoj prindët e mi. . .

Ajo hesht, kërruset mbi parmakë dhe vështron shkumën e bardhë që vjen vërdallë në sfondin e zi. Pastaj vazhdon pa e ngritur kokën.

— Megjithatë, këtë e bëra padashur. Gabimi i saj i vetëm është se nuk mundi të dashurojë babanë. Kjo do të thotë se ajo vendosi të bënte gjithçka për mua, të pranonte edhe të keqen, po nuk mundi. Dhe e gjithë kjo për shkakun tim, ndryshe ajo do të kishte ikur me kohë nga ai.

— Po pse nuk të mori me vete? — e pyes përsëri. Ajo, natyrisht, e priste këtë dhe mbeti një copë herë pa folur.

— Si të më merrte, — ajo u revoltua nga pyetja ime e përsëritur. — Askush nga prindët e saj nuk e pranonte këtë ndarje, sepse ajo ishte një grua që i kishte rënë së mirës me shqelm. Këtë ndarje askush nuk e quante një veprim të ndershëm. . .

Ajo hesht, vështron errësirën dhe hesht sikur të kërkojë të bluajë edhe njëherë ato që thotë.

— Madela, të kuptoj. . . — i them.

— Prandaj unë e kam falur, — thotë ajo me rrëmbim, duke u kthyer nga unë. — Vetëm tani ndiej të më ngrohet diçka përbrenda, e kam falur. . .

*

Në errësirë afrohen dy njerëz të zënë për krahu. Është një grua plot shëndet dhe një burrë i shkurtër.

Ata mundohen të afrohen pa u ndier, po Madela i vë re dhe pastaj kthehet nga unë.

— Do të shihemi nesër, — më thotë ajo.

— Jo, — i them unë. — Nesër do të nisemi në hidrocentral.

— Atëherë do të takohemi atje, — thotë ajo.

E vështroj me habi. Në fakt, gjatë gjithë kohës unë isha shumë i turbulluar. — Të kujtohet kur më prishje urat? — vazhdon. — Atëherë të thosha se mua më pëlqen të ndërtoj atë që u hyn në punë njerëzve. Minaretë nuk i hyjnë askujt në punë. Unë do të ndërtoj patjetër ura, Andi, ura të vërteta në kantiere të mëdha. . .

Dy njerëzit e zënë për krahu u bënë tre. Ata të dy ecin me një hap të plogët mbi guriçkat e bardha të zallit. Por unë vështroj Madelën. Ajo lëviz e zhdërvjellët, duke i bërë ballë erës së detit. Ajo lëviz me çape të gjata, të sigurta dhe më duket sikur mundohet t'u japë siguri dhe atyre të dyve nëpër mugëtirën e bregut. Pastaj ata dalin në dritë dhe humbasin midis njerëzve. Unë mbështetem përsëri në parmakë. Deti gjëmon nëpër gurë dhe vërvit cifla dallgësh, po mua më pëlqen. Ndërsa sytë e kaltër të Madelës mundohen të gërvishin mugëtirën. . .

U R A M B I G R E M I N Ë

U vendos që ura të ngrihej mbi greminë. Në fillim ishte projektuar një urë e vogël, rreth 5 metra, dhe kalonte ndanë greminës, po pastaj byroja teknologjike e ngarkoi inxhinier Idin ta ndryshonte projektin dhe ta bënte urën 25 metra të gjatë. Dhe atëherë ajo duhej të kalonte pikërisht mbi greminë. Gjithë atë ditë inxhinier Idi ndenji ndanë humnerës, duke u munduar të përfytyronte urën të ngritur, studjoi vendin ku mund të hapeshin themelet e këmbëve. Nja dhjetë metra më poshtë, gremina ndërpritej nga një tarracë natyrale dhe pastaj varej përsëri, e frikshme dhe e pafund...

«Aty do të vendosen këmbët, — tha me vete, — në pjerrësirë. Tani njerëzve do t'u duhet të punojnë mbi greminë». Ai e rrahu mendimin me brigadierin Ram Seferi dhe specialistët që do të merreshin me ndërtimin e urës.

«Është e vetmja zgjidhje», tha Ram Seferi.

Inxhinier Idi e skicoi dhe në mbrëmje vonë llogariti gjithçka, materialet, forcat që do të nevojiteshin, dhe ia paraqiti këshillit teknik për aprovim. Këshilli teknik, në qoftë se e aprovonte, e dërgonte në

Institutin e Projektimeve dhe, pas kësaj, jepte lejen e zbatimit.

Tani ai priste i emocionuar përgjigjen. Ishte inxhinier i ri dhe dukej ende sikur do të shlyente një provim të vështirë, ndaj ndiente një shqetësim të natyrshëm. Në mbledhje kishte ardhur edhe zëvendësministri, i cili ishte përfaqësues i qeverisë për hekurudhën. Natyrisht, ai nuk kishte ardhur për projektin e tij, po për disa probleme të tjera organizimi, megjithatë ai do të dëgjonte edhe çfarë do të flitej për projektin e tij. Inxhinier Idi vuri re se ai mbante në duar e vështronte me një ndjenjë kënaqësie projektin e tij. Atëherë ndjeu një emocion të pakuptueshëm. Papritur ai ngriti kokën dhe sytë e tyre u ndeshën. Përfaqësuesi i qeverisë vuri buzën në gaz:

— Ke bërë një projekt të mirë, — tha. — Sa kohë ka që ke mbaruar stazhin?

— Dy muaj, — tha inxhinier Idi.

Përfaqësuesi i qeverisë e vështrroi me një ndjenjë habie. Ai kishte shtat mesatar dhe ishte rreth të dyzetave. Me sa dukej, projekti ishte diskutuar edhe më parë dhe ishte dhënë aprovimi nga instituti, megjithëse Idi ishte një inxhinier fare i ri.

— Atëherë, — nisi drejtori i punimeve, — projekti të fillojë nga zbatimi menjëherë dhe të dërgohen materialet dhe njerëzit që nevojiten.

Inxhinier Idi pandehte se mbledhja do të zgjaste dhe u habit kur vuri re se njerëzit nisën të ngriheshin dhe të dilnin jashtë. Në fillim ai ndenji si i hutuar, po pastaj nxitoi të fliste me zë të lartë:

— Më falni, — tha, — po koha e përfundimit... a nuk duhet caktuar koha e përfundimit?

Drejtori i punimeve qëndroi në vend dhe e vështrroi në sy.

— Për sa kohë mendoni ju? — tha. — Kohën duhet ta parashikoni ju.

Inxhinier Idi mendoi se kishte bërë gabim që nuk kishte marrë brigadierin me vete.

— Në rrethana të zakonshme ura kërkon dy muaj, — tha ai, — por, meqë i jemi zotuar partisë të përfundojmë hekurudhën para afatit, mendoj se mund të ngrihet brënda 40 ditëve.

— Brenda 40 ditëve! — Drejtori i punimeve e vështroi me habi.

— Sigurisht, — tha Idi, — ky është afati minimal.

Në dhomën e vogël me mure kartoni ra një hesh-tje e gjatë. Vetëm brulëritja e druve në sobë dëgjohej dhe që larg oshëtima e Shkumbinit. Nga gremina ku do të ndërtohej ura, Shkumbini dukej si një gjarpër i stërgjatur dhe i verdhë, që zvarisej në një rrugë pa fund.

Inxhinier Idi u mundua të kuptonte se çfarë pikërisht kërkonin ata. Ai u kthye nga drejtori i punimeve.

— Ju jeni vetë inxhinier dhe e kuptoni, — tha ai. — A nuk është ky afati më i shkurtër?

Drejtori i punimeve vuri buzën në gaz.

— Dëgjo, Idi, — i tha, — vërtet ky është një afat minimal dhe, sipas leksioneve në universitet, është i pamjaftueshëm. Por duhet të dish se këtu, në hekurudhë, na është dashur të kapërcejmë shumë afate minimale, madje edhe për ura jo të zakonata. — Ai e vështroi, drejt në sy. — Mbase ende nuk ke pasur rast ta shohësh këtë, po kjo është e kuptueshme.

«Me sa duket, ky nuk e ka parë fare greminën ku do të ngrihet ura dhe nuk do të më kuptojë», — mendoi Idi me një inat të përmbajtur.

Atij i vinte shumë inat kur e trajtonin si filles-

tar. Ky mendim e mundonte gjithnjë, megjithëse ai kishte punuar në disa ura dhe kishte marrë një diplomë me motivacionin «i dalluar».

«Kur s'e mora brigadierin, — mendoj. — Ai do t'i jepte një mësim të mirë.»

Ram Seferi me brigadën e tij të specialistëve kishte pasur rast të ndërtonte qindra ura dhe vepra arti në hekurudhë dhe gëzonte një respekt dhe besim të madh në të gjithë kantierin. Ai e dinte mirë se kujt i thoshin vështirësi, sepse i kishte provuar në shpatulla dhe me siguri do ta kuptonte se afati i caktuar prej tij ishte më i shkurtër. Ai nuk e përfillte fare kohën dhe mund të përcaktonte me saktësi se sa ditë nevojiteshin për ndërtimin e një ure.

— Unë ju kuptoj, drejtor, — tha inxhinier Idi. — Po duhet të dini se ajo urë tani kalon mbi greminë dhe nuk është më vetëm 5 metra. Kjo e vështirëson punën, sepse nuk ka front, nuk mund të futësh njëkohësisht shumë njerëz.

— Por, — tha drejtori i punimeve, — ju e paskeni harruar fare kohën e përfundimit të hekurudhës. Ju e dini se që të thahet betoni, kërkon plot një muaj, bëhen kështu dy muaj e gjysmë. Ndërsa, të them të drejtën, ne mendojmë se ju do ta ndërtoni në afatin e mëparshëm.

— Brenda dy javëve?! — Idi pothuajse thirri nga habia.

— Pikërisht.

— Po kjo është e pamundur!...

Në dhomën e vogël, midis atyre pak njerëzve që kishin mbetur, u vendos një heshtje e thellë. Inxhinier Idi ndiente vështrimet e të gjithëve dhe me siguri, po të ngrinte kokën, do të përplasej në sytë e tyre. Ai nuk mund ta merrte me mend se çfarë

shprehnin sytë e tyre. Ai nuk e ngriti kokën fare. Një mendim kryeneç e bëri të inatosej, të rrëmbente skicat dhe të dilte me rrëmbim jashtë.

«Ta kisha brigadierin», — tha me vetë duke ndier pas shpatullave derën që u përplas me forcë. Papritur qëndroi dhe mendoi se nuk bëri mirë që përplasi derën. Në përgjithësi, të gjithë kuadrot e reja zemërohen dhe inatosen vetëm e vetëm ngaqë u krijohet mendimi se nuk i kuptojnë dhe i trajtojnë me mosbesim. Në këtë rast, ata kishin treguar një besim të tepruar. Por, megjithatë, a nuk duhej të kuptonin se ishte e pamundur të ngrihej një urë betoni 25 metra e gjatë mbi greminë dhe brenda dy javëve?

Idi ndjeu një dorë të lehtë që iu mbështet në sup, dhe ktheu kokën.

— Oh, më falni, — tha me mirësjellje, — nuk ju vura re,

Përfaqësuesi i qeverisë e vështroi ngrohtë. Ata nisën të lëviznin përkrah njëri-tjetrit nëpër sektor. Ai i tha:

— Përse rrëmbehesh, Ideal? Këtu është fjala vetëm për ta parë punën në qetësi dhe për të përcaktuar mirë se ç'duhet bërë.

— Nuk rrëmbehem shoku zëvendësministër, — tha ai, — por ky është një absurditet.

— Jo, nuk mund të jetë absurditet. Ti je i ri dhe ende nuk ke arritur ta kuptosh praktikisht këtë. — Ai e vështroi ngrohtë dhe Idi padashur vuri re se sytë e tij shprehnin diçka njerëzore dhe të sinqertë. — Po, sidoqoftë, bisedo me specialistët e Ram Seferin, — vazhdoi ai, — ata me siguri do të arrijnë në ndonjë përfundim.

«Bëra gabim që nuk e mora brigadierin me vetë, — mendoi përsëri Idi. — Ta dija kështu, nuk do të

vija pa marrë brigadierin me vete». Pastaj me zë shtoi: — Duhej të kishte ardhur edhe ai. Ai me siguri do t'ju bindte.

— Ai nuk do të fliste fare, — tha përfaqësuesi i qeverisë duke qeshur lehtë. — Ai nuk thotë asnjë fjalë pa e pasur brigadën aty.

— Kjo është e vërtetë, ta hajë dreqi! — tha Idi duke vënë edhe ai buzën në gaz nga përfytyrimi i brigadierit. — Po si mund të zgjidhet kjo punë?

— Ideal, — i tha përfaqësuesi i qeverisë dhe Idi përsëri vuri re në sytë e tij atë pamjen njerëzore e të sigurtë që të bënte për vete. Nuk duhet menduar se si mund të zgjidhet, po si duhet të zgjidhet, më kupton? E sa gjëra na është dashur të zgjidhim kështu! Pandeh se pak gjëra na është dashur të zgjidhim në kohë rekord? Ndërtimi i socializmit nuk ka kohë për të humbur, Ideal, dhe fjala ka qenë për hidrocentrale, e kombinatë gjigande dhe jo për një urë. Por, ama, kur e zgjidh në këtë pamje qoftë edhe problemin e një ure në kohë jo të zakonit, atëherë ke zgjidhur edhe të gjithë veprën. A nuk është kështu?

Inxhinier Idi nuk mundi ta duronte vështrimin e tij të butë, të afërt dhe uli kokën. Megjithatë, ai thellë në vetvete nuk e ndiente veten të bindur, prandaj mendoi se duhej të sillte brigadierin që të merrte vesh me ta. Ai mori cigaren që i zgjati përfaqësuesi i qeverisë dhe, si e ndezën, u ndanë.

*

Idi u ngjiti në lartësinë e trasesë për në grëminën ku do të ngrihej ura. Kapërceu një tunel nja 200 metra të gjatë dhe doli në një lartësi të frikshme. Aty

bënte ftohtë dhe frynte një erë e hidhur që i futej në të gjitha qelizat, por as që e kishte mendjen tek ajo. Ai vështronte trasenë. Që nga Librazhdi e deri në Prrenjas ai e kishte bredhur më këmbë dhe gjithnjë e kishte përfshirë një përfytyrim i çuditshëm. Ajo ishte një hekurudhë e bukur, që kalonte nëpër lartësi të habitshme, mbi mure, ura, viadukte dhe mes për mes maleve. Kohë më vonë do të tregoheshin shumë legjenda për ndërtimin e saj dhe ai nganjëherë e përfytyronte veten personazh të legjendave të së ardhmes. Në atë hekurudhë ishte gërshetuar forca e vullneti i rinisë dhe mendimi e aftësia krijuese e specialistëve. Ajo ishte një vepër e ndërtuesve të socializmit dhe udhëtarët do të kishin rast të udhëtonin nëpër një pamje mahnitëse.

Idi ecte nëpër trase, duke mbajtur vështrimin në pejzazhet e rralla që hapeshin në të gjithë pamjen. Ai ndjeu pikëla të ftohta shiu, po kur vuri re gozhupin, kuptoi se kishte nisur të binte dëborë.

«Thonë se, kur bie dëborë, këtu krijohet një pamje fantastike dhe e pabesueshme, — tha me vete, — po dëborë do të na prishë punë» — Atë nisën ta përfshinin përsëri mendime të shqetësuara për urën që do të ndërtonin mbi greminë. Pastaj mendimet i ngatroheshin larg, në ngjarje të tjera të hekurudhës dhe në sytë e tij ngjyrë hiri zinte vend pamja e inatosur e brigadierit.

«Po ti, tutkun je, që nuk i sqarove dot? — do t'i thoshte me siguri ai. — Tutkun je, ë? Përse e kishe gojën, apo për të na shitur mend neve këtu?»

Ai ndjeu të rrëqethura. Brigadierit e donte shumë dhe gjithnjë i thoshte se do të bëhej një inxhinier i mirë.

«Ti nuk je një inxhinier i llastuar, — i thoshte

ai, — por edhe kur llastohesh, ty të ka lezet, ta hajë dreqi!» Ai e vështronte ngrohtë. «Fundja, përse të mos llastohemi, kur fati na ka caktuar në vepra të mëdha të partisë. A nuk kemi të drejtë t'i përkëdhelemi një nëne, hë, fol?»

«Unë s'kam ç'të them, brigadier, — i thoshte ai, — ti fol».

Fytyra e brigadierit e rrahur nga erërat zuri vend për një kohë të gjatë në mendimin e tij pa fill e pa fund. Ç'do t'i thoshte atij, ë? Inxhinier Idit iu kujtua ura e Bushtricës. Ajo ishte një urë madhështore, 300 metra e gjatë dhe 50 e lartë, ishte e bukur, e fuqishme dhe lidhte dy male, të cilëve përroi i Bushtricës u binte mes për mes. Shumë kohë ajo urë do të shërbente si një pikë turistike madje edhe për vetë ndërtuesit e saj. Në fillim mendimi për të ndër-tuar një urë të tillë dukej si një fantazi e sëmurë, pastaj nisi të merre formë konkrete dhe më pas brigadat e specialistëve dhe vullnetarëve i kapërcyen të gjithë kufijtë e fantazisë dhe bënë çudira. Ata thyen konceptin se specialistët shqiptarë nuk janë në gjendje të ndërtojnë ura gjigande. Dhe në ndërtimin e saj u duk fare qartë forca e rinisë vullnetare e shkrirë në aftësinë dhe guximin e specialistëve shqiptarë. Dhe ura vështronte poshtë xhadenë, nëpër të cilën lëviznin makina që transportonin hekur.

«Po, ura ime, — tha ai me vete, duke përfytyruar urën mbi greminë, — me siguri do të ndërtohet, po jo brenda dy javëve, kjo vërtet është e pamundur».

Ai kapërceu edhe një tunel tjetër dhe, kur doli, vuri re se dëborra i kishte zmadhuar cuflat dhe binte me rrëmbim.

«Është shumë e bukur, po do të na prishë punë»,

— tha me vete duke vështruar greminën, ku do të ngrihej ura. Ajo ishte vetëm disa metra larg, e ngushtë, e frikshme, e thellë dhe ai vuri re se njerëzit kishin nisur punën. Kishin sjellë shumë vullnetarë dhe me sa dukej brigadieri u kishte caktuar frontin e punës. Ata kishin nisur një punë të vrullshme dhe nën cufilat e dëborës dukeshin si qenie të çuditshme që vallëzonin në bardhësi. . .

Inxhinier Idi kishte qëndruar në këmbë mbi greminë dhe vështronte vullnetarët, ndërsa brigadieri thithte në heshtje cigaren. Ai ia tregoi të gjitha dhe pikërisht, siç tha përfaqësuesi i qeverisë, brigadieri nuk foli fare.

— Si mendon ti, brigadier, — foli inxhinier Idi, i inatosur nga heshtja e tij e padurueshme. — A mund të ndërtohet ura brenda dy javësh?

Ai vështroi greminën dhe ndjeu frikë. Vërtet, ashtu e zbrazët ajo dukej e frikshme dhe të bënte të mendoje se puna ishte e pamundur ose në fund të fundit shumë e vështirë, që kërkonte guxim dhe kujdes.

— Hë, pra, brigadier?

Ram Seferi rrudhi turinjte dhe i hodhi një vështrim sikur t'i vinte keq.

— Hë, pra, brigadier?

Ram Seferi hodhi bishtin e cigares me nervozizëm.

— Ç'të shoh, mor veshllapush — i ulëriu papritur, — ç'të shoh? — Tjetri u spraps i habitur. — Mos duhet të nis tani t'i lutem përfaqësuesit të qeve-

risë që të zgjatë afatin, ë? Po kjo është fare e lehtë. Ta bëjmë hekurudhën për dhjetë vjet, shoku përfaqësues i qeverisë, Kombinatit Metalurgjik le të furnizohet me qerre sa të mbarojnë Ram Seferi dhe inxhinier Ideali urën.

— Brigadier, por... — inxhinier Idi kishte marrë një pamje shumë të drojtur dhe nuk po kuptonte se ç'po ndodhte. — Unë s'po them...

— Çfarë s'po thua, more?! — Brigadieri vërtet dukej i inatosur. — Ç'të thuash ende. A e kupton se duhet, e di ti ç'do të thotë duhet, apo jo? Po ti na qenke bebe, inxhinier! — Ai e zuri nga jaka e gozhupit dhe, kur vuri re se Idi kishte marrë një pamje për të ardhur keq, u zbut papritur:

— Unë dua, brigadier, — tha më në fund ai i tronditur, — po më duket e pamundur.

— Eh, mirë, — tha Ram Seferi pothuaj i zbutur. — Mos do të nisësh nga të qarat tani? Duhet menduar se ç'mund të bëjmë. Në radhë të parë duhet hapur front pune për të gjithë.

Mbi greminë ishte mbledhur e gjithë brigada. Ata e kishin vënë re që larg shpërthimin e brigadierit, por as që e kishin marrë seriozisht, sepse ishin mësuar me të. Kur mendonte për ndonjë rrugë zgjidhjeje, ai inatosej dhe i gëmushej atij që kishte më afër, pastaj, papritur zbutej, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ishte pasdite dhe vullnetarët sapa kishin marrë turnin. Megjithatë, ata i kishin bërë të gjitha punët që u kishin caktuar dhe tani rrinin kot. Brigadieri thirri komandantin e tyre. Ai ishte një djalë fare i ri, por i shëndetshëm dhe i fortë.

— Dëgjo, — i tha, — tani ju nuk keni ndonjë punë. A mund të vini në turnin e tretë?

— Natën?! — pyeti vullnetari duke shfaqur një ndjenjë habie.

— Sigurisht natën, pse, ç'pandehe zotrote?

— Mirë xhanëm, tha vullnetari, — por. . . të pyes shokët.

Ai nxitoi të pyeste shokët dhe pas pak vullnetarët u përgjigjën si me brohorimë se ishin gati të vinin kur ta donte puna. Pastaj ata u vunë në rresht dhe nisën të lëviznin nëpër vallen e shfrenuar të pufkëzave të dëborës. . .

Mbi greminë nisi një bisedë e gjatë. Specialistët kishin filluar të zbardheshin nga dëbora, po megjithatë nuk kishin ndër mend të largoheshin nga bregu i lartë, në të cilin do të betonohej shpatulla e urës. Inxhinier Idi e ndoqi bisedën në heshtje, pa mundur të përqëndrohej në të gjitha mendimet që shfaqnin ata, dhe priste se ç'do të thoshte brigadieri. Edhe ai dukej i menduar. Ndërsa të tjerët flisnin, ai hetonte me sy çdo pjesë të greminës, llogariste me intuitë qëndrueshmërinë e shkëmbinjve, shkarjet dhe gjithçka që mund të shërbente si vend për të qëndruar njerëzit. Vështronte bregun tjetër. Në atë anë dukej hyrja e një tuneli, ajo ishte shtruar me shina dhe traseja zgjatej deri larg mes për mes maleve. Ndërsa aty pranë gremina ndante trasenë si një hendek i thellë dhe i pakapërcyeshëm. Ai i dëgjonte njerëzit pa i ndarë sytë nga gremina. Njerëzit flisnin, grindeshin, ata donin medoemos t'i lidhnin ato dy brigje në një kohë fare të shkurtër.

Dhe ndodhi fare papritur, atëherë kur inxhinieri e kishte humbur durimin. Për herë të parë ai pati rast të ndeshej ballë për ballë me aftësinë krijuese, diktuar nga përvoja e gjatë, të njeriut të thjeshtë ndërtues. Dhe ai mendoi se njerëz të tillë janë në

gjendje të kuptojnë dhe të dalin nga situatat e vësh-tira me një pjekuri dhe guxim jo të zakon të.

— Mua më duket se ka një zgjidhje, — tha më në fund Ram Seferi, pa i hequr sytë nga gremina. Ai fliste sikur të ndodhej në një moment solemn dhe shumë të rëndësishëm. — Këtu është fjala vetëm për të fituar kohë dhe front pune. (Inxhinier Idi dhe të tjerët po e dëgjonin me kujdes). — Sikur të hapim front pune për shumë njerëz, atëherë fitojmë edhe kohë.

— Vetëm kjo na duhet, brigadier, — tha Idi, — dhe pikërisht kjo është e pamundur.

— Mos u ngut, more djalë, — tha Ram Seferi me qortim dhe vazhdoi: — Po të vihet re me kujdes gremina, ne kemi mundësi ta nisim nga skela e traut, pastaj fillojmë punimet e karpentierisë pa u betonuar shpatulla. . .

— Po kjo, — u hodh Idi, i habitur, — kjo është tamam sikur ta ndërtosh shtëpinë duke u nisur drejt-përdrejt nga çatia dhe themelet?!... A mund të ndërtohet shtëpia kështu?

— Mos u ngut, more djalë, — tha prapë Ram Seferi me një bezdi të hapur. — Në këtë rast duhet të ndërtohet kështu. Ne njëkohësisht, gjatë betonimit të shpatullave, do të ndërtojmë edhe kallëpin e traut dhe do të vendosim hekurat. . .

— Brigadier, por. . .

Brigadieri as që ia hodhi sytë, por u ngul mbi greminë si një pilotë betoni. Në fillim njerëzit qëndruan të heshtur, sikur të bluanin në mend ato që kishte thënë brigadieri. Ajo ishte një heshtje e gjatë, që qëndroi pezull gjithë atë ditë, derisa mbi greminë nisi të trokiste mesnata. Pastaj. . . Brigada e vullnetarëve (ata e kishin harruar fare brigadën e vullnetarëve)

rëve) u duk sikur mbiu papritur, në fillim u dëgjua kënga dhe pastaj u dukën njerëzit që ngjiteshin në shpatin e thepisur dhe të mbuluar me dëborë. Më vonë nisi një lëvizje e vrullshme njerëzish dhe mjetesh. Trokitjet e sqeparëve dhe kënga e rinisë çirrite mesnatën me një forcë të habitshme duke e futur inxhinier Idin në një botë të çuditshme pothuaj fantastike. . .

Netët nisën të vinin të lagura dhe herë-herë të mbuluara me dëborë. Inxhinieri i ri nisi të jetonte me të gjitha qelizat forcën dhe vullnetin e madh të njeriut të thjeshtë, ndërtuesit të paepur, besimin dhe guximin për të bërë të pamundurën, kur duhej bërë një gjë e tillë. Poshtë, në rrugën e gjatë, dritat e makinave zhbironin errësirën dhe në ato net ai ndiente më fort se kurrë frymëmarrjen ritmike të atdheut socialist.

Njerëzit punonin pa ndërprerje ditë e natë, sipas propozimit të brigadierit Ram Seferi. Vullnetarët kishin nisur në fillim ndërtimin e skelës së traut, domethënë «çatinë» sipas fjalëve të inxhinier Idit. Në të dy anët e greminës të rinjtë, djem e vajza, vullnetarë, mbartnin materiale ndërtimi. Koha nuk priste dhe puna lëvizte edhe ditën edhe natën. Ende nuk ishte hapur fronti i punës për të gjithë, ndaj punonin me tri turne.

Dhe mbi greminën e ftohtë, netve apo mëngjesëve, kënga e vullnetarëve të rinisë nisi të shoqërohej me trokitjet ritmike të çekanëve dhe sqeparëve. Pa u përfunduar ende skela e traut, poshtë greminës, aty ku toka arrinte pjerrësinë më të lehtë, brigadieri hapi frontin tjetër. Nisën punimet e karpentierisë. Vetëm në disa ditë gremina arriti të mbushej me skela dhe armatura, ku do të derdhej betoni.

Ndërsa inxhinier Idi vëzhgonte gjithçka me kujdes dhe nganjëherë mes për mes errësirës së bardhë, i dukej sikur vështronte sytë e butë dhe njerëzore të përfaqësuesit të qeverisë.

«Shko tek ata, Ideal, ata me siguri do të gjejnë ndonjë rrugë».

Mbi greminë ishte vendosur armatura e një ure. Ajo urë lidhte dy brigje dhe ca kohë më parë as i kishte shkuar ndokujt ndër mend se do të lidhej ajo copë mali e ndarë nga një greminë. Dhe traseja zgjatej e zgjatej nëpër lartësitë e mureve dhe urave, e qëndrueshme, e bukur, në një bardhësi mahnitëse. Treni do të shkiste me shpejtësi nëpër shina duke transportuar hekur dhe furnaltat do të lëshonin një uturimë të përjetshme.

Vetëm një javë dhe ura ishte bërë gati për t'u betonuar...

Idi iu afrua Ram Seferit, të cilit s'ia bënte tër syri as nga dëborat dhe as nga errësira. Ishte fjala për të fituar kohë në ndërtimin e një vepre të popullit, të partisë.

— Ram, — i tha ai papritur, i mbushur me një ndjenjë të çuditshme.

Ram Seferi gjatë gjithë atyre ditëve kishte punuar në të tri turnet bashkë duke fjetur një herë në dy ditë, vetëm disa orë. Ai ishte hequr dhe dukej i lodhur.

Me përvojën e tij të madhe në ndërtimin e urave, kishte bërë një shpërndarje të atillë të vullnetarëve, që të mos mbetej askush pa punë, po të gjithë të kryenin diçka, të gjithë ta ndienin thellë përgjegjësinë e asaj që bënin...

— Ti je një brigadier specialist i përkryer, — i tha ai. — Ti je një njeri i mrekullueshëm, Ram...

Ram Seferi nuk foli. Mbase ai e kuptoi gjendjen shpirtërore të inxhinierit të ri.

— Tani, inxhinier, — i tha, — na duhen edhe disa ditë për t'u derdhur betoni. Kjo punë i do a s'i do pesë ditë. Pra, urën tënde ne e ngritëm vetëm në dymbëdhjetë ditë.

Inxhinier Idi mendoi se brigadieri nuk e kishte kuptuar dot gjendjen e tij shpirtërore, ose as që e hante merakun se ç'ndiente ai atë çast. Mbi greminë kishin nisur të uturinin betonierat dhe vullnetarët e rinisë kishin nisur të derdhnin me vrull betonin. Brigadieri me sa dukej kishte urdhëruar betonimin. Poshhtë, në këmbët e urës, ai vuri re njerëz dhe përfaqësuesin e qeverisë me të edhe drejtorin që i përgëzonin për punën e tyre të bukur në një kohë të pabesueshme. Ndërsa dëbora binte mbi greminën e thellë...

«ÇAKMAKU I BARDHË»

Mbi rrugën me çakëll qëndronte pezull dielli i nxehtë dhe njerëzit e pakët që punonin në të dy anët e saj ishin ulur në lokalin e vetëm të atyre anëve dhe pinin dhallë të ftohtë. Disa hapa larg lokalit rruga ndahet më dysh; njëra të shpie larg në qytet, kurse tjetra në fshatin e bukur EK. Fshati EK është gjithë pyje dhe verës në të vijnë të pushojnë edhe ata që janë larguar prej kohësh, po që nuk i kanë harruar bukuritë e rralla të atyre anëve. EK është shumë afër kufirit dhe njerëzit e njohin menjëherë atë që vjen për herë të parë. Rruga për atje nuk është dhe aq e gjatë dhe nga lokali fshati duket si në pëllëmbë të dorës.

Në lokal kishte qetësi dhe banakieri, një burrë i trashë dhe tullac, luante domino me nja tre katër klientë. Ai as që e prishi terezinë kur hyri një njeri i veshur mirë me një cigare «me tapë» në gojë. Klienti ndezi cigaren me një çakmak të bardhë dhe i tha banakierit nëse mund t'i jepte ndonjë gjë të ftohtë për të pirë.

— Dhallë, — i tha me nervozizëm banakieri, duke lëshuar gurët në tryezë. — Ku ia pret mendja tjetrit se do të vijë një klient në mes të vapës.

Klienti e vështroi sikur të ishte fajtor që po ia linte lojën në mes.

— Na u prish makina nja një çerek ore që këtej, — i tha sikur të shfajësohej. — Unë vdiqa për të pirë ndonjë gjë dhe erdha.

Banakieri e vështroi me vëmendje, sikur të mos i besonte, po klienti mori krikllën e dhallës dhe u ul pranë atyre që luanin. I dhënë pas lojës, ai harronte të thithte cigaren; ajo i shuhej dhe, kur kujtohej, e ndizte me çakmakun e tij të bardhë.

Disa hapa larg lokalit, pikërisht aty ku ndahe-shin rrugët, qëndroi një «Gaz» i ri. Brenda ishin: një burrë pakës i thinjur, një vajzë dhe shoferi. Shoferi zbriti dhe u fut në lokal.

— Të erdhi makina, — i tha banakieri klientit me çakmak, sikur të donte ta hiqte qafe.

— Jo, — i tha ai, — këta janë udhëtarë që shkojnë në L. Banakieri iu afrua shoferit dhe e pyeti se ç'donte.

— Ndonjë gjë të ftohtë për të pirë, — i tha edhe ai.

— Vetëm dhallë kemi, — i tha banakieri. — Dhallë të ftohtë në ujin tonë të bekuar.

Shoferi mori tri kriklla dhe ua shpuri atyre në makinë. Vajza e pyeti se ç'ishte.

— Kjo është dhallë e ftohur në ujin e bekuar të banakierit, — tha shoferi.

Të tre nisën të pinin dhallën e ftohtë. Shoferi me zë të ulët tha:

— Ja ku është EK. — Ai hodhi vështrimin në drejtim të fshatit dhe pastaj u kthye nga të tjerët. — Në EK mund të kalosh pushime të bukura, po, natyrisht, vetëm duke u shoqëruar me një njeri si Bekim K.

— Bekimi është shumë simpatik, — tha vajza, — dhe shumë i ndershëm.

— Urime Jola, — tha burri i sediljes së prapme.

— Ka dhe një grua të mirë, — tha shoferi, — po me atë grindet shumë dhe ajo nuk e kupton. — Shoferi vështrroi vajzën në sy. — Ai ka nevojë për një jetë të bukur, me punë jo shumë të lodhshme dhe për dashuri. Miku im, Bekimi, është me kulturë dhe shumë i ndjeshëm, po gruaja e emancipuar kërkon t'i bësh gjellët dhe t'i hekurosësh reçipetat dhe, doemos, të durosh edhe të sharat në kolektiv. Bekimit i ka ardhur shpirti në majë të hundës me këto gjëra. Ai ka nevojë për një vajzë të bukur dhe me ndjenja, që ta dojë fort dhe pa shumë pretendime. Ai ka nevojë për ajër, për të jetuar si njeri, më kupton, Jola?

— Të kuptoj, — i tha vajza.

— Atëherë gëzuar, — tha shoferi duke i gjetur fundin gotës. — Na duhet të vazhdojmë udhëtimin për në L. — Ai u kthye përsëri nga fshati dhe foli pa e kthyer kokën. — Do të kemi kohë të studjojmë bukuritë e EK, kur të vijmë me pushime, ashtu si dy vjet më parë, kur erdha me mikun tim Bekimin. Tani më jepni gotat e atij banakierit teveqel.

— Leo, — i tha burri i sediles së prapme, — shih se mos lëmë ndonjë dyshim.

— Është vetëm një tifos dominoje, — tha shoferi. — Me sa duket, fshatar i qytetëruar i këtyre anëve. Askujt nuk i shkon ndër mend se përse kemi ardhur ne këtu.

Kur shoferi po futej në makinë, ata që luanin domino u zgjatën në dritare dhe klienti «fshatar i qytetëruar» pati kohë të ndizte mbi kokat e tyre

cigaren që i ishte shuar përsëri. Në lokal u vendos gjendja e parë. Banakieri nisi të luante përsëri domino. Klienti pagoi paratë dhe i tha banakierit se po ikte. Ai doli në rrugë dhe eci në drejtim të kundërt me makinën, pa e kthyer kokën pas, me një çap rondokop dhe të lodhur.

Ishte pranverë, megjithatë dielli digjte dhe rëndonte mbi rrugën me çakëll.

1.

Kur doli jashtë, qielli ishte hapur. Yjet dukeshin sikur qenë larë dhe ndrinin më fort. Gjithë atë pasdite kishte rënë një shi i rrëmbyer dhe Bekim K. kishte qëndruar në dritare, duke vështruar flluskat e ujit që formoheshin në pellgjet ndanë rrugës. Ai kishte ndenjur vetëm me një tufë mendimesh të ngatërruara. Jola pinte konjak në kanape dhe ai ndiente vështrimin e saj. Ai ende nuk po e kuptonte si kishte arritur të fitonte miqësinë e Jolës, dhe të pritej në apartamentin e saj si një njeri shumë i dashur. Leoni, shoferi, e kishte njohur me të në «Flora». Ajo ishte vajza e tezes së tij po e kishte tamam si motër. Ai i kishte thënë: «Jola është ca e përkëdhelur, po ka aq kulturë, sa, megjithëse nganjëherë ta bie në majë të hundës me ato mendimet e saj të coroditura, mua më pëlqen të rri me të».

— Gjithsecili ka mendimet e tij, — kishte thënë Bekimi, — po më të pranueshmet janë ato që i përkasin jetës së bukur.

— Punë dreqi, — kishte thënë Leoni, — kam frikë se do të bëhemi dy kundër njërit.

— Do të jetë fat i madh, — kishte ndërhyrë

vajza. — Ti kë një kokë, të cilën vetëm e kam vësh-tirë ta thyej.

Jashtë nata ishte e freskët. Megjithatë, Bekimit nuk iu kthjelluan mendimet.

Atyre iu bë e zakonshme të dilnin të tre dhe të pinin verë të kuqe në lokalin e Pallatit të Kulturës.

«I vetmi lokal ku mund ta ndiesh veten ca mi-rë, — kishte thënë Jola, — megjithëse, sikur të mos kesh stomak të fortë, mund të helmohesh me këto meze bajate.

Leoni gjithnjë i ishte dukur një shofer i çudit-shëm. Në fillim Bekimin e kishte tërhequr pamja e tij e çiltër, pastaj kultura e tij. Ai ishte shumë i edukuar dhe dinte të sillej mirë. Megjithëse ishte rreth të dyzetave, të linte përshtypjen e një tridhje-tëvjeçari.

Pastaj ata e kishin ftuar në shtëpi. Ai ishte një apartament i mobiluar mirë, sipas modës së fundit, ku mund të pije konjak me çokollata dhe amareta.

Kur u fut në apartamentin e tyre, Bekimi men-doi:

«Njerëz që dinë të jetojnë».

Dhe iu bë e zakonshme të futej në apartamen-tin e tyre. Nganjëherë ata ktheheshin vonë. Ai ndien-te vështrimin e saj dhe rrëqethej. A e dinte ajo se ai ishte i martuar dhe me fëmijë? Ajo natyrisht nuk e dinte dhe, kur ia tha me marifet, vuri re se ajo u drodh. Bekimi mendoi se do të shuhej gjithçka e bukur që kishte nisur të lindte midis tyre, dhe ndjeu zbrazëti. Ai kuptoi se vajza kishte zënë vend në të gjithë genien e tij.

Ajo e vështroi. Atij iu duk sikur u krodh papri-tur në një det të thellë dhe të kaltër, në një det shu-

më të trishtuar. Sytë e saj ishin vërtet të trishtuar dhe ai ndjeu se i donte shumë.

Ishte fund jave dhe binte shi. Leoni e solli me «Gaz» dhe ata e gjetën Jolën mbi kanape duke lexuar.

— Ç'lexon? — e pyeti ai.

«Pjesëmarrës në vrasje» të Xhuda Uotënit. Është shumë i mirë. — Ajo tregoi kopertinën e librit. Ka diçka moderne dhe të bukur.

— E, moj, e, — tha Leoni, — lexon ndonjë gjë dhe merr kot.

— Mbrëmë pashë një program në televizor, — tha ajo pa ia varur fare. — Të duket fantastike jeta që bëhet atje.

Jashtë shiu qëmtonte ngadalë, si të ishte vjesh-të. Leoni mbushi një gotë me konjak dhe e ktheu me një frymë. Pastaj tha:

— Do të iki të marr Vasin, — e u drejtua nga Bekimi. — I thashë se do ta njihja me ty.

— Kush është? — pyeti Bekimi.

— Një mjek, — tha Jola me një notë mospër-filljeje.

— Kam frikë se do të grindemi, — tha Bekimi. — Unë nuk shkoj mirë me mjekët.

— Edhe ai nuk i honeps mjekët, — tha Leoni. — Kështu që do të shkoni mirë.

Hyri e ëma e Jolës. Ajo ishte një grua e vjetër, e shëndoshë; si i dha dorën Bekimit, puthi të nipin në faqe. Ai e pyeti se si e kishte mëlçinë.

— Sikur t'ia jepje njëherë Vasit përgjigjen e analizave, — i tha ajo. — Nuk e ndiej veten dhe aq mirë.

— Me siguri e ke nga koha, — i tha Leoni. —

Është krejt e paqëndrueshme. Megjithatë, Vasin do ta sjell këtu dhe mund të bisedosh vetë me të.

Ai tha se nuk do të vonohej dhe doli. Tezja e përcolli deri te dera duke e porositur për ca gjëra, dhe nuk u kthye më në dhomë. Ata të dy ndenjën një copë herë vetëm në heshtje, pastaj ajo u ngrit dhe mbushi dy gota me konjak.

— Më jep një cigare, — i tha me zë të butë.

Ai i dha një cigare dhe, kur ia ndezi, i preku lehtë gishtërinjtë. Ajo ngriti kokën ngadalë dhe e futi atë në vështrimin e saj të turbullt. Ai e puthi dhe i tha:

— Më ke futur në një det të thellë dhe unë nuk dal dot...

— Edhe ti, — i tha ajo me zë të butë dhe të nxituar. — Edhe ti...

Ai hodhi në qafë krahët e rëndë dhe nisi ta puthte ku mundte. Në kuzhinë u dëgjuan lëvizje dhe ata morën gotat e konjakut e shkuan në dritaren e hapur.

— Ti mund të pandehësh se jam një vajzë e keqe, — i tha ajo.

— Jo, — tha Bekimi.

— Megjithatë ti mund të pandehësh, — i tha ajo. — Një vajzë e mirë nuk mund të dojë një burrë të martuar.

— Ti je e mirë, — i tha Bekimi.

— Unë të dua, — tha ajo.

Ajo piu një gllënkë konjak dhe pastaj i tha me zë të butë dhe pakëz të ngjirur:

— Unë nuk dua kurrë që ti të prishësh familjen. Po të më duash, mos u grind asnjëherë me gruan.

Ai e vështroi thellë, e vështroi në sytë e saj të trishtuar dhe ndjeu të mbushej me gjak, ndjeu

se diçka e re po lindte në jetën e tij monotone, të mbushur me punë të lodhshme. Ai mendoi të shoqen. Ajo ishte një grua e mirë, të cilën fati po e dënonte në dashuri. Bekimi e kishte dashur shumë atë dhe asnjëherë nuk kishte menduar se midis tyre do të futej një tjetër. Megjithatë, koha do të bënte të sajën. Ai nuk kishte mundur të gjente kënaqësi dhe gjithçka i ishte bërë e mërzitshme. Ai kishte nevojë për një njeri që t'i kuptonte brengat e zemrës, po kjo nuk ishte një gjë e lehtë. Sepse në fakt ai asnjëherë nuk kishte qenë në gjendje të kuptonte me saktësi se cilat ishin pikërisht brengat e zemrës.

Vajza i qëndronte pranë dhe ai e kishte kuptuar se ishte e mirë dhe nuk donte t'i prishte familjen. Ai duhej të ruhej shumë që të mos binte në sy, sepse ndryshe shefi do t'i thoshte:

«Ne, më kupton, nuk mund të mbajmë në punë njerëz që nuk mendojnë për familjen». Dhe me siguri do ta shpinin «për edukim» si Ferikun.

Vajza pinte cigare dhe ai i vështronte profilin me kurorën e verdhë të flokëve, që i shpupuriseshin nga era e lehtë e mbrëmjes. Papritur u hap dera dhe në dhomë hyri një burrë i thinjur, që ai nuk e njohte. Ishte Vasi dhe Bekimi më tepër e mori për kasap sesa për mjek. Por ai shpejt i hyri në zemër Bekimit dhe menjëherë u krijua një shoqëri shumë e këndshme. Bekim K. gjithë atë natë e ndjeu veten shumë të turbulluar.

Kur doli jashtë, nuk binte më shi dhe ai u end ca kohë rrugëve, i humbur i tëri në mendimet e tij të ngatërruara...

Mjeku ndenji për darkë në shtëpinë e Jolës. Darkën ua servirën në dhomë, dhe ata hanin duke e shoqëruar me verë të ftohur në akull. Ata kishin mbetur të tre vetëm dhe bisedonin me zë të ulët.

— Me sa vura re, punët shkojnë mirë, — tha mjeku, — urime Jola! Ai ka rënë në dashuri me ty.

— Ai është një njeri shumë i çiltër, — tha Jola, — por nuk e di a do të sakrifikojë gjithçka për dashurinë e tij.

— Ti duhet të bësh që ai të sakrifikojë gjithçka, Jola, — tha Leoni.

Vajza vuri buzën në gaz dhe vështroi kushërin me koketëri.

— E di që dhe unë kam filluar ta dua?...

— Ti nuk duhet ta duash, Jola, — tha Leoni. — Ti duhet vetëm ta bësh të të dojë.

U vendos heshtje. Mjeku ndezi një cigare dhe u mbështet në kolltuk.

— Puna është se kanë mbetur vetëm dy muaj, — tha, — sikur të iknin edhe këta dy muaj, atëherë gjithçka mbetet për vitin tjetër. Mirëpo askush nuk të pret deri vitin tjetër.

Mjekut i ra një çehre e zyrtë. U duk sikur u fut në një vorbull mendimesh dhe vështtrimin e kishte tretur në gotën e verës që mbante në dorë. Ai ishte një mjek që kishte mbaruar jashtë shtetit dhe atje kishte shumë miq. Ai u njoh me këta dy kushërinj të çuditshëm dhe, si i kuptoi mendimet dhe dëshirat e tyre, nisi t'i përpunonte dhe të gjurmonte rastin për t'u arratisur jashtë shtetit. Ai u foli shumë për miqtë e tij, për jetesën e lirë dhe të bukur dhe shëtitjet me makina personale në lokale

fantastike. E ç'të mira kishte pasur familja e tyre në këtë pushtet? Asgjë veç përbuzjes si një familje e degjeneruar. Por a mund të quhej degjenerim shoqëria e Jolës me djem? Mjeku i saj i dashur e kishte këshilluar të qëndronte urtë, të mohonte të kaluarën dhe të sillej si një vajzë me kulturë dhe e padjallëzuar. Ajo arriti të fitonte admirimin e nja dy të rinjve ndonëse e dinin se familja e saj kishte përbërje të keqe politike. Por ajo me asnjërin nuk vendosi të shkonte, sepse asnjë nuk ishte nga ata që i duheshin mjekut. Mjekut i interesonte një njeri me personalitet, që të kishte një farë pozite dhe miq të shumtë, me qëllim që të mund të largonte dyshimet dhe mendimet e këqija për veprimet e kësaj familjeje.

Jola ndenji një copë herë me këto mendime dhe, kur e kuptoi se koha po ikte, tha:

— Leo, nisu me shërbim ndonjë javë. Brenda kësaj jave unë do t'ia mbush mendjen Bekimit të kalojmë pushimet në EK. të gjithë bashkë...

3.

Gjithë atë javë ata ndenjën bashkë. Netve, rruçicave të qeta ata ndenjën me dashurinë e tyre dhe me yjet. Megjithatë, Bekimi dukej i hutuar dhe ndiente dhembje zemre. Një natë ai nuk mundi më të përmbahej dhe i foli hapur.

— Përse nuk të njoha më parë, — i tha, — përse duhej të të njihja pikërisht tani, që jam i martuar dhe i kam kaluar të tridhjetat?

— A nuk është njësoj? — i tha ajo. — Unë jam me ty. Unë gjithnjë do të jem me ty dhe për këtë

askujt nuk duhet t'i vijë keq, sepse unë nuk i marr asgjë.

Ai lëvizte si i dalldisur netve, me ndjenjën e dashurisë së ngrohtë dhe herë-herë i shqetësuar dhe nervoz. Megjithëse ai mendohej të ruhej se mos e shihte ndonjë i njohur, e kuptonte se kjo do të ishte shumë e vështirë. Njëherë padashur, u përplasën me një njeri që po ndizte cigaren me një çakmak të bardhë. Bekimit iu duk se diku e kishte parë atë njeri që u largua si një vizion i mjegulluar, dhe ndjeu të rrëqethura kur mendoi se ai mund të ishte një shok i vjetër i së shoqes. Ai kishte një të ecur karakteristike, që e futi në dyshime.

— Ta hajë dreqi! — shfryu me nerva të tendosura. — As që mund të dashurosh i lirë një njeri.

Vajza e vështroi me një ndjenjë pikëllimi. Atij iu duk shumë i papërcaktuar ai vështrim.

Thithi fort cigaren dhe e vështroi drejt në sy. Tymi i duhanit u end një copë herë si një mjegull e hollë rreth fytyrës së saj dhe ai vuri buzën në gaz me hidhërim.

Gjithë java nisi të shtyhej në një botë të pakuptueshme ndjenjash, që përzihej herë-herë me një nervozizëm të neveritshëm. Edhe vajza dukej nganjëherë nervoze, sepse ende nuk kishte mundur të gjente rastin të shprehte mendimin e saj për pushimet. Vetëm një natë, ajo ishte nata e fundit, kur ai u trondit, sepse pandehi se i pa një shok i zyrës. ajo tha:

— Nuk vazhdohet më kështu! — Në sytë e saj ai vuri re një shkëlqim të dhimbshëm. — Unë nuk dua të prish jetën tënde. Më përcill në shtëpi!

Ai qëndroi në mes të rrugës, duke e vështruar

me habi. Tani ai nuk do të pyeste edhe sikur të kalonte kushdo që mund t'i bënte keq.

— Nuk më do më? — tha ai me një ton naiv dhe shumë i tronditur.

— Bek... — Ajo e vështroi me habi, sikur të donte t'i thoshte: vërtet të shkon ndër mend një gjë e tillë?

— Domethënë...

Ajo nuk mundi të përmbahej më dhe iu hodh në qafë. Kur ai ia ktheu fytyrën nga vetja, vuri re se sytë i ishin mbushur me lot. Vërtet po qante për të? Ai u përfshi i tërë në një valë ndjenjash të çuditshme dhe kuptoi se ajo e donte me gjithë fuqinë e shpirtit, e donte thellë në zemër, pa kurrfarë interesi, e donte si njeri, si Bekim dhe ai e kishte fyer.

— Nuk të dua, — tha ajo me rrëmbim, — nuk mund të të dua. Përse duhet të humbasësh gjithçka për mua?

Ai e vështroi drejt në sy, pa mundur të gjente fjalë që të shprehte mirënjohjen e tij për këtë dashuri kaq të pastër.

— Dëgjo, moj vajzë, — i tha pastaj me zë të ngjirur. — Unë që vij me ty, i kam bërë mend të gjitha. Mua më shqetëson vetëm ti. A do të mundësh ti t'u bësh ballë erërave të Fierzës?

Ajo i mori një cigare dhe e ndezi. Bekimin gjithnjë e shqetësonte mendimi se ajo mund të largohej nga ai dhe kjo e bënte të ndiente dhembje zemre.

— Unë nuk pyes për erërat e Fierzës, — tha ajo. Po ty do të të hidhen të gjithë, opinioni shoqëror do të të mpijë gjithçka njerëzore dhe të dashur që ke ti, dhe atëherë ku të mbytem unë? Unë jam e sigurt se ti nuk do të mund të durosh më... dhe... jo unë nuk dua kurrë të prishësh familjen...

Ata ishin afruar pa e kuptuar në rrugën e shtëpisë së saj. Në dritaret kishte dritë dhe Jola e kuptoi se Leoni ishte kthyer. Ata qëndronin më këmbë në heshtje në mes të rrugës.

— E di, Beki? — i foli ajo papritur me zë të ngrohtë. — Një ditë po mendoja... Unë jam budallaqe, se këto gjëra as që duhen menduar, unë mendoja... — Ajo heshti papritur.

— Më thuaj çfarë mendoje? — tha ai.

— Unë ëndërroja, — ia nisi ajo pas një copë here, — unë ëndërroja sikur të shkonim të dy në ndonjë fshat të largët për pushime. Të qëndronim vetëm 15 ditë, ose sa të mundnim... — Ajo i hodhi një vështrim dalldisës. — Sa mirë do të qe, ë?

Ai e vështroi i habitur. Kaq shumë e donte ajo, sa t'i vinin në kokë gjëra të tilla? Po kjo mund të realizohej fare lehtë.

— A nuk janë budallallëqe, ë?

— Aspak, — tha ai. — Kjo është një ide e shkëlqyer. Vetëm se... — ai ngurroi ca, — ç'do të thoshin njerëzit e tu po të shkonim të dy, a nuk është e pamundur një gjë e tillë?

— E sheh që jam budallaqe? — tha ajo. — Unë as që i mendova fare njerëzit e mi.

Ajo u mbyll në vetvete dhe ai e kuptoi se sa keq i erdhi që ishte e pamundur të shkonin të dy bashkë në një fshat të largët për disa ditë. Po papritur asaj i shkëlqyen sytë.

— Po sikur të marrim dhe Leon me Vasin? — Ajo u përfshi e tëra nga një valë ndjenjash. — Po t'i marrim dhe ata, çdo gjë do të jetë në rregull.

— Po Vasin ç'e duam? — tha ai.

— Si ç'e duam?! — Ajo i shtypi hundën. —

Kush do ta shoqërojë Leon, kur ne do të duam të rrimë të dy vetëm?

Ai qeshi. Ende nuk ishte në gjendje të kuptonte se ç'do të ndodhte sikur një gjë e tillë të merrej vesh, po megjithatë mendoi se vajzës i kishte lindur një ide e mirë. Ai i tha:

— Ikim në EK. — Vajza e vështroi me një ndjenjë pasigurie. — E di ku bie?

— Jo, — tha ajo.

— Unë kam lindur në EK. — tha ai. — Para dy vjetësh kam shkuar me Leon. Ai është një fshat shumë i bukur dhe për këtë do të bindesh kur të vemi. Do ta rregulloj punën që të mos dyshojë njeri. A të pëlqen EK, Joli?

Ajo ngriti supet.

— Në EK. Unë kam njerëz nga farefisi, të cilët as që e njohin gruan.

Ajo e vështroi me një palë sy joshës.

— Unë do të vij aty ku të të pëlqejë ty, — i tha me pasion, — edhe në fund të botës, mjafton të të pëlqejë ty.

Ata u ndanë në hyrjen e pallatit dhe ai eci si i dalldisur nëpër errësirë...

4.

Dritëza e një pasqyre po e bezdiste dhe ai ktheu kokën.

— Xhaxhi, po të fus në diell dhe ti nuk do të dalësh dot.

Ajo ishte një vajzë e vogël dhe buzëqeshte nën rrezet e diellit, duke u munduar t'ia hidhte atij në fytyrë.

— Si të quajnë? — e pyeti ai. Ai ishte një djalë ende i ri dhe me sa dukej i donte shumë fëmijët.

— Mira, — tha vajza.

— E kujt je, moj Mira?

— E Bekim K, — tha vajza.

Ajo e vështroi duke vënë buzën në gaz. Ndërsa ai kishte mbetur i habitur. Pastaj i tha pse kishte dalë vetëm, po vajza menjëherë i tregoi me dorë një shitës ambulant akulloresh dhe ai njohu gruan e Bekim K. që po vinte me dy akullore në duar. Ajo ia dha njëren vajzës dhe, kur ndjeu se një njeri i huaj e vështronte pa ia ndarë sytë, ngriti kokën.

— Bato! — thirri ajo. — S'të njoha fare.

— Si je, Reti? — Ai i zgjati dorën. — A të të shoqëroj ca?

— Mirë, Bato, — i tha gruaja, — po më duhet të të blej edhe ty një akullore.

Ai vuri buzën në gaz. Pastaj nxori një cigare dhe e ndezi me një çakmak të bardhë.

— S'prish punë, — i tha, — tani jam i madh dhe mund të pi cigare.

Ata ishin shokë fëminie. Gjithë jetën kishin qenë miq të mirë dhe, kur takoheshin, flisnin edhe për hallet e tyre. Ai ishte fytyrëhequr dhe nën kostumin elegant ngjyrë hiri i ravijëzoheshin muskuj të fortë.

— Si ia shpie me Bekimin? — e pyeti papritur ai.

— Mirë, — tha ajo. Ai vuri re se fytyra i mori një pamje të trishtuar. — Vetëm se...

Ajo ngurroi. Po përse të ngurronte ndaj një miku, që kishte qenë gjithnjë i mirë për të?

— Nuk ia shpie mirë, — i tha e vendosur dhe hapur ajo. — Ndonjë ditë me siguri do të ndahemi.

Ai e vështroi në heshtje. Reti u çudit që ai e vështroi në heshtje. I lindi mendimi se ai dinte shumë gjëra, mbase dinte më shumë se ajo.

— Kanë arritur punët sa të ndiej neveri për të, — tha ajo.

— Me gjithë mend ndien neveri, Reti? — pyeti ai.

— Po, — tha ajo. — Ka të ngjarë të ketë hyrë ndonjë grua tjetër mes nesh dhe ai e ka humbur fare personalitetin e tij. Ai ka filluar të mos pyesë fare për ne. — Ajo vështroi të bijën. — Këto ditë ai do të niset për pushime në EK me ca shokë. Vendosi papritur, por edhe unë nuk kam ndër mend t'i lutem të më marrë me vete.

Ata kishin arritur te stacioni i autobusit dhe asaj i duhej të ikte. Tjetri nuk i tha asnjë fjalë. Vetëm kur u ngjiti në autobus, ai i tha:

— Do të flasim përsëri dhe gjatë për këto gjëra, Reti.

— Mirë, — tha ajo.

Ai përkëdheli vajzën e vogël dhe u largua me një çap të qetë. Por në sy të tij mund të vije re një notë keqardhjeje dhe inati. E dinte se Reti nuk do t'ia falte keqardhjen, prandaj u mundua të qëndronte i qetë dhe natyrisht i vendosur në mendimet e tij të ngatërruara për Bekim K. dhe miqtë e tij të rinj.

5.

Tridhjetëvjeçari elegant, që luante me çakmakun e tij të bardhë sa kohë qëndroi me gruan, dukej krejt i freskët dhe i çiltër, sikur në jetë t'i shkonte

gjithçka mirë. Por, me t'u ndarë nga ajo, një njeri i vëmendshëm mund të vinte re edhe gjurmë lodhjeje nervore dhe pagjumësi të vazhdueshme në fytyrën e tij të hequr. Ai ecte i qetë, duke vërtitur në duar çakmakun dhe duke vështuar i menduar fytyrat e kalimtarëve.

«Të ketë më shumë se një dashuri të thjeshtë? — tha me vete. — Edhe sikur të ketë vetëm dashuri, ata njerëz do të dinë ta futin në rrjetën e tyre. Në qoftë se ikin në EK, atëherë do t'ia mbushin mendjen t'i kthejë kurrizin atdheut fare lehtë. Dhe doemos edhe jetës së tij, ta hajë dreqil!»

Ai hyri në një ndërtesë trekatëshe dhe nëpunësi i shërbimit nuk e ndali.

— Ç'kemi, Gone? — i tha.

— Asgjë, shoku Bato.

— Kur do të shkosh me pushime?

— Këto ditë. Ai vuri buzën në gaz. — A do t'ju ndodhet një cigare «me tapë», shoku Bato?

Ai i tha se i ndodhej një cigare «me tapë» dhe, si ia ndezi, ngjiti dy nga dy shkallët. Kur hyri në zyrë, tre vetë u ngritën më këmbë në shenjë respekti dhe ai u shtrëngoi duart. Ata ishin pothuaj të një moshe. Njëri i tha:

— Shoku Petrit na ka porositur, që sapo të vini ju, ta njoftojmë. A ta njoftojmë?

— Mirë, — tha ai.

Petriti ishte një burrë i gjatë dhe i thinjur. Ata të katër u ngritën menjëherë më këmbë sapo hyri ai, dhe pastaj u ulën rreth një tryeze të vogël, në ca kolltukë të butë. Ai u zgjati të gjithëve nga një cigare. Ata e ndezën dhe nisën të bisedonin për gjëra fare pa rëndësi, po të gjithë e dinin se rreth asaj

tryeze do të niste një bisedë e lodhshme, që kërkon-te një logjikë të fortë dhe nerva të tendosura.

— Puna është se ne kemi arritur të zbulojmë vetëm veprimtarinë e një agjenti që ka ndenjtur për një kohë të gjatë në heshtje. — Batoja vështroi shefin në sy. Ai dukej shumë i lodhur, por i gatshëm të niste nga hollësitë e përpunuara mirë në trurin e tij të fuqishëm. — Ne kemi arritur në përfundimin se «Mjeku», sipas udhëzimeve të «Boshtit të qerres», që ndodhet jashtë shtetit, po përgatit një grup për arratisje.

Ai vuri re se shoku Petrit nisi ta dëgjonte me vëmendje.

— Për të mos ngjallur dyshime, atij i nevojitej patjetër një njeri si Bekim K, — vazhdoi Batoja me tonin e tij të qetë. — Bekim K. do të mund t'i sigurojë edhe për të qëndruar në fshatin kufitar EK, ku do të përgatiten për t'u hedhur matanë pa dyshuar fare për ta. Bekim K. këtë mund ta bëjë fare lehtë. Ata po e futin në kurth.

Ai thithi fort cigaren dhe u duk sikur donte të vazhdonte më tutje, po Petriti u bë gati të fliste.

— Atij i besohet shumë, — tha. — Përveç kësaj, njerëzit e tij janë të lidhur me gjak me pushtetin. — Ai iu drejtua Batos: — Ç'dini për lidhjet e tjera të «Mjekut»?

— Deri tani asgjë, — tha Batoja. Ai ngurroi ca. — Unë... vetëm dyshoj të ketë lidhje me «Buallin e Zi», që është në pasivitet. — Petriti e vështroi me vëmendje.

— Por, — vazhdoi Batoja, — deri tani Martini nuk ka njoftuar asgjë.

— Përse dyshon pikërisht tek ai? — pyeti Petriti pak i habitur.

Tjetri vuri buzën në gaz me drojtje, megjithatë foli me një farë sigurie.

— «Bualli i Zi» i përket të njëjtit zbulim të huaj nga i cili varet edhe «Mjeku». Pra, edhe «Bualli i Zi» varet nga «Boshti i qerres» jashtë shtetit. — Ai vështroi shefin në sy dhe pastaj të tjerët. — Unë mendoj se «Mjeku» e di mirë punën e tij dhe, në goftë se ai ka menduar të arratiset, atëherë me siguri do t'i duhet të takohet me «Buallin e Zi».

Të tjerët e vështroan me një farë habie dhe me vëmendje. Natyrisht, të gjitha këto edhe mund të ndodhnin, por ata ende nuk kishin gjetur ndonjë shteg që të vërtetonte këto dyshime dhe hipoteza për lidhjen midis dy agentëve të mbuluar. Petriti i ngjalli kënaqësi pjekuria dhe përgatitja profesionale e tridhjetëvjeçarit, por, siç ndodh në të tilla raste, ai u mundua ta fshihte. Ai vuri re se djaloshi dukej shumë i zbetë, i harruar në mendime dhe jo i çiltër si zakonisht.

— Unë nuk jam i sigurt vetëm në një gjë, — tha papritur Batoja, duke nxjerrë një psherëtimë të mbytur. — A do të arrijë Bekim K. që për sytë e bukur të një femre të mohojë atdheun?

Petriti ia nguli sytë fort. Në tiparet e tij të lodhura ai vuri re shqetësimin e njeriut të sigurimit për fatin e një bashkatdhetari të rënë në fijet e merimangës së agjenturave të huaja. Ajo që e shqetësonte djaloshin nuk ishte dështimi i veprimeve të agentëve, oh, për këtë ai ishte i bindur, ishte i bindur edhe se do të arrinte me çdo kusht t'ua shkëpuste nga kthetrat, por ajo që e shqetësonte djaloshin ishte papjekuria, futja me mendjelehtësi në një aventurë e një njeriu, të cilin ai e kishte menduar ndryshe. Vallë duhej të sillej me të si me një

armik? Ç'e kishte detyruar një njeri si Bekim K. të binte në rrjetën e agjenturave të huaja? A mund të shpëtohej ai, dhe në fund të fundit, a duhej shpëtuar?

— Dëgjo, Bato, — tha Petriti me zë të qetë dhe pakëz të hakërryer. — Për mua nuk është hera e parë që merrem me raste të tilla. Gjithnjë zbulimeve të huaja u janë dashur njerëz të lidhur me pushtetin. Dhe duhet të dish se për Bekim K. ata kanë shumë nevojë; e para, sepse ai do t'u krijojë mundësi të treve të arratisen, dhe e dyta të kenë mundësi ta përdorin si mjet për propagandën e tyre. — Ai ndezi një cigare, e thithi fort dhe pastaj vazhdoi: — Që të arrish të mohosh atdheun, duhet ose të kesh qenë gjithnjë armik, ose të biesh viktimë e propagandës perëndimore dhe revizioniste, pra të jesh mendjelehtë. Bekim K. iu gjet shtegu: kontraktat në familje, largimi nga realiteti dhe dhënia pas asaj, që disa e quajnë moderne e ka bërë ta shohë jetën me një sy tjetër, me egoizëm, me shpirtvogëlsi.

Ai thithi edhe një herë cigaren dhe përsëri ndërroi ton.

— Por, sidoqoftë, ju arritët ta zbuloni që në embrion veprimtarinë e tyre dhe me siguri do të arrini të zbuloni edhe çfarë u rëndon disave prej tyre në ndërgjegje...

Në dhomën e mbushur me tym duhani u vendos një heshtje e gjatë. Me sa dukej biseda kishte mbaruar, por Petriti po shënonte diçka në një skedë të bardhë. Ai shkruante me sy të rrudhur, sikur të shprehte një ndjenjë dhimbsurie, dhe Batoja mundi të lexonte vetëm një frazë:

«Çakmaku i bardhë» është në përfundim të zgji-

dhjes së një operacioni të lehtë në dukje, po në vetvete të ndërlikuar dhe shumë të vështirë».

Batoja ndjeu turbullirë, ajo i ishte ngjitur që në mëngjes dhe fraza në vetvete nuk mundi t'ia kthjellonte mendimet. Ai e kuptoi shefin dhe e pëlqeu arsyetimin e tij të saktë, por përbrenda ndjeu fijet e një shqetësimi të padukshëm dhe të pakuptueshëm, të cilin do ta kishte të vështirë ta linte pas dore. Si nëpër mjegull ai dëgjoji porositë e fundit për të patur kujdes se agjentët mund të bënin papiropritur ndonjë lojë dhe të realizonin ëndrrën e tyre. Ai nuk mundi të përqëndrohej në këtë porosi dhe vetëm kur po zbriste shkallët u kujtua se ajo kishte një rëndësi të madhe dhe, sikur të mos i kujtohej se përse ishte fjala pikërisht, atëherë do të dëshkonte gjithçka.

«Punë dreqi! — tha me vete. — Edhe sikur të mos ia kenë mbushur dot mendjen për t'u arratisur, ata do ta përlajnë».

Ai u fut në një pastičeri dhe kërkoi arançatë. Ndjeu një freski të ëmbël dhe të natyrshme, e hoqi mendjen nga Bekim K. dhe e hodhi tek lidhjet e tjera të «Mjekut», për të cilat kishte shprehur dyshimet e tij në takimin me Petritin.

«Mjeku» kishte qëndruar shumë kohë pa vepëruar, megjithatë ai kishte mundur të fuste në shërbim të tij njerëz. Ai ishte i informuar edhe për marrëdhëniet e tij me vajzën, ato ishin marrëdhënie jomiqësore dhe as thjesht bashkëveprimi. ««Mjeku», — mendonte ai, — kërkon të marrë vajzën me vete jo vetëm për dashuri, po edhe se asaj mund t'i ketë mbetur ndonjë trashëgim gjëkund, për të cilin ajo nuk di gjë, ndërsa «Mjeku» e di dhe s'ka mundësi ta tërheqë pa të. Dhe natyrisht, ai nuk do të mbetet

andej barkthatë. A thua do të arratiset pa lënë zëvendës këtu?»

Dikush kërkoi me zë të ulët të ndizte cigaren dhe ai i zgjati të tijën, pa e pasur fare mendjen tek tjetri.

— Shoku Bato, Martini njoftoi se «Mjeku» u takua me «Buallin e Zi».

Batoja ktheu kokën me rrëmbim për të dalluar njeriun që lëshoi ato fjalë aq të pritura, por ai kishte humbur në lëvizjen e madhe të kryeqytetit.

6.

«Mjeku» u ul i shkujdesur në kolltukun e butë, kurse tjetri, një burrë i gjatë, shumë simpatik dhe me tipare brune, vështroi njëherë rreth e rrotull.

— Verë të kuqe me akull, — i tha kamerieres, — e di vetë ti.

— «Mjeku» vështroi me një pamje të kënaqur, si një njeri që punët i venë mirë, ndërsa tjetri i pëshpëriti:

— A je i sigurt se nuk kemi lënë ndonjë gjurmë dyshimi?

— Nuk besoj të dyshojë njeri për ne, megjithëse po takohemi për herë të parë pas shumë vjetësh.

— Natyrisht, ky takim nuk bëhet më kokën tënde, ë? — pyeti tjetri me zë të ulët.

— Jo, jo me kokën time, — tha «Mjeku». — Mua më kanë thënë me kohë si duhet të veprohet kur të vijë puna. — Mjeku vështroi njëherë klientët që ndodheshin pranë tryezës së tyre. — Unë do të iki këto ditë për pushime në një fshat të bukur. Prandaj këtu duhet të më zëvendësosh ti.

Tjetri e vështroi me kërshtëri dhe me një pamje ziliqare dhe pastaj i tha:

— Po si ta mësoj unë se ç'duhet bërë, Vasi? Unë deri tani nuk kam asnjë të njohur.

«Mjeku» nxori një copë letër nga çanta, e futi në një zarf të bardhë dhe i tha i shkujdesur:

— Kur të kalosh nga posta, fute pak në kuti. — Ai e vështroi me ngulm në sy dhe shtoi duke e ulur zërin: — Në atë letër të vogël janë mbledhur miqtë e mi. Në të janë shënuar adresat dhe karakteristikat e secilit. Në zarf është shënuar edhe njeriu që mban lidhjet me mikun tim Z, nga i cili varemi të dy.

— Pse, nga Z. varemi ne? — pyeti tjetri me habi. — A nuk është jashtë ai?

— Sigurisht, — tha «Mjeku» duke i hedhur një vështrim përbuzës. — Gjithçka përgatitet atje. Unë deri tani kam vepruar sipas porosisë së tij dhe me urdhrin e tij do të shpie tre vetë në... Tani duhet të merresh ti me këto punë sipas udhëzimeve të reja të Z.

— Ti ke rregulluar një vajzë të bukur, — i tha tjetri duke përfytyruar Jolën, dhe një ndjenjë zilie për gjithçka të Vasi ia përshkoi trurin.

— Këtë mund ta bësh edhe ti fare lehtë, — tha «Mjeku». — Mjafton të jesh modern, kupton? — Ai vuri buzën në gaz. — Të jesh modern, sipas tyre, do të thotë të jesh majmun, po mos pandeh se nuk gjen vajza që u pëlqejnë majmunët...

Kur dolën, ishte bërë natë dhe ata vendosën të ndaheshin menjëherë. I gjati nuk mundi të vinte re se në ç'drejtim u largua «Mjeku», dhe mendoi të futej rrugicave. Mirëpo në hyrjen e rrugicës së parë, në terr, ai vuri re dy silueta dhe, megjithëse nuk

i lindi ndonjë dyshim, mendoi se do të bënte mirë të mos futej në të.

— Më falni (i gjati priti në heshtje zërin që i erdhi pas krahëve), ju kanë dhënë një zarf që ne na duhet shumë. — I gjati vuri re se të dy siluetat kishin lëvizur dhe ishin afruar shumë. Qëndroi një makinë dhe ai nuk e kuptoi se ç'po ndodhte. Vetëm ndjeu frikë, një frikë të pakuptueshme dhe tronditëse, e cila i hyri në të gjitha qelizat dhe e bëri të mos ishte më në gjendje të mendonte për asgjë. U kthye ngadalë nga zëri, duke ndier pikat e djersës së ftohtë t'i lëvrinin nëpër trup.

Ai që foli i mori çantën, nxori që andej një zarf të bardhë, ia zgjati çantën dhe i tha të futej në makinë pa bërë fjalë. Të dy siluetat e vunë në mes, ndërsa ai që foli kishte vënë një cigare në gojë. I gjati nuk mundi t'ia dallonte fytyrën edhe kur ai ndezi cigaren me një çakmak të bardhë.

— Është «Bualli i Zi», — pëshpëriti ai. — Do të bisedojmë me të pasi të «çlirojmë» miqtë e tij nga zarfi, ku me siguri e ndiejnë veten ngushtë.

Makina u vërsul me shpejtësi në mugëtirën e neontë...

7.

Mëngjesi lindi i zymtë, ngjyrë hiri dhe pritej të niste shi. Bekim K. u ngrit heret dhe, pasi u bë gati për rrugë të gjatë, priti në gjysmerrësirën e dhomës. Ai mundi ta rregullonte që të ikte ca ditë më parë me shërbim në një qytet afër EK, dhe kjo u prit mirë nga miqtë e tij, madje iu ngjalli edhe gëzim. Tani ai priste në mugëtirë borien e makinës

së Leonit. E shoqja flinte me vajzën dhe ai i vësh-troi një copë herë. Ajo flinte e inatosur, kurse vaj-za kishte vënë buzën në gaz. Ai ndjeu një komb të vogël që iu bë në grykë, iu duk sikur po i këputej diçka përbrenda dhe nxori një psherëtimë ankthi. Ndjeu se e kishte dashur të shoqen, e kishte dashur shumë, po tani ai kishte nisur një dashuri që e josh-te dhe e kishte rrëmbyer të tërin.

Jashtë gjëmoi boria e «Gazit». Ai u përmend i trembur, pastaj u përkul mbi shtrat dhe puthi edhe gruan, edhe vajzën. E shoqja lëvizi, ndërsa vajza buzëqeshi. Ai mori çantën e udhëtimit dhe zbriti shkallët. . .

«Mjeku» ishte ulur përpara me Leon, ndërsa vajza pothuajse ishte shtrirë në sedilen e prapme. Ata iu dukën të zymtë, sikur pak më parë të ishin grindur. Vetëm vajza, sa e pa, i qeshi dhe ai nisi ta ndiente veten më të gëzuar. Të tjerët, megjithëse ishte mëngjes heret, thithnin cigaret me nervozizëm, kjo Bekimit i ra në sy, po as që u mundua të vriste mendjen.

Më parë ata kishin bërë një bisedë intime pa praninë e tij. «Mjeku», duke dyshuar se mos kishte lënë ndonjë gjurmë, vendosi, përveç nisjes ca ditë më parë, të ndryshonte planin. Ai ishte pothuaj entuziast për pregatitjen e planit dhe mendoj se sigurimi shqiptar nuk mund të ishte aq i tmerrshëm sa e bënin. Megjithatë duhet mbajtur parasysh për-voja e hidhur dhe duhet vepruar me kujdes dhe dinakëri.

«Ndoshta ata janë interesuar për pushimet e Bekimit, — tha ai.

«Asnjeri nuk e di se ne do të nisemi pikërisht sot, — tha Leoni. — Dhe, po të duhet të na gjur-

mojnë, këtë do ta bëjnë në atë qytetin pranë EK. Makina është e dikasterit dhe askush s'mund të na ndalojë të marrim shokë me vete».

«Kjo është e vërtetë, — tha «Mjeku», — prandaj ne do të kalojmë matanë pikërisht sot». Ai ua nguli sytë dy të tjerëve. «Ata as që mund ta marrin me mend se ne do të kalojmë matanë pikërisht sot dhe, edhe sikur të kenë vënë njeri për të na përgjuar në EK, gjatë pushimeve tona, ne kemi kohë t'ua mbathim». Ai u bë papritur i zymtë, po në vetvete përfytyroi bisedat dhe shakatë që do të bënte me miqtë e tij jashtë shtetit, kur t'u tregonte se si ua kishte hedhur njerëzve të «sigurimit të tmerrshëm».

Por, a e dinte Bekim K. se pikërisht atë ditë ishte vendosur të arratisesh?

Makina u lëshua me shpejtësi nëpër asfalt dhe Bekim K. e kishte mendjen vetëm tek duart e dashurisë që nisën ta shtrëngonin vjedhurazi. Gjatë gjithë rrugës ai vështroi vetëm dashurinë, e vështroi si një det të kaltër dhe të thellë, plot mistere, dhe të bukur...

*

*

*

Tek lokali pranë EK. nuk kishte njeri, ndaj banakieri kishte dalë jashtë dhe që ulur në prak. Ai ishte i inatosur, sepse atë ditë që nuk bënte shumë vapë, nuk kishte ardhur asnjë klient që t'i pinte dhallën e ftohur në ujin e tij të bekuar dhe me siguri ajo tani do të thartohej. Papritur ai dëgjoi uturimën e një kamioni që po zvarisej në rrugën me çakëll dhe, sikur ai të mos qëndronte vetë duke nxjerrë

një ulërimë mu në mes të rrugës që të shpinte në EK, do ta kishte ndaluar.

«U prish, shyqyr», — tha me vete banakieri dhe e vështroi me kërshtëri.

Shoferi u hodh poshtë duke sharë me zë të lartë dhe duke qëlluar me shqelm gomën e parë. Banakieri e vështroi më vëmendje atë fytyrë të inatosur shoferi dhe nisi të qeshtë me vete. Nga karrocëria zbritën tre punëtorë dhe u futën në lokal, ndërsa shoferi ndenji të rregullonte makinën. Ai u fut poshtë saj, diçka zbërtheu, e mbërtheu përsëri, u fut në kabinë dhe i ra motorinos, po makina nuk u ndez. Nuk kishte kaluar as një çerek ore, kur lokalit iu afrua një «Gaz» i ri me katër vetë brenda.

«Edhe kjo na duhej», — tha me vete Leoni kur pa kamionin që kishte zënë rrugën. Ai zbriti nga makina dhe pyeti shoferin nëse mund t'ia hapte pak rrugën, sepse kishte brenda zëvendësministrin dhe nuk ishte e hijshme të qëndronte aty duke pritur.

— Mirë, mor jahu, — foli shoferi. Vetëm se nuk karikon dinamoja. Po e provoj edhe njëherë.

Ai u hodh në kabinë dhe i ra disa herë motorinos, por ajo me sa dukej kishte vendosur të mos ndizej. Ai zbriti duke vënë në gojë një cigare me «tapë» dhe e ndezi me një çakmak të bardhë. Ishte bërë gjithë njolla vaji në fytyrë dhe tha duke u ngërdheshur.

— Ç'të bësh, duhen shpatulla! — Ai u kthye nga «Gazi». — Thuaji dhe atij «adjudantit të zëvendësministrit» të na ndihmojë ta shtyjme të paktën sa të lirohet rruga.

Doli edhe Bekimi me «Mjekun» dhe të tre mbështetën duart në spondin e pasëm. Dolën edhe

punëtorët nga lokali, ndërsa banakieri vajti t'i bënte shoqëri vajzës.

— Duart lart! — u dëgjua një zë i çuditshëm, fare i pa besueshëm. — Mos lëvizni!

Bekimi vuri re me habi se të tre «punëtorët» mbanin nga një pistoletë në dorë.

— Ç'do të thotë kjo? — pyeti me habi Bekim K.

— Kuptohet lehtë, — tha shoferi duke thithur cigaren që ishte shuar. Ai dukej i qetë dhe e vështronte Bekimin me vëmendje, sikur të kishte vendosur të futej thellë në mendimet e tij.

— Bek, — thirri vajza e shqetësuar; ajo ishte një thirrje e mbushur me nota përkëdheljeje, që tingëlloi shumë qesharake dhe e neveritshme. — U thuaj atyre të mos i trembin.

— Ç'do të thotë kjo? — tha prapë Bekim K. — A e dini kush jam unë?

— Sigurisht, — tha shoferi duke ndezur cigaren me çakmakun e tij të bardhë. Prandaj të takon ty të na njohësh.

Ai iu afrua Leonit dhe «Mjekut» dhe u nxori nga xhepat revolverët, ndërsa Bekim K. i vështronte lëvizjet e tij me habi. Pastaj ai shofer i çuditshëm i ua frua «Gazit» dhe i tha Jolës:

— Zbrisni, ju lutem! — Në zërin e tij u vu re një notë talljeje. — Makina juaj nuk ka më benzinë. Ne e llogaritëm sot në mëngjes që ajo të arrinte deri te lokali pranë EK.

Vajza zbriti shumë e habitur dhe shkoi tek të tjerët që qëndronin me duart lart.

— Ja çfarë?! — tha papritur me habi banakieri, duke i ngulur sytë Batos. Unë pandeha se t'u prish makina për herë të dytë.

— Qenke një banakier i zgjuar, — i tha Batoja

duke iu afruar të tjerëve. Vajza e vështronte me habi dhe frikë, por ai as që e vuri re. Ai vetëm i doli ballë për ballë Bekimit dhe e vështroi drejt në sy.

— Na njohe tani, Bek? — i tha me përbuzje. Bekim K. e vështroi gjatë, vështroi dhe miqtë e tij që qëndronin të zbetë, si vdekje, me duart lart. Pranë, si një ironi e fatit i qëndronte «dashuria»...

NJË NJERI I NEVERITSHËM

Aj ishte ulur në një kolltuk të butë, kishte ndezur një cigare dhe dëgjonte tjetrin me bezdi. Ishte i shëndetshëm dhe rrinte i shkujdesur, me këmbë të hapura; kur hynte ndonjë njeri me rëndësi, mundohesh të merrte një pamje të drojtur. Tjetri i fliste me respekt dhe dukej sikur ruhej se mos i shpëronte ndonjë fjalë e pamenduar mirë. Ai e dëgjonte sikur të mos e kishte mendjen aty.

Unë hyra i mardhur, me jakën e pardesysë të ngritur. Jashtë bënte ftohtë. Një natë më parë kishte rënë dëborë, ajo kishte shtruar dhe njerëzit ishin shqepur së luajturi. Në drekë ajo shkriu. Edhe tani pasdite ra dëborë, por nuk shtroi. Unë ula jakën e pardesysë dhe eca drejt, duke iu përgjigjur përsëritjes së disa të njohurve që ishin në atë sallë.

U ndodhëm ballë për ballë. Nuk na kishte qëlluar të ndodheshim ballë për ballë që kur nuk ishim më kolegë. Xhezari, me sa dukej, sillej me drojtje ndaj njerëzve që më përsëritën, dhe prandaj vendosi të më fliste. Më parë ai mjaftohesh vetëm me një përsëritje të ftohtë ose bënte sikur nuk më shihte. Por këtë radhë vendosi të më fliste.

— Ou, Bledi, si je?

I shqiptoi këto fjalë me një notë mospërfilljeje, por në fytyrë kishte marrë po atë pamje të drojtur dhe qesharake. Dhe unë, megjithëse nuk doja të mendoja asgjë, nuk mund të mos e kuptoja se ndryshimi i menjëhershëm i pamjes së tij nuk ishte i rastit. Ndryshimi ndodhi vetëm se, me ata njerëz që më përshëndetën me dashamirësi, ai sillej me drojtje. Unë i thashë:

— Mirë, Xhezar.

— Kam dëgjuar se je shumë mirë, — tha ai.
— Gezohem.

— Unë gjithnjë kam qenë mirë, — i thashë. —
Po ti si je?

— Eh, — ia bëri ai duke u kthyer nga tjetri dhe i tha se ku punoja. Tjetri më lëshoi një buzëqeshje. Unë nuk e kuptova se ç'donte të thoshte Xhezari me atë «eh»; ajo nuk ishte as psherëtimë, as pasthirmë. Me sa më kishin treguar, ai kishte mundur të bëhej shef sektori.

— Ç'do të thotë «eh»? — i thashë.

Ai bëri një lëvizje të papërcaktuar me dorë dhe hodhi vështrimin matanë xhamave të dritares. Nata e ftohtë qëndronte pezull mbi rrugët e ndriçuara dhe njerëzit lëviznin me çapa të plogët. Nganjëherë dëgjohej ndonjë ritëm takash dhe unë, sipas një zakoni të vjetër, i ndiqja me mend derisa humbisnin. Ndërsa ai mendohej të shquante në errësirë vajzën a gruan që lëshonte trokëllimën e takave.

«Mbase pret gruan», — thashë me vete.

— Ulu, — tha Xhezari, — përse qëndron më këmbë?

— Do të ulem, — i thashë, — por erdha vetëm për pak. (Unë vendosa të qëndroja derisa ai të më sqaronte atë fjalëzën «eh».)

— Domethënë je shumë mirë. — tha prapë Xhezari. — Kam dëgjuar dhe gëzohem.

— Unë asnjëherë nuk kam qenë keq, — përsërita.

—Po, po, atje je shumë mirë, — tha Xhezari, — ndërsa tek ne nuk ishe dhe aq mirë, po shpëtove.

Jashtë u dëgjuan disa taka, ai zgjati kokën në dritare dhe u mundua të zhbironte reflektimin e dritës në xham.

— Si e ke gruan? — i thashë.

— Çka, e kam lënë në shtëpi. Bënte ftohtë dhe ajo deshi të rrinte në shtëpi me vajzën.

Ai u mbështet në kolltuk dhe unë vura re se fytyra i kishte marrë një pamje të mërzitur. Ishim pothuajse moshatarë, por ai dukej shumë më i madh. Unë këtë e vija re në të gjitha lëvizjet e tij të plogëta e pa gjallëri dhe më vinte çudi: përse një burrë aq i ri më dukej si një plak i ushqyer mirë dhe pa thinja? Unë nuk i kam mbushur të tridhjetat dhe kam dy fëmijë.

Ne qëndronim ballë për ballë me pamje të ndryshme. Ai dukej shumë i mërzitur dhe unë vesh-troja me kujdes lëvizjen e plogët të kokës së tij të madhe.

— Po të ishe akoma te ne, nuk do të kishe ecur kaq përpara, — tha Xhezari.

— Nuk të kuptoj, — i thashë.

— Nuk do të kishe ecur, — tha ai. — Te ne të marrin frymën.

...Dikur punonim në të njëjtin sektor. Xhezari kishte ardhur një vit më parë se unë, por shpejt kuptova se ai kishte mbetur në vend. Njohuritë e tij ishin shumë të pakta për nivelin e punës që bë-

nim, por unë vura re se ai nuk përpiqej të thëllonte dhe të përvetësonte të dhënat e reja të profesionit. Megjithatë, të tjerët thoshin se ai punonte shumë një vit më parë. Ndryshimi ndodhi vetëm si u largua për disa kohë. Unë kryeja punën time dhe të tijën njëkohësisht dhe e kuptoja se kjo ishte shumë e vështirë. Ai u kthye përsëri dhe vuri konditën që të mos merrej më me punën e parë. Ngula këmbë që ta merrnim edhe për ndonjë punë tjetër. Ne kishim shumë nevojë për kuadro. Po shpejt nisa të kuptoja se kisha bërë gabim. Ai kishte më pak njohuri se secili nga ne. Përdorte ca forma pune që i kishte parë a dëgjuar nga të tjerë, dhe mendohej t'i servirte sikur i kishte sajuar vetë. Ishin ca imitime, që në vështrimin e parë të bënin të mendoje se kishe të bëje me një njeri me njohuri të thella, por kjo nuk mund të zgjaste shumë dhe një njeri i pregatitur e kuptonte se kishte të bënte me ca imitime bajate. Megjithatë ishte vonë, Xhezari kishte mundur të krijonte një opinion të mirë për vete dhe u caktua të zëvendësonte shefin e sektorit...

— Ty, megjithatë, të ka ecur, — i thashë.

Ai vështroi nga dritarja dhe u mundua të dallonte kalimtare në lëvizte në rrugën e ftohtë.

— Të ka ecur, — i thashë, — të ka ecur në kuptimin fjalë për fjalë të të ecurit.

...Punonjësit e vjetër të sektorit tonë u transferuan në sektorë të tjerë dhe mbetëm vetëm ne të rinjtë. Shefi i vjetër kishte arritur të na mësonte gjithë anën profesionale të punës dhe ne nisëm ta ndienim veten të aftë për të ecur me këmbët tona. Shefi i vjetër më donte dhe ma vlerësonte punën, por edhe atë e donte. Ishte e çuditshme,

po më vonë unë kuptova se ka edhe njerëz që dinë të krijojnë një opinion të mirë për veten. Ai kishte nuhatur se do të bëhej qarkullim kuadri...

Xhezari vështrroi edhe ca nga dritarja dhe u kthye nga unë.

— Si the? — më pyeti.

— Të ka ecur, — i thashë.

— Eh! — ia bëri përsëri duke lëvizur dorën në mënyrë të papërcaktuar. Tjetri u mundua të kuptonte lëvizjen e dorës. Koka e tij e madhe binte çuditërisht në sy.

Xhezari më hodhi një vështrim të shpëlarë...

...Shefi ynë i vjetër dhe i thinjur arriti ta përsoste sektorin tonë, por u detyrua të largohej, se iu besua një sektor tjetër më i rëndësishëm. Ai ishte komunist. E dinte se vështirësitë e reja do ta lodhnin, po, si na përqafoi të gjithëve, u largua duke na uruar punë të mbarë. Sektori i ri ishte në të njëjtën ndërtesë dhe unë munda të vija re vullnetin e hekurt dhe ndërgjegjen e shefit të vjetër. Në kokë nuk i kishte mbetur asnjë qime e zezë, megjithëse ishte vetëm 45 vjeç, por, ama, ai organizoi përsëri një sektor shumë të mirë. Unë kisha respekt të jashtëzakonshëm për shefin dhe për punën që ai bënte pa u kursyer.

Xhezari zëvendësonte shefin e vjetër. Puna nuk shkante si më parë, nisën të rriteshin pretendimet për thjeshtësimin e punës dhe për shtimin e kuadrit. Shumë procese ai i quajti të vjetëruara. Edhe unë kisha filluar të ndieja lodhje, sepse akoma kryeja punën e dy vetëve. Nisa të shndërroheshin dalngadalë në një mekanizëm dhe ndieja se po nxirrja një punë shtampë dhe me pak gjëra të reja. Papritur një pjesë e kolegëve nisën ta ndienin ve-

ten ngushtë dhe të kuptonin se diçka nuk shkonte mirë, ndaj kërkuan të largoheshin.

— Duhet të largohesh, — më thoshin. — Shko në ndonjë sektor tjetër. A nuk e sheh se nuk mund të bësh përpara me njohuritë e tua dhe po shndërrrohesh në mekanizëm?

— Unë duhet të gjej arsyen, — u thosha.

— Nuk mund ta gjesh, — më thoshin. — Xhezari ka mundur t'u mbushë mendjen të tjerëve se ti nuk ke aftësi dhe se mund të bësh vetëm atë që bën. A e di ti se punën tënde ai e quan të pakualifikuar?

Unë i vështroja me habi.

— Kjo është e pabesueshme, — thosha.

— Po duhet ta besosh, — më thoshin. — Ai e quan pikërisht të pakualifikuar dhe u ka mbushur mendjen të tjerëve se ai vetë është i përgatitur mirë dhe zor se mund të ketë ndonjë tjetër këtu si ai.

— Oh, po kush e beson këtë budallallëk?! — thosha unë.

Xhezari kishte mundur të sillte në sektor disa njerëz që e donin. Shokët e mi mendonin se ata ishin të paaftë. Më në fund mua më kërkuan në një sektor tjetër dhe e kuptova se po më hiqnin qafe me mirësjellje dhe se kjo, po të shihej me syrin e shokëve të mi, kishte të bënte pikërisht me vendin e zëvendësshefit...

Unë vendosa të ngrihesha, por ai përsëri lëshoi atë fjalëzën «eh!»

— Ç'do të thuash me këtë «eh»? — thashë.

— Nuk na kuptojnë, — tha ai.

— Nuk të kuptoj.

— Mua, — tha ai, — më trajtuan keq.

— Prapë nuk të kuptoj, — i thashë me një zë të ftohtë.

— E, o, nuk më lënë rehat.

— Aha! — bëra i habitur.

Unë kisha mbetur ballë për ballë me të.

— Nuk na lënë rehat, — tha prapë ai. Nuk dukej fare i shqetësuar. — Se nga dalin ca njerëz dhe nuk duan të na lënë rehat.

E dija se një ditë do të ndodhesha ballë për ballë me të.

E vështrova gjatë këtë njeri. E vështrova në heshtje, po përbrenda ndieja se po më lindnin mendime, në fillim pa ndonjë formë të përcaktuar, pastaj në një rrymë të vrullshme, shumë të qartë dhe që më kujtonin jetën time.

...Xhezari arriti të bëhej zyrtarisht shef. Ai u martua, bëri një fëmijë, i ngritën disa herë rrogën, mori një apartament të bukur, megjithëse shumë të tjerë qëndronin në hotel dhe... dhe megjithatë mendohej të injoronte aftësinë dhe punën intensive të shumë punonjësve të sektorit, të cilët kishin nisur ta vështronin ftohtë. Ata e kishin kritikuar me durim, e kishin nxitur të punonte dhe të krijonte. Dhe ai krijoi: krijoi opinione për të gjithë, krijoi dhe një apartament të rehatshëm, gjysmë të errët, që ndriçohet nga dritëza artificiale, po rrallë nga dielli, krijoi dhe një fëmijë, natyrisht edhe një rreth miqsh hipokritë, dhe e ndiente veten mirë. Mendimet nisën t'i lëviznin në ato që i mungonin dhe në punën e tepërt, prandaj kërkoi të emërohej zyrtarisht edhe një zëvendësshef, po këtë nuk ia pranuan...

Si ishte vallë ajo puna e keq trajtimit? Ai nuk ishte armik, oh, unë e dija se ai nuk ishte armik,

ai kishte qenë një njeri i thjeshtë, po tani kishte nisur të ndërlikohej në rehatinë gjysmë të errët të apartamentit të tij.

— Përse s'të kuptojnë? — e pyeta.

Ai më vështroi si i habitur. Natyrisht, ishte fare e lehtë të kuptohej se përse ai e ngrinte fort zërin, alarmohej, mbase edhe kishte ulërirë, ishte fare e lehtë edhe të kuptohej ndjenja e tij qesharake. Por unë nuk e kuptoja se përse ua thoshte të tjerëve, përse më fliste edhe mua me këtë gjuhë, megjithëse e dinte se ne nuk do të ishim kurrë miq.

...Në sektorin tjetër iu përvesha punës si gjithnjë. Ndieja se forcat po më përtëriheshin dhe dalngadalë nisën të shkruanin edhe gazetat për specifikën e punës sime. Të gjithë thoshin se unë kisha ecur përpara dhe më shihnin me admirim. Por unë përsëri kisha mbetur i zakonshëm, pa asnjë post, dhe sipas mënyrës së tij të të vlerësuarit nuk duhej të kisha ecur përpara...

I qëndroja përballë me një vështrim të qetë në dukje, po përbrenda sytë më digjnin. Ai tha me zë të mekur:

— Nuk duan të më japin televizor, — dhe mori një pamje si për të ardhur keq.

Nata e ftohtë i bënte xhamat të kërkëllinin dhe takat në asfalt e bënin atë të mundohej të dallonte kalimtarët. Ndërsa unë e vështroja gjatë dhe në heshtje, me një dëshirë që ta rrëmbeja dhe ta flakja jashtë në rrugë. Me atë mënyrë të foluri më bënte të kujtoja gjithë jetën time, që kur linda dhe deri tani, pa i mbushur të tridhjetat dhe me dy fëmijë, më bënte të kujtoja jetën e gjithë moshatarrëve të mi.

...Jeta ime dhe e moshatarëve të mi nisi kur baballarët tanë po fitonin revolucionin.

Baballarët tanë, punëtorë të thjeshtë, fshatarë, ministra, udhëheqës të partisë, baballarët tanë komunistë, me fytyra plot vragëza mavi nga ciflat e predhave, me duar të fuqishme, shumë të fuqishme, mbanin fort pushtetin e revolucionit, e mbanin me dhëmbë, me thonj, e mbanin me gjak dhe me barut, e mbanin dhe e siguruan njëherë e mirë.

Dhe baballarët tanë na rritën ne...

Ne nisëm të rriteshim, në fillim të zbathur dhe pastaj me sandalet e nënës. Unë nuk do t'i harroj kurrë sandalet e nënës. Jashtë binte dëborë dhe unë duhej të dilja, të shkoja në shkollë. Atëherë ne kishim nisur të venim në shkollat e socializmit. Natyrisht, duhet të qëlloja edhe vajzat me toptha dëbore, por nuk kisha këpucë. Nuk kishte as Gimë, as Timë, as Vera, as Luli, as Beni, as Tili... (kështu na kishte gjetur Çlirimi), por ata kishin dalë jashtë dhe ma bënë me shenjë. Në dëborë nuk kishte si të dilja zbathur. Atëherë vura re se ata kishin veshur sandale grash. Nëna ime kishte vetëm një palë sandale, unë iu luta dhe ajo m'i dha pa bërë fjalë fare. Dola jashtë me sandalet e nënës dhe këmishën e babait. Jashtë binte dëborë dhe bënte ftohtë, por unë nuk e ndieja, askush nuk e ndiente.

Baballarët tanë na vështronin nga dritaret, por ne as që e merrnim me mend se në gjithçka tonën, bile edhe në lojërat, ata vështronin të ardhmen...

Njëzet vjet më pas unë ndodhesha ballë për ballë me një njeri që kishte harruar shumë gjëra dhe çirrej se e kishin persekutuar.

Xhezari kishte filluar të ndiente habi nga hesh-tja ime.

— Për vajzën më pyete? — tha pastaj, (Unë nuk e kisha pyetur për vajzën). — Aha, rritet mirë; ç'të bëjë, se mos ka telashe. Ne kemi telashe. Asaj i pëlqejnë shumë biskotat 30-lekëshe dhe nuk ha bukë fare. Eh, kur s'jemi prapë fëmijë!

Unë nuk mund të mos kujtoja jetën time dhe të moshatarëve të mi.

...Unë, Gimi, Timi, Vera, Beni, Tili... ngriheshim që në katër të mëngjesit dhe zinim radhën në dyqanin e bukës. Bënte ftohtë dhe nuk ishte gdhirë, por ne rrinim në radhë njëri pas tjetrit, pas dhjetëra të tjerëve. Atëherë bukën e merrnim me triska. Kur shkonim në shkollë, merrnim vetëm një fetë me sheqer dhe me ujë, ose e hanim me «dhëmbë».

Nganjëherë na qëllonte të shkonim që në darkë dhe i luteshim shitëses të na jepte bukë me triskën e së nesërme, sepse nuk na kishte mbetur asnjë thërrime.

— Hë, moj Aso, do të na japësh?

— Ja pra, prisni dhe pak, — ajo na vështron-te ngrohtë. Por ajo kishte frikë se mos buka nuk i mjaftonte për ata që kishin triskat e asaj dite.

Ndërsa tani vajza ime nuk e di se kujt i thonë triska («Ato të druve babi?») dhe ha bukë njëzet herë në ditë. Vajza e tij nuk e pëlqen bukën, po ha biskota. Ne atëherë nuk e kishim mësuar në shkollë fjalën biskotë.

Ne luanim para dyqanit të bukës derisa Asoja na thërriste:

— Ejani, djema, më mbetën vetëm dy bukë.

— Po si t'ia bëjmë, moj Aso?

— Të marrin vetëm dy dhe t'u japin hua të tjerëve.

Ne ishim fqinjë të mirë dhe ashtu bënim...

Ndërsa ai e kishte harruar fare këtë lloj buke, megjithëse edhe vetë mund të kishte mbajtur radhë deri në mbrëmje.

...Baballarët tanë na vështronin nga dritaret kur ktheheshim me bukë në dorë netve të ftohta. Dhe baballarët tanë që nuk e kishin fshirë ende djersën nga puna e ditës, na lëmonin flokët me dhëshuri dhe dilnin jashtë. Jashtë bënte ftohtë, bënte shumë ftohtë, por ata dilnin. Mbase venin fshatrave, mbase maleve, se nga venin atëherë ne nuk e kuptonim, po dalngadalë rrobat tona u bënë më të trasha, këpucëve tona nuk u hynte më ujë, dhe ajo që kishte më shumë rëndësi, në dyqanin e Asos kishte shumë bukë dhe ne nisëm të mos hanim më vetëm një fetë me sheqer dhe me ujë, apo me «dhëmbë»...

Socializmi po ngrinte mirëqenien e të gjithëve...

Ne qëndronim përballë njëri-tjetrit dhe unë mundohesha t'u hyja thellë mendimeve të tij të paktueshme. Dhe kujtimi i jetës sime nuk më ndahej.

... Ishte festë. Ne luanim si të çmendur nga gëzimi me topa (topat prej rrecke nuk i preferonim më), ishin dy-tre topa llastiku, nuk më kujtohet se sa (tani vetëm vajza ime ka nja tre a katër topa plastmasi, ndërsa vajza e tij dhjetëra lodra). Spektatore kishim vetëm ca vajza të vogla. Ah, harrova, kishim edhe teto Faton. Ajo ishte nëna e një ministri. (Zakonisht udhëheqësit ne i quanim ministra). Teto Fatoja vinte gjithnjë në oborrin tonë, merrte një punëdore me vete dhe bënte muhabet me nënat. Ato e kishin bërë zakon të bënë kafe me radhë për të gjitha dhe unë vija re se kënaqeshin shumë kur rrinin bashkë. Kështu ndodhi edhe kur prindërit u

kthyen nga festa dhe ne i rrethuam si qingja. Prindërit ndenjën me teto Faton. Unë dëgjova kur dikush pyeti:

— Të kujt i ke ato çorape, moj teto Fato?

— Të djalit — tha ajo.

— Ee, — u habita unë, — pse mbajnë ministrat çorape me andra?! Me andra mund t'i mbajnë vetëm fëmijët!

Teto Fatoja vuri buzën në gaz, edhe prindërit vunë buzën në gaz, po ne picërruam sytë dhe u munduam t'i kuptonim. Përse qeshën ata? Unë pyeta:

— A nuk ka çorape të reja djali yt?

— Sigurisht, ka, — tha teto Fatoja. — Për festë ka të reja, për punë mban këto. Sot që është festë ai mbathi të rejat dhe unë po ja androj këto.

Ndjeva dorën e babait, ndjemë duart e baballarëve që na u mbështetën në supe.

— Mos e harroni këtë!

— Nuk do ta harrojmë, — thamë ne. Në të gjithë këtë pamje kishte diçka që ne nuk e kuptonim, por që duhej ta mbanim mend, sepse një ditë do të rriteshim dhe do ta kuptonim.

Dhe ne u rritëm. Unë, Agimi, Shpëtimi, Vera, Luljeta, Arbeni, Sotiri... u ndamë. Unë di se Agimi është në Laç, inxhinier, Shpëtimi diku në Myzeqe, Vera në Kombin, Luljeta në Fierzë, ka tre fëmijë, Arbeni ka shkuar në Kinë për Kombinatin Metalurgjik; ndërsa Sotiri... ku është Sotiri? Ah, ai është marinar. E ç'rëndësi ka? Ata janë kudo, të shëndetshëm, të bukur, të dashur dhe të mirë. Dhe natyrisht, kudo që janë e ndiejnë veten mirë.

Sikur të vendosej të dërgohej për të ngritur nivelin e jetesës në fshatin e tij të lindjes, padyshim Xhezari do të niste të ulërinte. Unë mendova shefin

tonë të vjetër. Ai e dinte se në sektorin e ri do të kishte aq punë, sa mund të kishte pasur gjatë disa viteve bashkë, megjithatë iku të organizonte sektorin e ri, pa thënë asnjë fjalë, duke menduar se atje ku e dërgonin ishte i domosdoshëm. Ndërsa ky fliste lart e poshtë se «e trajtonin keq» ngaqë nuk i kishin dhënë televizor, të cilin me siguri do ta merrte pas disa muajsh.

Tani që u ndodha ballë për ballë me Xhezarin, desha t'i kujtoja atij se nuk ndodhej vetëm me mua ballë për ballë. Unë i thashë:

— Si është puna e atij televizorit?

— Punë dreqi, — tha ai dhe u kthye nga tjetri. Tjetri nuk tha asgjë, po priti në heshtje. — ...

— Nuk të kuptoj, — i thashë.

— Ja pra, nuk duan të ma japin.

Unë e dija si ishte puna e atij televizori. Ai u kishte folur njerëzve për të drejtat e tij që po ia merrnin nëpër këmbë. «E drejta» e tij kishte marrë forma të çuditshme, forma pa formë dhe ai ishte munduar të krijonte një rreth njerëzish që do të tundnin kolektivin që t'i jepte «të drejtën» e tij, televizorin, sepse vetëm televizori i mungonte dhe se ai i duhej për... për... i duhej «për argëtimin e vajzës së tij, që nuk i kishte mbushur të dy vjetët».

Jashtë u dëgjuan taka dhe Xhezari nuk harroi të hidhte sytë përtej xhamave. Unë i thashë:

— Mos kanë vendosur të të futin në burg? — dhe ia ngula sytë fort. — Apo duan të të çojnë drejt-përdrejt në prodhim?

Ai ia plasi të qeshurit. Ishte një e qeshur e neveritshme, hipokrite dhe e mbushur me frikë.

— Jo, more, jo, — tha si i shkujdesur. — Duan të mos më japin televizor.

— Dhe për këtë thua se të trajtojnë keq?

— Sigurisht, përse do të thosha tjetër? Kisha shumë shpresë... po ja, kolektivi... vendosi t'ua japë dy pleqve vetëm sepse ata kanë në institucionin tonë që me krijimin e tij, dy pleq të cilëve as ka ç'u duhet, sepse së shpejti dalin në pension, dy njerëzve që nuk janë ndier ndonjëherë. Ata asnjëherë nuk kanë kërkuar ndonjë gjë, e nga na dolën tani për t'u prishur punë të tjerëve?! — Dhe lëshoi në adresë të tyre një sharje të ndyrë.

Unë ia kisha mbërthyer sytë dhe mundohesha të zbuloja në fytyrën e tij të shëndetshme diçka të mirë, por ajo s'dukej gjëkund. E kuptoja se ai donte t'i flisja dhe t'i qaja hallin; në kolektivin e tij unë kisha influencë dhe ai diç shpresonte. Unë e dija se kolektivi kishte vendosur të merrej ndryshe me të, por, me sa dukej, ai ende nuk e kishte kuptuar.

— Je një njeri i nevertishëm, Xhezar. Je bërë i neveritshëm. — Tjetri më vështroi me habi, ndërsa Xhezari përdrodhi turinjtë. — Ti ke qenë një njeri i thjeshtë dhe, meqë t'u dha dora, si të gjithëve, i harrove të tjerët dhe e ngrite «unin» tënd mbi ta. Ti harrove të tjerët, ti harrove interesin e përgjithshëm dhe u katandise në mikroborgjez.

Unë më në fund ndjeva një lehtësim të pakuptueshëm përbrenda, ndërsa ai më vështroi me habi dhe frikë.

— Ti je bërë edhe rrufjan, — i thashë. — Por mos pandeh se uji kalon gjithnjë nën rrogoz. Mos harro se ne e kemi përvetësuar mirë edhe paragrafin e «xha Emrushit».

Ai ishte zverdhur dhe mundohej të më ndërpriste.

— S'ke ç'thua, — i thashë. — Që në fillim u mundove të përvetësosh gjithçka dhe, në vend që të

jepje gjithçka për interesin e përgjithshëm, e shqel-
move atë. Ç'nevojë mund të ketë shoqëria për një
njeri të tillë?

Jashtë përsëri trokëllitën taka, por ai nuk e ngri-
ti kokën, qëndronte i stepur nën vështrimin tim të
egërsuar.

**N Ë M E S N A T Ë
K U R F L I N T E
Q Y T E T I**

Maku ndjeu derën që u hap përgjysmë dhe ndoqi me kureshtje hijen që rrëshqiti pa zhurmë dhe diç nisi të kërkonte nëpër mur.

«Me siguri çelësin e dritës», tha ai me vete, po nuk lëvizi nga shtrati.

Me sa dukej, hija nuk e gjeti atë që kërkonte, dhe u drejtua në heshtje nga shtrati. Atë çast Maku dhe hija u drodhën. . . po ndodhte «mrekullia» e fundit e Makut. Nisi të binte zilja e orës dhe në dhomë filluan të ndizeshin dhe të shuheshin dy drita të forta. Maku u hodh nga shtrati, ndërsa ai që hyri kishte mbetur i shtangur në mes të dhomës, si të qe zënë në faj, po shumë i tronditur dhe i shqetësuar. Më në fund u ndez drita e madhe dhe dhoma llamburiti. Atëherë Maku tha me zë të qetë:

— Qenke shumë i përpiktë, baba.

Tjetri, i tronditur dhe i inatosur, bëri një çap përpara.

— Kur do t'i lësh këto xhugulima, — i tha me zë të hakërryer.

Atij iu desh një copë herë derisa të qetësohej. Makut i pëlqente gjithnjë të «shpikte» ndonjë gjë dhe

dhoma e tij u nënshtrohej marifeteve nga më të çuditshmet. Këtë radhë ai kishte menduar të sajonte një mjet të sigurt për t'u zgjuar nga gjumi. Ai kishte bërë një instalim të ziles së orës me dy drita të forta që i binin mbi shtrat, dhe, sa herë binte zilja, ato ndize-shin e shuheshin pa ndërprerje.

— Shpikja ime zgjon dhe të vdekurin, — tha Maku. — Tani mund të them me bindje se do të jem gjithnjë i përpiktë në orar.

— Po, — tha i ati, — po të gjallin e bën t'i pushojë zemra. Nga e psonise një marifet të tillë?

Maku i tha se ia kishte treguar një specialist i huaj dhe i ati u ngrys në fytyrë. Mori të dalë, por u kthye menjëherë dhe i tha:

— Nga ata specialistët e huaj ki mendjen. Gjithnjë na kanë nxjerrë punë ata.

Maku hëngri darkë me nge, mori me vete një pako që ia kishin përgatitur për më vonë, dhe doli në rrugë. Qyteti flinte i qetë. Ai gjithnjë seç ndiente kur dilte natën në rrugë dhe e gjente qytetin në gjumë. Nata reflektohej në asfalt me dritat e vitrinave dhe ai ecte qetë-qetë, duke dëgjuar trokitjen e hapave të vet. Nja dy kilometra larg qytetit ngrihej uzina. Ajo ishte një uzinë gjigande, moderne dhe kohët e fundit kishte nisur prodhimin. Maku e dinte se ndërtimi i saj kishte kushtuar shumë. Qyteti kishte qenë fare i vogël dhe vetëm me ndërtimin e uzinës nisi të rritej në mënyrë të vrullshme. Maku gjithnjë habitej me forcën e madhe rritëse të uzinave.

Natën qyteti dukej i zbrazët, shumë i madh dhe kur ecte nëpër rrugë, i lindnin ndjenja të pakuptueshme. Ai e donte edhe uzinën, edhe qytetin

Makut iu kujtuan fjalët e të atit.

Specialistët e huaj erdhën që kur nisi montimi. Maku i kishte vështruar fytyrat e tyre të qeta dhe kur kishin zbritur nga autobusi: ata kishin një pamje fodulle dhe të ftohtë. Maku ishte munduar të gjente me mend se ç'ishin në gjendje të bënin ata, sepse në fakt ai kurrë nuk ishte marrë me makineritë e uzinës. Midis grupit të parë të specialistëve i kishte mbetur në mendje një fytyrë e gërryer dhe aspak njerëzore, e vendosur si pa dëshirë mbi një shtat vigan dhe të fuqishëm. Atëherë ai ishte lutur me vete që të mos e caktonin të punonte me të. Por ai ishte pikërisht specialisti me të cilin u caktua të punonte, dhe prej tij duhej të mësonte përdorimin e makinerive. Atë e quanin G. dhe ishte nga një vend i madh imperialist.

Makut iu kujtua edhe specialisti A; edhe ai ishte nga një vend imperialist, por ishte punëtor dhe shumë i afruar e i thjeshtë. Ai vinte i shkurtër, me pak bark dhe punonte me Faikun. Nganjëherë rreth tij mblidheshin punëtorët dhe ia fillonin muhabetit. Ai i mësoi Makut edhe atë marifetin me drita. Ai punonte shumë dhe punëtorët e nderonin punën e tij. Vetëm se Faiku nganjëherë ia varte punës dhe atëherë specialisti A. e qortonte me fjalë të vrazhda. Njëherë ata u shkulën gazit të gjithë. Faiku se nga ia kishte mbathur për ndonjë orë dhe, kur u kthye, specialisti A. e zuri nga jaka dhe i tha se do t'i thoshte padronit. Natyrisht, ia tha vetëm për ta trembur, po, kur vuri re se të tjerët ia plasën gazit, ai i vështroi me habi.

— Pandehni se nuk i them? — tha duke iu drejtuar Makut. — Oh, po ju nuk paskeni frikë! A nuk ju pushojnë po të mungoni në punë?

— Po ne nuk kemi padronë, — i tha pa të keq Maku.

— Atëherë keni mbikëqyrës, — tha me habi specialisti A. — A nuk vë shteti juaj mbikëqyrës?

— Jo, — tha Maku, — ne nuk kemi mbikëqyrës. Ata që sheh, janë vetëm drejtues e jo mbikëqyrës. — Maku e vështroi duke vënë buzën në gaz.

— Po si i bëhet hallit me këtë? — ai tregoi Faikun. — Po të qe në vendin tim, këtë e flakin në mes të rrugës. Kush i kontrollon këta?

— Ne, — tha Maku, — kolektivi. Eja në një mbledhje të kolektivit dhe do të shohësh se do ta bëjmë për ujë të ftohtë, pa qenë nevoja të flaket në mes të rrugës. Tek ne nuk e flakin punëtorin në mes të rrugës.

Makut i pëlqente specialisti A. Sigurisht, ai nuk dinte shumë për organizimin e jetës dhe të ekonomisë në këtë vend, por i vinte mirë që njerëzit nuk e ndienin kamzhikun e padronit.

Faiku ishte i ri çapkën dhe nuk ishte mësuar me disiplinën e punës, prandaj specialisti i tha se do ta shtronte çështjen në kolektiv. Faiku ishte zverdhur, ndërsa i huaji kishte mbetur shumë i kënaqur.

Specialisti G, me të cilin punonte Maku, ishte krejt ndryshe. Ai ishte i ftohtë, fare i huaj dhe fjalët i kishte të kursyera. Makut nuk i pëlqente aspak, po sillej mirë dhe mendohej të mësonte ndonjë gjë që nuk e dinte. Gjatë gjithë kohës specialisti G. nuk u tregua asnjëherë i afruar me Makun...

Maku voziti në mendime derisa hyri në oborrin e madh të uzinës. Atje ishte një botë tjetër, uzina merrte frymë thellë dhe nëpër rruginat që lidhnin

korpuset, shfrynin tubacionet e ajrit e të gazit dhe Maku kënaqej. Mëngjeseve, kur linte turnin, ai vështronte oxhakët dhe kullat e larta që villnin tymra shumëgjyreshe, dhe ngazëllehej. I dukej sikur shih-te qindra oxhakë që villnin tym, i dukej sikur ata lëkundeshin si në valle nën një ritëm të gëzuar dhe kjo donte të thoshte se nëpër atdhe gjithçka shkonte mirë.

Ai mendoi përsëri «shpikjen», të atin, specialistin G. me pamjen e tij të ftohtë dhe vigane, me atë fytyrë antipatike, si një patate e rrjepur, dhe mendoi se nga ai nuk kishte mundur të mësonte dhe aq shumë. Me vete tha se specialisti G. duhej të ishte tip flegmatik. Vërtet kaq të neveritshëm janë flegmatikët?

Maku u drejtua në garderobë dhe, si u vesh me rrobat e punës, mori në dorëzim turnin. Specialisti G, me sa dukej, nuk kishte ardhur ende në atë repart.

«Duhej të kishte ardhur», tha Maku me vete.

Ai nisi të kontrollonte aparatet, kolonat e gazit dhe pas një copë here ishte i mendimit se gjithçka shkonte në rregull. Nata e qetë gërvishej herë pas here nga fishkëllimat e tubacioneve që shkarkonin, dhe ai mundohej të përcaktonte me mend vendin dhe sasinë e shkarkimit.

«Megjithatë, specialisti G. duhej të vinte, — tha me vete. — Mos ka ndodhur ndonjë avari?» Maku e mendonte si të natyrshme që në një uzinë, e cila sapo nis nga prodhimi, avaritë të jenë të shpeshta.

— Ç'thonë punët Maku? — Maku u kthye me rrëmbim dhe pakëz i tronditur.

Në repart kishte mbirë papritur një njeri. Ai ishte një djalë i gjatë dhe i veshur me rroba punëtori dhe Maku e vështrroi me dyshim. Ç'kërkonte

Seiti në repartin e tij? Ai gjithnjë e kishte parë atë djalë të gjatë nëpër repartet e korpuseve të uzinës, megjithatë nuk mund të thoshte me siguri se ç'profesion kishte ai. Maku e njihte dhe nganjëherë kishte bërë muhabet me të, po jo aq shumë sa t'i vinte pa pritur, në mes të natës. Kohët e fundit tek ai kishte vënë re diçka të çuditshme. Seiti shfaqej papritur aty ku s'e merrje dot me mend, vinte pa rënë fare në sy dhe humbiste po aq papritur dhe pa rënë në sy.

— Edhe ti turnin e tretë ke? — pyeti Maku me djallëzi.

— Po, — tha ai, — turnin e tretë. — Ai vuri një cigare në gojë dhe Makut iu duk sikuri vuri edhe buzën në gaz. — A ke shkrepëse?

Maku ia ndezi dhe ai i zgjati edhe atij një cigare.

Vërtet, ç'kërkonte Seiti në atë orë në repartin e tij?

— Nuk paska specialist të huaj në repartin tënd? — pyeti Seiti.

— Ka, — tha Maku, — është specialisti G.

— Aha, ai hipopotami! E nga na qenka?

— Nuk e di, — tha Maku, — mbase është në repartin 204.

— Po reparti ngjitur nuk ka punëtor turni?

— Jam unë, — tha Maku. — Një njeri mund t'i kontrollojë të dy fare mirë.

Maku vendosi t'i hidhte një sy repartit tjetër, ai ishte një repart më i vogël dhe me më pak aparate. Kur u kthye, Seiti ishte zhdukur, si gjithnjë papritur, dhe as që mund ta merrte me mend se ku mund të kishte shkuar. Vetëm bishti i cigares ishte shuar në dysheme, si të kishte dashur të linte gjur-

mën e fundit. Maku nuk e vrau më mendjen dhe vajti në repartin ngjitur për të kontrolluar gjithçka me imtësi. Brenda tubacioneve ndjeu një lëvizje të vrullshme dhe u kënaq. Ishte mesnatë. Larg, qyteti flinte. Edhe i ati me siguri flinte, natyrisht pasi të kishte «studjuar» me imtësi «shpikjet» e tij të fundit. I ati ishte një mjeshtër i vjetër dhe, ndonëse inatosej me shpikjet e të birit, nuk e pengonte kurrë. Pse iu kujtua përsëri i ati? Maku nuk e gjeti dot pse.

Iu bë sikur dëgjoi përsëri hapa...

«Vërtet ç'kërkonte Seiti në repartin e tij, ë?»

Hapat u dëgjuan afër, diku në drejtim të reparatit tjetër. Ai shoi cigaren në pëllëmbë të dorës, dora i dogji, por ai e duroi në heshtje. Hapat ishin të gjatë dhe shumë të kujdesshëm.

Maku vuri re një hije. Megjithëse «hija» nuk mund ta shikonte, ai u fsheh pas një kolone. Hija ecte me kujdes, nëpër vende të errëta dhe duke shikuar rreth e rreth. Kjo e vuri Makun në dyshim. Ishte mesnatë dhe dëgjoheshin vetëm fishkëllimat e tubacioneve të shkarkimit. Hija u shkri me errësirën dhe Maku mendoi se atë mesnatë jo gjithçka shkonte mirë. Ajo hije nuk endej kot nëpër errësirë. Maku mendoi se edhe nëpër repartet e tjera kishte punëtorë, të cilët me siguri nuk i kishte zënë gjumi. Befas u shfaq në vendin e mëparshëm gjithnjë duke lëvizur me kujdes dhe duke vëzhguar.

Maku e kuptoi: ajo hije po vinte rrotull korpusit të tij. Në ç'repart donte të futej vallë?

Maku ishte një punëtor i qetë, shumë i zgjuar, nuk i pëlqente të grindej me njeri, madje as që ishte shquar ndonjëherë për trimëri. Megjithatë natyra e tij e qetë i bënte punëtorët e tjerë ta donin dhe të ndie-

nin respekt për të. Ai vinte mesatar nga shtati, jo shumë i shëndoshë. Ishte gjithnjë i kujdesshëm dhe mësonte me pasion gjithçka që nuk e dinte, por që mendonte se i hynte në punë.

Tek e ndiqte në errësirë me sy atë hije, ai harroi shumë gjëra, harroi shokët, të atin, shpikjet. Ai harroi edhe natyrën e tij të qetë dhe ndjeu se ishte bërë shumë nervoz.

«Ç'kërkonte ajo, ë?»

S'kishte pse dyshonte më: ajo hije kishte një qëllim, por se çfarë, Maku nuk e merrte me mend.

«Do ta përgjoj me kujdes», — tha me vete. Ai u ngjit në një kolonë të lartë nga mund ta vëzngonte më mirë dhe vuri re se hija po i afrohej repartit ngjitur. Ajo kapërceu me të shpejtë pjesën e ndriçuar të hyrjes dhe i humbi nga sytë.

«Ja kush na qenka!» — tha ai me vete i habitur.

Maku më në fund e kishte njohur hijen. Ajo vinte e gjatë dhe për çudij shumë e shkathët.

«Po ç'kërkon të bëjë? — tha me vete. — Ç'mund të bëjë në atë repart?»

Ai ndjeu se po dridhej nga ankthi dhe shqetësimi.

Nuk mund të bënte asnjë lëvizje; edhe sikur të thërriste me tërë forcën punëtorët e reparteve të tjera nuk do ta dëgjonin. Me mend thoshte se zëri do t'i ishte ngjirur nga ankthi, prandaj zbriti nga kolona dhe u fut me kujdes në repart. Po në repart nuk kishte njeri.

«Ku mund të ketë shkuar?» — tha.

Befas ai u drodh. Në vështrimin e tij u ngul si një përbindsh i rrezikshëm dhe shkatërrues kolona me hidrogjen. Ca minuta më parë ai ndiente një dashuri të veçantë për uzinën që sapo kishte nisur frymëmarrjen e saj ritmike, ndiente dashuri për çdo

tub, për çdo aparat, madje edhe kolonat e hidrogjenit i dukeshin shumë të dashura. Mirëpo ajo kolonë hidrogjeni tani zuri vend në vështrimin e tij si një përbindsh i hakërryer. Në pak sekonda ajo kolonë hidrogjeni mund të shndërrohej në një eksplozion shkatërrues vetëm duke mbyllur një saraçineskë. Si nuk i kishte shkuar ndër mend më parë?

Hija kishte mbyllur saraçineskën...

Ca minuta më vonë nuk do të kishte më uzinë, fuqia plasëse e kolonës ishte aq e madhe, sa në vendin e uzinës gjigande do të mbetej vetëm një varr i zi i stërmadh dhe i hapur.

«Ç'të bëj? ... Ç'duhet të bëj, ta hajë dreqi!»

Ai ndjeu se ishte hutuar nga tronditja, por megjithatë, lëvizi ngadalë drejt kolonës, pa pasur asnjë mendim dhe i mbushur me djersë të ftohta, duke pritur nga sekonda në sekondë shpërthimin...

A e dinin punëtorët se dikush kishte vendosur të hidhte uzinën në erë? Ajo ishte uzina e tij, uzina e tyre.

Maku vuri papritur duart mbi saraçineskë, sikur ajo të qe një qenie e gjallë që priste ndihmën e tij, dhe e hapi me shpejtësi. Pastaj u mbush me frymë dhe mendoi se uzina kishte shpëtuar. Mirëpo, kur ktheu kokën, vuri re se përballë i qëndronte hija, e ftohtë, e palëvizshme, si një qenie gjigante prehistorike, me një vështrim si të gjarprit. Tani ajo nuk ishte më hije, sepsë kishe dalë në dritë dhe kishte marrë tiparet e vrazhda dhe aspak njerëzore të specialistit të huaj G...

«Ky me siguri është vrasës!» i shkrepri një mendim Makut.

Specialisti G. iu afrua ngadalë, me një pamje të egërsuar, dhe qëndroi përballë punëtorit ashtu i gja-

të dhe i fuqishëm, me atë vështrimin e tij të ftohtë si të gjarprit.

«Përse ka ardhur këtu kjo kafshë? — tha Maku me vete. — Për t'i hequr kafshatën popullit tim?»

Maku e vështroi në heshtje duke ndier se po mbushej me një egërsi jo të zakonit. Mendime nga më të ndryshmet po i kalonin në tru me shpejtësi të habitshme.

Po nuk mundi t'i shtynte më tej mendimet, mbi trupin e tij të dobët u përplas një grusht i llahtarshëm dhe e plandosi përdhe.

— Ti nuk je specialist... Ti je një kriminel...

Grushti qëlloi përsëri dhe Maku e kuptoi se po humbte ndjenjat, po mendoj se tjetri do ta qëllonte derisa të mos merrte më frymë. Kolonat, oxhakët, kullat i dilnin para syve duke lëvizur sipas një ritmi të parregullt... sipas një ritmi nervoz, dhe i dukej sikur specialisti G. e qëllonte me një shufër metalike, duke ia plasur gazit. Ai ishte një gaz i çakërditur dhe rrëqethës, e qeshura kumbonte në hapësirë me nota tronditëse, e jashtëzakonshme dhe krejt e metaltë. Përsëri shufra metalike... oxhakët, kullat, kolonat; oh, ato nuk duhej të shpërthenin. Kolona nuk do të shpërthente... Shufra metalike... duart e ashpra të mijëra baballarëve duke rrëmuar në gërmadhat e luftës dhe duke ngritur themele uzinash... Dhe në duart e baballarëve një shufër metalike...

Ku e kishte parë Maku herë tjetër atë shufër metalike?

«Paskam humbur ndjenjat, — tha me vete. — Ngrehu, Mak! Vetëm sonte ty nuk të lejohet të humbasësh ndjenjat».

Ai u kujtua se, kur G. e qëlloi, ishte rrëzuar pikërisht mbi një shufër metalike. Tani G. po mbyllte

qetë-qetë saraçineskën. Ndërsa Maku, «shpikësi i xhug-ylimave», shtrëngonte në duar shufrën metalike. Ai ia veshi pa hezituar fare mu në kokë dhe specialisti shtatmadh, si një qenie prehistorike, u rrëzua përdhe. . .

Jashtë gjëmuan hapa të rënda, hapa shokësh të alarmuar. Maku nuk ishte në gjendje të kuptonte nëse ishin vërtet hapat e shokëve, po mendoi se duhej të bënte përpjekje të mundimshme për të hapur prapë saraçineskën. Ai po zgjatej, duke u dridhur nga mpakja e fuqive dhe duke ndier se agjenti i huaj, i fshehur nën maskën e një specialisti, po ngrihej prapë.

«Oh, ngrehu, — tha Maku me vete, — po nuk do të të lëmë të bësh asgjë. . . Nuk flemë ne, o specialist agjent, megjithëse zgjodhe mesnatën». . .

Repartit ishte mbushur me njerëz. Kur agjenti do të qëllonte përsëri, dikush i doli përpara dhe e she-mbi përdhe.

— Si e ndien veten, Maku? — Ai njohu Seitin dhe një valë e pakuptueshme ndjenjash i lëvizën në të gjitha qelizat. Ai kishte ardhur si gjithnjë papritur, po këtë radhë me një grup punëtorësh që tani ishin hedhur mbi agjentin.

— Ia bëre mirë, Maku, — i tha Seiti.

Makut nisën t'i ktheheshin fuqitë. Vërtet ai ishte ca si i hutuar, por e ndiente veten mirë dhe vësh-tronte punëtorët që e kishin mbërthyer fort agjentin dhe po e nxirrnin jashtë.

— Me siguri ke menduar se ç'desha unë në repartin tuaj në mesnatë, — i tha Seiti.

— Po, — tha Maku, — kam menduar.

— Tani e kuptove se përse, Maku, — i tha Seiti. Gjithçka kishte ndodhur në disa minuta dhe Makut i dukej se kishte parë ëndërr. Jashtë uzina merrte frymë thellë dhe tubacionet shkarkonin si gjithnjë me fishkëllimë. Ndërsa larg, atje ku qielli dukej i ndriçuar, ishte qyteti. Qyteti flinte i qetë. Maku përfytyroi rrugët e tij të zbrazura, nëpër të cilat reflektoheshin dritat e vitrinave dhe të neonëve, dhe vuri buzën në gaz. Në mëngjes ato do të mbusheshin me njerëz dhe ai do t'i përshëndeste si gjithnjë.

KORRIDORE NË PAFUNDËSI

Muzgu mbeti pas dyerve të mëdha dhe gazetari u gjend në një korridor të gjatë dhe të lartë, me mure ngjyrë qumështi. Megjithëse vonë, në korridor lëviznin njerëz. Ai u ul mbi një tryezë diku nga mesi i korridorit dhe vendosi të priste, duke u munduar të binte sa më pak në sy. Ishte ende i ri në moshë, po si gazetar kishte një përvojë të madhe. Kur nisej të shkruante diçka, bllokun e shënimeve e nxirrte në fund. Më parë futej mes njerëzve, pyeste, dëgjonte, mendohej ta vërtiste bisedën aty ku i interesonte atij dhe pastaj takohej me ata që i duheshin. Po këtë radhë ishte ndryshe. I duhej të shkruante për një grua. Atij i kishte qëlluar që, ndonjëherë, kur ishte fjala për një grua, edhe i frynin gjërat, por ishte mësuar të hetonte me kujdes atë që ajo meritonte dhe e zhvishte nga zmadhimet.

Prandaj erdhi që në mëngjes në këto korridore të bardha. Ai pyeti njerëz, mjekë dhe dëgjoi fjalë të tilla që e bënë t'i vinte çudi se si ai, një gazetar i vjetër, nuk kishte pasur rast të njihej me një grua si Meri. Më shumë e tërhoqi biseda me dy kolegë të saj.

— Nuk di ç't'ju them për të, — i tha njëra, një

grua e re dhe e shëndetshme. — Ajo është një kirurge e guximshme dhe zemërgjerë.

Ai e vështroi pak me habi.

— Është një grua shumë e ndjeshme, — tha ajo, — por, përballë vdekjes, bëhet më e egër se vdekja vetë.

Ai vuri buzën në gaz. Ajo iu duk tepër entuziaste.

— Është grua me fëmijë, — tha tjetra. — Në shtëpi, si të gjitha ne, gatuan, lan, bashkë me të shoqin pregatit fëmijët për në shkollë, pastaj vjen këtu dhe ne e njohim si mjeke të rreptë dhe të dashur.

Natyrisht ai ende nuk mund të krijonte një përfytyrim të saktë mbi këtë grua, ai vetëm mendohej të mos i shpëtonte asgjë për të gjatë bisedave.

Në mëngjes ai nuk mundi ta shihte, sepse mjekja nuk donte të takonte njeri. Ai vendosi të mësonte shkakun: modesti, mospërfillje apo ndonjë gjë tjetër. Një gjë e tillë nuk qe e lehtë, por ai mundi ta mësonte. I thanë se mund ta takonte vetëm pas operacionit që do të bëhej në mbrëmje. . .

Gazetari u mbështet në karrige dhe ndezi një cigare. Ca njerëz ishin afruar pranë një dere të madhe aty nga fundi i korridorit dhe pritnin. Ai mendoi se ata duhej të ishin të afërmit e pacientit që po operohej. Priti duke thithur cigaren dhe duke u munduar të përfytyronte ato që kishte mësuar në mëngjes. . .

Atë ditë pacienti që do të operohej kishte kaluar një krizë të rëndë. Ishte një djalë njëzetvjeçar që kishte një defekt në zemër që në lindje. Defekte të tilla mund të riparohen vetëm me operacion. Po kriza e bëri të pamundur operacionin. Pacienti nisi të humbte ndjenjat, frymëmarrja iu vësh-

tirësua dhe të gjithë menduan se ai ishte në prag të vdekjes. Merin e thirrën me urgjencë.

— S'është e mundur, — tha ajo, — unë kam ndjekur nga afër gjithçka dhe ai ishte në gjendje të mirë, bile të lehtë për të përballuar operacionin!

Profesor Kenoja u mundua ta qetësonte. Ajo kishte marrë një pamje të dëshpëruar dhe në rru-dhat e fytyrës dukeshin shenja nervozizmi. Erdhën edhe kirurgë të tjerë dhe nisën të ekzaminonin pa-cientin.

— Klinikisht i vdekur, — arriti përfundimi, — kriza e papritur i ka dhënë impulse të tepërta zem-rës dhe ajo nuk është në gjendje të kontraktojë. Ndarja e gjakut tani nuk bëhet fare.

Merit sa nuk i erdhi për të qarë.

— S'është e mundur, — tha prapë gati duke belbëzuar, — ai kishte një organizëm të fortë dhe operacionin do ta përballonte lehtë. — Ajo foli në kohën e shkuar sikur gjithçka të kishte marrë fund papritur, prandaj ndjeu të skuqej dhe të inatosej.

— Por, — tha profesor Kenoja, — kjo s'do të tho-të aspak që ai të mos binte në gjendje vdekjeje, Meri. Mos doni t'ju nis një leksion mbi pasigurinë në profesionin tonë?

Meri kishte humbur e gjithë në mendime dhe, kur profesor Kenoja tha këto fjalë, e vështroi në sy. Ajo ushqente një ndjenjë të madhe respekti për drejtuesin e saj të vjetër në rrugën e profesionit, me ndihmën e të cilit kishte kapërcyer situata të vështi-ra. Por, mos duhej të tërhiqej dhe ta linte djaloshin të vdiste, t'ua kthente të afërmye pa bërë asnjë për-pjekje për ta sjellë në jetë? Një ditë më parë i kish-te siguruar të afërmit e pacientit se ai ishte mirë

dhe do ta përballone lehtë operacionin. Ç'mund t'u thoshte tani? Ç'mund të bënte?

U larguan të gjithë. Profesor Kenoja i rrahu shpatullat me dashmirësi dhe i tha se kirurgjia ishte një shesh beteje i pafund midis jetës dhe vdekjes. Që të arrije në atë shesh, duhej të futeshe në një mijë korridore dhe, që të dilje përsëri nga she-shi, duhej përsëri të kaloje në një mijë korridore.

Ajo e kishte vështruar në sy me një nervozizëm të hapur.

Gjithë atë ditë ajo e ushqueu të sëmurin me oksigjen, i bëri masazhe në kraharor dhe gjymtyrë dhe vuri re se ai u bë më mirë. Mos duhej t'ua kthente të afërmve pas kësaj ringjalljeje të përkohshme? Ajo u mundua të sillte ndër mend gjithë përvojën e saj në kirurgji, solli ndër mend raste të vështira. Kujtoi mjeshtrin e kirurgjisë, doktor Shirokën, profesorë të tjerë që kishin ndenjur në të njëjtat audiotore dhe kishin arritur suksese të mëdha, solli ndër mend edhe profesor Gori Kenon, që kishte ecur shumë larg në profesion. Vallë, ç'duhej bërë në situata të tilla? Përse ai tani e këshillonte të tërhiqej?

Tani vdekja i dukej si një fëmijë e përkëdhelur, që s'di të bëjë asgjë, që qëndron pranë një pellgu dhe nuk shpëton dot një flutur të bukur që përpëlitet në ujë.

Edhe pasdite Meri ndenji në spital. Pacienti ishte mirë, ajo i ndiente të gjitha veprimet e tij, ndiente çdo lëvizje, çdo rrahje zemre dhe papritur vetja iu duk e lashtë, e rrahur me jetën, e fuqishme dhe tërë qenien e saj e përfshiu një siguri e madhe dhe, pa ngurruar fare, ajo tha:

— Përgatiteni për operacion! Në sallë! Ju lutem njoftoni profesor Kenon të vijë këtu!

Befas u pendua për fjalët e fundit, por ishte vonë.

Paradhoma, e mbushur me avujt e sterilizatorëve, me erën e gomës së lagur dhe të barnave, pikonte djersë. Mjekët dukeshin të qetë. Edhe profesor Kenoja dukej i qetë dhe i përmbajtur, megjithëse mundahej të vëzhgonte çdo lëvizje të Merit. Ajo nuk ishte aspak e qetë. Herë-herë në fytyrën tërheqëse, në të cilën viheshin re rrudha lodhjeje, kalonte një hije nervozizmi.

«Kam frikë, — tha me vete profesor Kenoja. — vështirë që ky operacion të ketë ndonjë shpresë, por... ta marrë e mira, po ndodhi kjo, Meri do të pësojë zhgënjim dhe do të tronditet.»

Atij iu kujtua dështimi i saj në operacionin e të vëllait. Atë ditë ajo iu lut të asistonte në operacion (me sa dukej nuk e ndiente veten të sigurt) dhe ai erdhi. Ajo kishte çuditërisht një vendosmëri të jash-tëzakonshme. I vëllai vuante nga mushkëria e majtë, e cila i kishte shkaktuar kalbjen e zemrës. Asnjë kurë nuk mund t'i bënte efekt dhe ajo vendosi ta operonte. Po, me të nisur operacioni, profesor Kenoja e kuptoi se pacienti nuk do të rezistonte dot. Me siguri edhe Meri e dinte këtë, por ai vuri re një përpjekje të përbindshme prej mjeshtri për ta kthyer pacientin në jetë. «Ç'forca ka kjo grua» — kishte thënë me vete. Ajo luftoi me të gjitha forcat, e ktheu disa herë në punë zemrën rebele që heshtte papritur dhe, kur e mbylli plagën, ngriti fytyrën e mbushur me djersë e lotë.

— Shpëtoi! — tha.

Profesor Kenoja e vështroi në heshtje. Dy ditë më vonë pacienti vdiq. Ajo nuk erdhi për disa ditë në punë dhe, kur u kthye, nuk operoi më. Kjo na-

tyrisht ishte e rëndë për një kirurg, i cili nuk duhet ta humbasë kurajën asnjëherë. «Aq më tepër një grua» — mendoi ai. Kështu kaloi një kohë e gjatë dhe e mundimshme, e mbushur me dëshirën për t'u ndeshur me vdekjen dhe jetën, gjersa më në fund një ditë ajo përsëri mori në duar bisturinë.

Dhe tani ai vinte re të njëjtat shprehje në fytyrën e saj. E gjithë qenia ishte mbështjellë me një vello nervozizmi dhe ai pati frikë se mos e pësonte si në rastin e të vëllait. Vendosi t'ia kujtonte këto, me qëllim që ajo të ishte e përgatitur dhe të mos pësonte ndonjë tronditje të re, në rast se. . .

— Meri, — i tha ai, — a e ndieni veten të qetë?

— Besoj, profesor, — tha, ajo duke u ngritur më këmbë. Kjo tregonte hapur se ajo nuk e ndiente veten aspak të qetë. Matanë dyerve me xhame akulli ishte bërë çdo gjë gati për operacion dhe kirurgia vendosi të futej në sallë.

— Duhet patjetër të jeni e qetë, Meri, — tha profesor Kenoja, — dhe të mos harroni se në profesionin tonë. . .

Për çudi, në fytyrën e saj vuri re një pamje të qetë, të ashpër, në të cilën nuk dukej asnjë notë sentimentalizmi. Sytë e mëdhenj i ndritnin në një mënyrë të çuditshme, kryeneçë dhe atij iu duk se ajo do të ndodhej në prag të një tronditjeje të re. Oh, ai e dinte se ajo e donte profesionin, ishte shkri-rë e gjitha në të dhe çdo mossukses e shqetësonte gjer në tronditje. Prandaj ai vendosi t'ia thoshte troç mendimin e tij. Po Meri kishte hapur derën e sallës së operacionit dhe po matej të hynte brenda, ndërsa të tjerët po bëheshin gati ta ndiqnin pas. Papritur u ndal.

— Mos më thoni asgjë, profesor, — i tha, — çdo

gjë mund të ndodhë. — Ajo e vështronte me sytë që s'donin ta tërhiqnin shkëlqimin kryeneç. — Po, megjithatë, unë, mjeku, duhet të jem më se i sigurt në korridoret e profesionit tim. Bisturia ime duhet të presë e sigurt dhe unë duhet të jem e bindur në atë që bëj.

Ajo u fut brenda në sallë. Të tjerët e ndoqën pas, dera e rëndë me xham akulli u puthis mirë dhe gjithçka humbi pas asaj bote të bardhë, nëpër të cilën zgjateshin mijëra korridore që e mbushnin njeriun me ankth e shpresë. . .

Gazetari u ngrit më këmbë. «Çfarë gruaje na genka kjo kirurgia Meri, pra?»

Kishin kaluar disa orë dhe nga salla ende nuk po vinte ndonjë lajm i sigurt.

— Si thua, do ta shpëtojë? — pyeti njëri nga ata që pritnin.

— Duhet pasur besim te Meri, Pandi.

— Unë e di se ajo është një kirurge e zonja, po pse e thirri profesor Kenon?

— Kjo s'do të thotë asgjë, — ndërhyri gazetari padashur, jo më tepër për të sqaruar punën, sesa për t'u dhënë kurajë.

Njerëzit e vështruan të panjohurin në heshtje. Po ai ç'priste aty? Gazetari ndezi një cigare dhe nisi të lëvizte në korridorin e gjatë ngjyrë qymështi. Ai kishte arritur pothuaj në fund të korridorit, kur papritur u hap dera e madhe dhe njerëzit iu vërsulën mjekëve që dolën njëri pas tjetrit. E para doli një grua, pastaj profesor Kenoja, i cili nuk dihet pse i kujtoi Endrju Mensonin, dhe pastaj me radhë... Gruaja përshëndeti me dorë dikë dhe eci me një çap të gjatë, pothuaj burrëror, nëpër pllakat që shndritnin.

Ai i doli përpara dhe ajo menjëherë i tha:

— Ah, jeni ai gazetari? — Për çudi ajo tani iu duk një grua e gjatë, tërheqëse dhe me flokë të verdhë, tek-tuk të zbardhur nga thinjat, e kjo atij i kujtoi Ana Gejslerin. U habit që e krahasoi përsëri me një personazh të Kroninit.

— Urdhëroni! — Ajo e la të kalonte i pari në dhomën e mjekut.

— Erdha të shkruaja për ju, — tha gazetari.

— Të shkruani për mua?! — tha ajo me habi.

— Unë pandeha se donit t'ju tregoja ndonjë gjë për anesteziologjinë.

Dukej sikur ajo u takua me të për t'i folur mbi sukseset dhe zhvillimin e shkencës së mjekësisë dhe jo për veten. Ai e pyeti se përse kishte zgjedhur kirurgjinë, a nuk ishte një specialitet i vështirë për një grua dhe a nuk kërkonte mundësira të posacme? Ajo e vështroi në sy, sikur të kërkonte të depërtonte në brendësinë e tyre. Sytë e gjelbër në gri të gazetarit iu dukën të çiltër dhe kërkues. Ai kërkonte vetëm një përgjigje të sigurtë.

— Që kur i hyra kësaj rruge, — tha ajo, — më preokuponin gjithë kërkimet e reja dhe rezultatet e tyre. Gjithnjë kam luftuar të mos mbetem në vend me shkencën, të thyej ato koncepte që pushtojnë në specialitetin tonë edhe njerëz që kanë arritur rezultate të mira.

Gazetari e vështroi me vëmendje. Me siguri ajo kishte parasysh profesor Kenon, që, ndonëse ishte bërë i njohur me profesionin e tij, nuk mund të shkëputej nga ajo që i pushton zakonisht disa mjekë, mungesa e besimit në vetvete. Po kjo grua, vallë, a kishte mundur të shkëputej?

Ajo po i shpjegonte se, si grua, i duhej të shtrydhte kohën për të zhvilluar aftësitë e saj. Sepse, ndo-

nëse ekzistonin të gjitha mundësitë, asaj i mbeteshin shumë gjëra për të bërë.

— Po, — përfundoi ajo, — unë gjithnjë do të ndiej bezdi kur njerëzit thonë: «E shikon, bëri këtë. Është grua dhe e bëri». Me ç'të drejtë e thonë? Unë dua që të më vënë në të njëjtën balancë aftësie me cilindo, pavarësisht nga seksi.

Gazetari donte t'i bënte edhe një pyetje, po e kuptoi se biseda kishte mbaruar. Ai ende nuk po gjente dot pikënisjen e portretit të kësaj gruaje.

Ata qëndronin në heshtje dhe gazetari vëzhgoonte me kujdes tiparet e saj, sytë e mëdhenj dhe njerëzorë, ballin e rrudhur dhe të gjerë.

— A keni pasur ndonjë rast të veçantë gjatë këtyre viteve në punë? — e pyeti papritur ai.

Asaj i kaloi në fytyrë një dridhmë e lehtë, të cilën gazetari nuk mundi ta vinte re.

Pastaj me zë të qetë tha:

— Njeriu, si raste të veçanta, përmend ato më të vështirat. Por... — ajo bëri një pauzë të shkurtër; — për ne, kirurgët, rastet më të vështira janë më të dëshpëruarat.

— Po rasti i sotëm? — Mendja atij i kishte shkuar tek operacioni i të vëllait.

Meri u ngrit, buzëqeshi dhe papritur u bë serioze, e ftohtë dhe, tek po hapte derën, u kthye nga ai.

— Edhe rasti i sotëm ishte i veçantë, — tha, — por aspak i dëshpëruar.

Ai e ndoqi me sy tek lëvizte në korridorin e gjatë ngjyrë qumështi me një çap të qetë dhe të sigurt. E gjithë lodhja e asaj dite dukej sikur ishte tretur si ata avujt e narkozës që bridhnin nëpër sallë. Pastaj ai kapërceu derën e pavijonit dhe doli nëpër natë. Dritëzat e yjeve pikëlonin dhe era e mbrëmjes

i krijonte një gjendje shpirtërore të mirë. Si mund ta niste shkrimin për të? Mos duhej ta niste: «Ishte një kohë kur...» Ai tha me vete se, po ta niste kështu, me siguri do t'i hapte vetes punë, po vendosi ta niste pikërisht kështu: «Ishte një kohë kur gruaja shqiptare endej nëpër vite me forca të pakrahueshme, me botën e saj të madhe shpirtërore, po gjithnjë nëpër pluhura, e padukshme dhe e papërfillshme. Ajo nuk ishte krijuar aspak të stoliste sallonet dhe t'u buzëqeshte mysafirëve të lartë që do të çmonin bukurinë, dhëmbët e bardhë dhe xhevahirët...»

Gazetari lëvizte nëpër natë duke ndier erën e mbrëmjes dhe pikëlimin e butë të yjeve thellë në shpirtin e tij të ndjeshëm. Ndërsa preokupimi i tij vazhdonte. «Jo, — tha me vete — pak ka të përbashkët kjo grua me Ana Gejslerin. Gruaja e shkrimit tim është ndryshe. Dikur ajo grua ishte një zonjë e përlulur shtëpie, në luftë ishte vërtet trimëreshë, po në shoqëri një send pa vlerë. Ajo gjithnjë ka qenë e pajisur me forca të pakrahueshme, të cilat kanë shpërthyer nëpër kohëra.» Atij iu kujtua Teuta që iu drejtua konsullit romak: «Thuaji senatit tënd, o romak!...» — dhe urdhëroi të përgatiteshin për t'u bërë ballë ushtrive më të fuqishme të kohës. Pastaj iu kujtuan vajzat e Shkëmbit të Vajës. Miro Tërbaçja, Shota. Ai e hodhi mendimin te heroinat e kohës së partisë. «Po, — tha me vete — ajo kohë kur gruaja shtrydhej nën kapakët e trashë të historisë ka mbetur larg. Partia e vështroi drejt në sy, zbuloi forcat e saj të mëdha dhe e mori me vete në rrugën e triumfit të revolucionit.»

Gazetari mendoi se kjo do të ishte një hyrje shumë e gjatë për një portret, po menjëherë e ndër-

rroi këtë mendim. Atij iu duk se i kishte rënë shumë shkurt. Përfytyroi Merin në operacionin e fundit, luftën e madhe, vështrimin e ftohtë në aparatet, duke ndier gjithnjë pas shpatullave vështrimin e ngrohtë, të habitur dhe entuziast të profesorit plak. Këtë radhë ishte ai që thirri me padurim.

— Shpëtoi, të lumtë, Meri!

Gazetari priti autobusin e fundit në stacion. Tani ai e kishte të qartë portretin e saj dhe ishte i sigurt se do të arrinte një shkrim të mirë. Por ajo që e mbushte me emocione ishte forca e vërtetë e saj, qëndrueshmëria dhe shpirti i ndjeshëm për të arritur të pabesueshmen. Dhe ai u përpoq të gjente titull për shkrimin e tij; nën atë titull do të fliste për gruan me ndjenja dhe mendje të fuqishme.

**PLAKU
DHE
KËNGA**

Plaku vendosi të mblidhte bagëtinë dhe të zbris-
te poshtë në Gropë ku kishte zënë rrënjë qindra vjet
më parë një fshat i vogël me shtëpi prej guri, mbu-
luar me plloça. Ai fshat shihte vetëm disa orë diell
në ditë, sepse ishte i rrethuar me male të larta, të
veshura me drurë dhe shkurre. Po që nga malet du-
kej një pamje e rrallë dhe, ndonëse po mbushte tre-
çerek shekulli jetë, plaku e kundronte gjithnjë me
qejf duke jetuar thellë vetes çdo nuancë të re, çdo
ngjyrë të perëndimit dhe matanë malit nëpër një të
çarë, detin, që hapte krahët gjer në pafundësi.

Që fëmijë plakut i kishte lindur dëshira të kën-
donte. Edhe tani që kokën e kishte të bardhë dhe
vështrimin të rrudhur, sa herë vinte mbrëmja dhe
ai kthehej me bagëtinë përpara, e mundonte kënga.
Sepse ai këngën e sajonte vetë dhe ajo tregonte gjith-
një një ngjarje të re. Kënga e tij ishte një lajm i ri
për ato anë të humbura që nuk dinin fare se ç'bëhej
matanë maleve, ishte si një rreze drite që e lidhte
me jetën e tërë vendit. Prandaj dhe njerëzit nisën
ta donin dhe ta nderonin çobanin këngëtar. Që kur
ishte djalë i ri dhe fshihte komitët lart në mal, ai

zbriste me këngë në buzë dhe, kur mblidheshin njerëzit të ndanin bagëtinë, ai shpërthente dhe të gjithë e dëgjonin gojëhapur. Kënga herë ishte e butë dhe e ëmbël, herë e hidhur farmak, herë trimërore që t'i ndizte zemrat zjarr dhe herë dukej si një ulërimë dufi dhe urrejtjeje. Gjithnjë, kur kthehej, edhe tani që ishte plak, ai ia merrte një kënge dhe ata e kuptonin se kishte ndodhur diçka përtej maleve, aty ku hapej kasabaja.

«Vërtet e vranë Xhelo kapedanin, o Bato?»

(Natyrisht kjo kishte ndodhur vite më parë, që atëherë kur kënga kishte nisur t'u shërbente njerëzve si një lajmëtar i përtejmaleve.)

Ai nuk e ndërpriste këngën, por e vështronte atë që e pyeste në sy dhe i bënte shenjë të heshte dhe të dëgjonte. Kënga tregonte historinë e Xhelo kapedanit (atë e njihnin të gjithë), plaku bënte me vargje portretin e tij, shtatlartë, leshgjatë e fytyrëgjërryer nga tufanet e maleve dhe me vështrimin thikë. Sa herë ishte ndeshur me karvanet, sa herë i kishte goditur koshadhet e pashait turk, gjersa një ditë kullën e beut e mbyti në flakë. Trim o trim na qenkësh ky Xhelo kapedani, po një ditë pazari e zunë. Shumë kohë e solli vërdallë dovetin, po më në fund e shpunë në litar. Megjithatë fjalët e fundit «Vdekur më mirë dhe i lirë, se gjallë dhe në robëri» dhe atë vështrimin thikë s'ia shuan dot.

Batoja u hidhte fshatarëve vështrimin e tij që nuk qe më i butë dhe priste ta pyetnin për ndonjë gjë. Por askush nuk pyeste, ai vinte re ankth dhe urrejtje, pastaj ata ngriheshin dhe largoheshin në heshtje. Ai kthehej nga nusja e tij e re, fare e re dhe e vështronte në bark, vallë a do t'i lindte një djalë,

një djalë me yll në ballë që ta rriste lart në stane dhe ta bënte komit?

Por u deshën shumë vite t'i lindte djali, vërtet me yll në ballë lindi, po mbeti i vetëm. Që atëherë Batoja kishte kënduar shumë këngë, këngë të vjetra trimërie që nisnin majave dhe lëshoheshin humnerrave dhe, pasi futeshin thellë në zemrat e njerëzve, hapeshin në tërë krahinën dhe ushqenin mall për lirinë. Rrodhën edhe kohëra të tjera. Plaku Bato ndiente mbi supe peshën e viteve dhe malet etjen për komitë, por kënga nuk u plak.

...Plaku mbloodhi bagëtinë me ndihmën e dy qenve të mëdhenj dhe të fuqishëm dhe nisi të varej poshtë malit. Dhe, si zakonisht, duhej t'ia merrte nëpër buzë këngës së re, por ai ende nuk kishte mundur t'ia gjente dot fillin. E mundonte një si ankth brenda kraharorit të tij të gjerë dhe leshtor dhe sikur e pengonte ta lëshonte zërin. E çfarë s'i kishte ndodhur plakut kur niste këngën. Herë i vinte të këndonte fort, herë mezi i dilte zëri, herë nuk i vinte fjala e përshtatshme, herë ritmi, sido që kishte ndodhur, më në fund ai e niste këngën dhe ajo merrte malet. Kurrë s'i kishte ndodhur të mos këndonte dot një këngë...

Në atë fshat të futur në gropë ku dielli e shihte vetëm dy orë në ditë, të rejat i mësonin vetëm nga këngët e plakut Bato. Njerëzit mësuan edhe për tradhtinë e mbretit dhe pushtimin e Shqipërisë nga fashistët këmishëzinj me pendë si këndesë. Atëherë shpirti i plakut ishte mbushur me vrer dhe ai zbriste i zymtë dhe inatçi dhe nëpër dhëmbë i vërtitej një këngë e egër dhe plot duf. Njerëzit e dëgjonin dhe mbusheshin me urrejtje dhe ndonjëri rrëmbente ar-

mën dhe humbiste pyjeve. Nuk mbahej mend se sa kohë kënga e plakut vulli zemërim për të keqen e madhe që kishte gjetur mëmëdheun dhe fukaranë; dukej se shpirti i tij i ndjeshëm nuk do të qeshte më dhe ai vetëm këndonte me pikëllim dhe pishat e gjata i mbanin iso dhe psherëtinin.

Plakut mendja i vente tek i biri, tashmë i rritur. Ai ishte i gjatë si pishë malesh, i shpejtë si vetëtimë dhe i butë si një qengj manar. Bënte të gjitha punët që mund të bëjë një bujk i mirë dhe plaku e donte shumë. Po, me sa dukej, ai mendonte se i biri nuk e ndiente dhe aq robërinë. Dhe, sa herë zbriste nga mali dhe i afrohej shtëpisë, plakun e zinte ankthi dhe shpirti i dridhej. Edhe gjunjët i dridheshin, ndërsa vështrimi hetonte me kujdes kopshtin, dritaret, pastaj sytë lëviznin përsëri në dritaret e vogla a thua nuk do të gjente më njeri në shtëpi. Po, me t'u dëgjuar zilet e bagëtisë, hapej dera dhe i biri jepej te pragu.

— U lodhe, o baba?

Plaku e vështronte në heshtje. Ata qëndronin një copë herë më këmbë pranë njëri-tjetrit, njëri i gjatë, i drejtë dhe i fuqishëm, tjetri i plakur dhe i kërrusur nën peshën e viteve. Fytyra e plakut merrte një pamje të tillë sikur të thoshte se nuk ishte aspak i kënaqur që e gjente të birin në shtëpi. Dhe kjo ishte e vërtetë. Atëkohë plaku përfytyronte vitet e kaluara kur në malet e atdheut endeshin komitë si Xhelo kapedani që e sillnin vërdallë dovetin edhe pse e dinin që do të përfundonin në litar. Vallë a nuk kishte djem Shqipëria që t'u thyenin topat dhe hekurin këndesëve fashistë?

Plaku e vështronte të birin me pikëllim dhe

dukej sikur e qortonte që e gjente në shtëpi. I biri e ndihmonte të futej brenda, të çlodhej ca dhe të priste njerëzit që do të vinin të mësonin të rejat. . .

*
* *
*

Plaku zbriste ngadalë tatëpjetë duke u munduar të gjente fjalët e këngës së re. Kishin ardhur kohëra të çuditshme dhe malet ishin mbushur me luftëtarë. Thoshin se ata luftëtarë të merrnin gjak në vetull dhe po e thërrmonin në mënyrë të pakuptueshme makinën fashiste. Plaku nuk dinte shumë për ta, megjithatë ai u ngriti këngë. Dhe për çudi këngët i mësuan fshatshe dhe i këndonin sa herë mblidheshin bashkë. Por ajo që e tërhoqi më shumë plakun Bato ishte rrëfimi për një djalë. Për të thoshin se qe bir i vetëtimës dhe luftonte si një dragua përrallash, nga ato që tregoheshin netve të dimrit. Thoshin dhe se ai ngrihej mbi kreshta malesh me njerëzit e tij dhe qëllonte me vetëtima armiqtë, duke mbjellë panik dhe vdekje. Dhe përfytyrimi i plakut ishte ndezur menjëherë. Natyrisht i kujtoi edhe Xhelo kapedanin, por thoshin se ai djalë nuk qe dragua përrallash, as komit nuk qe, po partizan. Partizan do të thoshte bir i Partisë. Megjithatë plakun nisi ta mundonte kënga. Ai lëvizte çukë më çukë dhe breg më breg me bagëtinë dhe nën rrezet e diellit që copëzoheshin nëpër halat e pishave i ngriheshin përfytyrimi pothuaj legjendar dhe malli për të birin. Sa kishte ëndërruar që të kishte një bir të tillë! Dhe atë mëngjes plaku Bato kishte mësuar se biri i vetëtimës ishte shuar përdhe.

«E shuan, o Bato, e shuan siç shuhet vetëtima.»

Ai përfytyroi shuarjen e vetëtimës duke përhapur flakë dhe gjëmime. Po plaku nuk dinte shumë për atë komit (a partizan siç i thoshin djemuria, ai mendonte se komitet dhe partizanët duhej të ishin njëloj), prandaj dhe nuk dinte nga t'ia niste këngës. Ai nuk e njihte fare, vetëm kishte dëgjuar nga të tjerët dhe mendja i kishte mbetur tek ai.

«Eh, Bato, o plaku Bato, — psherëtiu me vete — iku koha kur ti i mësoje i pari gjëmat.»

Ai me të vërtetë e kishte të vështirë t'i ngrinte këngë. Sepse ai nuk i kishte ardhur asnjëherë në stan dhe plaku s'e kishte parë dot.

Atij iu kujtua se si kishte ndodhur nja dy vjet më parë...

...Po zbriste si gjithnjë me kopenë përpara dhe pushkën supit, në kondakun e së cilës kishte gdhendur një shqiponjë. Qarkullonin fjalë se fashistët merrnin me forcë djem të rinj nga fshati dhe i shpinin të hapnin rrugë. Kjo kishte ngjallur zemërim dhe fshatarët nuk dëgjonin të punonin për fashizmin. Djemuria nuk kishte duruar dot dhe ishte ngritur me sforcë dhe sëpata dhe i kishte përzënë sipërrrësit, dhe kjo e kishte entuziazmuar plakun Bato. Menjëherë atë nisi ta mundonte kënga dhe, tek zbriste, ndiente një farë lehtësimi dhe gëzimi të pakuptueshëm. Rrugën e bëri më shpejt se herët e tjera, sikur të mos i pritej sa t'ua tregonte njerëzve këtë ngjarje.

Po, kur arriti në shtëpi, i biri nuk i doli në prag si gjithnjë. Ai hyri brenda dhe nuk gjeti njeri. Atëherë vendosi të shkonte në qendër të fshatit. Mbylli bagëtinë, hodhi pushkën krahut dhe u nis dalngadalë në qendër të fshatit. Nën degët e një rrapit të lash-të njerëzit ishin shtruar këmbëkryq dhe tymosnin

me llullat e tyre të mëdha e të gdhendura. Njerëzit nuk i folën, nuk e pyetën si gjithnjë, ata vetëm thithnin llullat dhe lëshonin re tymi. As ai nuk foli. U mbështet në trungun e rrapit dhe vuri pushkën në prehër duke ndier një farë shqetësimi, i cili kishte mbetur i nderur mbi kokat e tyre. Ai e kishte harruar fare të birin. Rrinte me sytë mbërthyer në shqiponjën e gdhendur në kondak të dyfekut dhe heshte duke u munduar t'i shpëtonte ngacmimit nervor që e pickonte në mënyrë të çuditshme. Ç'të kish-te ndodhur vallë? A e dinin ata se ai kishte sajuar një këngë të re që me siguri do t'ua ngroh-te zemrat? Ai ngriti kokën dhe i vështroi me radhë. Ata thithnin llullat që kërcitnin dhe lëshonin re tymi. Papritur iu kujtua i biri. Ku mund të ishte ai? Ia zuri syri midis djemve të rinj duke thithur edhe ai një llullë.

— Eja këtu, — i tha duke u ngritur më këmbë.

I biri iu afrua ngadalë fytyrëngrysur dhe kokulur.

— Të paktën thuamë ti se ç'ka ndodhur, — i tha plaku Bato.

— Ç'të të them?

— Atë që s'e thonë dot këta burra me mustaqe, atë të më thuash, — iu gëmush plaku Bato. — Ç'më rrinë turivarur sikur t'u ketë ngrënë gomari bukën.

— Eh, lëre, o plak, — sekush tha nga turma, — na kanë vënë në be.

Plaku u mundua të shquante atë që foli. Po nuk mundi dhe pyeti pa iu drejtuar njeriu:

— Kush kështu?

— Talianët, — sekush tha.

— Pse, o, ç'do na marrën më? — u hakërrye plaku Bato. — Na ka metur gjë tjetër pa na marrë?

Nën hijen e rrapit për një copë herë u vendos një heshtje e rëndë. Pastaj sekush tha nëpër dhëmbë:

— Djemtë, o Bato, djemtë.

Këtë radhë plaku e njohu zërin e Selos, po përsëri nën hijen e rrapit qëndroi pezull heshtja dhe ai iu kthye të birin.

— Fol! — e urdhëroi.

I biri ngriti kokën dhe nisi të fliste me drojtje:

— Ja, — tha, — erdhën ushtarët italianë dhe kërkuan 50 djem për të hapur llogore...

— Aha! — ia bëri plaku Bato.

— Duan djem të fortë, — tha i biri, — dhe nësër në mëngjes do të vijnë t'i marrin. Edhe mua më thanë.

— Aha! — ia bëri prapë plaku Bato.

Njerëzit nisën të lëviznin dhe të pëshpëritnin, ndërsa plakut i dogji pushka në duar. Pastaj u kthye përsëri nga i biri.

— Po sikur të mos duam? — pyeti.

I biri uli kokën pa folur.

— Po sikur të mos duam? — pyeti prapë.

— Do të djegin fshatin, o plak!

Djali ngriti kokën dhe plaku për herë të parë vuri re në sytë e të birin një ndriçim të ndezur dhe të çuditshëm. Dukej sikur nën qerpikët e rëndë i fshihej një zemërim i përmbajtur, i cili priste vetëm një fjalë që të shpërthente jashtë me duf.

Plaku e vështroi një copë herë në heshtje dhe pastaj vështrimin e hodhi në fytyrat e njerëzve që kishin nisur të ndiqnin me kureshtje bisedën e tyre. Fytyrat e tyre sikur thoshin:

«Ç'të bëjmë, na ka pickuar gjarpri nën vete dhe s'kemi nga t'ia mbajmë.»

Plaku vështroi përsëri të birin. Ai nuk kishte

djalë tjetër, vetëm atë, nuk kishte as vajzë, as grua, as njeri. Seloja kishte pesë djem, të pestë azganë dhe, me siguri do të hidheshin edhe në zjarr, po t'u bënte i ati ndonjë shenjë.

Plaku përsëri vështroi njerëzit. Ata qëndronin në heshtje, me sy të mbërthyer në të dyja siluetat e tyre që po i zbente mugëtira. Pastaj ai vështroi prapë të birin që priste i qetë. Ç'do të ndodhte me plakun Bato? Plaku hoqi ngadalë pushkën nga krahu dhe vështroi edhe një herë shqiponjën e gdhendur në kondak. Ajo ishte gdhendur vite më parë, kur ai kishte qenë i ri dhe në stan priste Xhelo kapedani. Edhe ai kishte gdhendur një shqiponjë. Kur ia kishite parë Batos, i kishte thënë:

«Ke bërë mirë, Bato, shqiponja është një shpend i lirë dhe s'duron dot robëri.»

Tani ai vështroi shqiponjën sikur të donte t'i jepte shpirt dhe ta nxiste të fluturonte. Pastaj papritur ai i zgjati pushkën të birit.

— Ç'bën, o baba?

— Merre, — i tha, — dhe ik.

I biri mbeti i shtangur.

— Ta dëften pushka, bir, ku të vesh, — tha plaku me zë të qetë. — Atje ku luftohet me talianin. Të dëften vetë ajo.

— Por... — i biri zuri të përtypej, — po ti do të mbetesh vetëm.

Plaku Bato ia kishte lënë pushkën në duar.

— S'prish punë, — i tha, — shko! Shko tek ata me yll në ballë që i kanë dalë Shqipërisë për zot!

Djali e dëgjoi pa ia ndarë sytë, ndërsa plaku i tha:

— Dhe mos ma turpëro dyfekun, bir!

Djali i vështroi të gjithë me radhë me sytë të

ndezur çuditërisht dhe pastaj lëvizi me çape të gjata drejt malit.

Atëherë ishte fillimi i luftës dhe njerëzit ende nuk e kuptonin forcën e saj. Ajo ishte një luftë jo e zakonshme, ishte lufta e fuqishme e një populli që po ngrihej dhe po ngjishej rreth një trupi të vetëm me forca të pallogaritshme.

Plaku Bato u ul qetë dhe ndezi edhe ai llullën. Vështroi andej nga ikte i biri dhe si nëpër dhëmbë ia mori këngës dhe njerëzit e dëgjuan me habi. Ajo ishte një këngë e çuditshme dhe sikur bënte fjalë për atë që kishte ndodhur atë ditë në fshatin e tyre. Njerëzit e dëgjonin në heshtje pa thënë asgjë dhe plakut i vinte çudi që nuk ia mbanin.

Por, kur mbaroi, vuri re se disa nga djemtë ishin ngritur më këmbë. Edhe dy djemtë e Selos ishin ngritur më këmbë. Në fytyrat e tyre vihej re një urrejtje dhe shprehej një vendim i patundur.

— Po ne ç'presim, — tha më i vogli i Selos, — urdhrin e babait!

— Si, ore, me sfulqje i zunë talianët ata, ë?

— Ja, ore, njerëz si ne qenë dhe nuk dëgjuan të hapnin rrugë për fashizmin.

— Kurse ne duan të na shpjen të hapim llogore. Ç'i duan llogoret ata, ë?

— Po ne ç'presim?! — klithi prapë djali i vogël i Selos.

Dhe ai nuk priti urdhrin e të atit, i bëri një shenjë të vëllait dhe të dy humbën në muzgun e mbrëmjes që po lëshohej me vrull. Pas tyre nxituan edhe djem të tjerë dhe plakuri Bato, Seloja, dhe fshatarët i vështruan në heshtje gjersa ata u shkrinë në sfondin e mugët të maleve...

Plaku zbriste poshtë ngadalë duke u munduar të gjente fjalët e këngës dhe duke ndier emocione të çuditshëm që e ngacmonin padashur nga rrjedha e kujtimeve. Që atëherë kishin kaluar dy vjet dhe atë e kishte grirë malli për të birin.

Një natë — kjo kishte ndodhur disa muaj më parë — ai kishte ardhur në stan vetëm sa për ta parë. Plaku menjëherë kishte vënë re sytë e ndezur dhe burrërinë në fytyrën e tij dikur të butë. Ndërsa në kondakun e dyfekut, sipër shqiponjës, ai kishte gdhendur një yll.

«— Erdha të të shoh, baba, — i kishte thënë, — si je?

— Mirë, bir. — Çastin e parë të mallit ai e kapërceu dhe tani e vështroi si me dyshim. — Por... mos mbaroi lufta, vallë? — e kishte pyetur.

I biri kishte vënë buzën në gaz.

— Jo, o plaku Bato, — i kishte thënë (ai e kishte kuptuar të atin). — Tani po luftohet me gjermanin. Është më i egër ky gjermani, — kishte vazhduar sikur i ati ta dëgjonte për herë të parë. — Po ne ia kemi hapur varrin.

Plaku e vështronte në heshtje. Pastaj i kishte thënë prerë.

— Atëherë shko, bir, dhe kallenit brenda!

I biri kishte vënë përsëri buzën në gaz. Ai e njihte mirë të atin. Pastaj ata ishin ndarë dhe ai kishte ikur përtej maleve, ndërsa plaku kishte mbledhur bagëtinë në vathë...

Tani ai zbriste tatëpjetë me bagëtinë përpara duke çarë mugëtirën që i ngjishej para syve. Plaku

ishte ende i fortë dhe kishte ecur gjithnjë maleve, megjithëse mbi shpinë mbante halle dhe vite të rënda. Po këngën s'e shoi dot, ajo i dilte vetiu, ai ndiente një si kumbim të thellë në shpirt dhe ajo shpërthente pastaj me vrull. Kështu do të bënte dhe këtë radhë, gjithë fshati duhej ta kishte mësuar këtë lajm dhe njerëzit do t'i thoshin:

«Këndo, o plaku Bato, ngreji një këngë atij biri të vetëtimës, ngreji, se e kemi si birin tonë.»

Ai i përfytyronte njerëzit ulur nën rrapin e madh duke e nxitur me vështrimet e tyre. Ai do t'ia niste këngës dhe ata do t'i mbanin iso.

«Merrja, o plaku Bato, këndo, siç do të këndoje për birin tënd!»

Në mugëtirë plaku vuri re siluetat e dy njerëzve që ecnin njëri pas tjetrit.

«Këndo, o plak, një këngë trimërishte... Është bir i Partisë, o plak, bir i Partisë vetëtimë.»

Dy njerëzit afroheshin ngadalë dhe plaku, që mezi i shquante, po mundohej t'ia shpërthente këngës.

«Në fshat me siguri më presin — thoshte me vete. — Ata duan që unë patjetër të këndoja një këngë. Po këta ç'të jenë?»

Dy njerëzit ishin afruar shumë dhe ai njohu djemtë partizanë të Selos.

— Po, o plaku Bato, duhet t'u këndojmë trimave që ranë për atdhe!

Po plaku nuk këndoi dot, për herë të parë ai nuk këndoi dot një këngë. Djemtë e Selos po i afroheshin kokulur dhe në heshtje. Ata qëndruan përballë tij pa folur. Pastaj e vështruan drejt në sy. Ai më i vogli mbante në sup dy pushkë...

Djemtë e Selos zbritnin poshtë, edhe plaku Bato zbriste pas tyre duke shtrënguar fort pushkën që

i kishin prurë ata. Në kondakun e saj ishte gdhendur një shqiponjë me yll dhe në barkun e saj dukeshin pika gjaku. Ai zbriste ngadalë, me çap të gjatë dhe të thyer, drejt qendrës së fshatit. Ai nuk fliste dot, diçka i qe mbledhur në grykë, diçka e ndrydhte dhe e kafshonte përbrenda dhe ai mendoi se njerzit, ai grumbull njerëzish që qëndronin nën rrapin e madh, e pritnin të këndonte.

«Nuk dua të turpërohem — mendoi. — Po pse s'më del, moj këngë?»

Ai vuri re se nga qendra e fshatit u nda një grup njerëzish dhe nisi të lëvizte drejt malit. Buçiti një këngë, në fillim e butë e pastaj e fuqishme, dhe plakut iu duk e njohur.

«Lule, more trima, që ratë për atdhe.»

Kënga nisi të ngrihej lart dhe të përhapej ashtu e mbushur me dhembje dhe krisma, ajo i ngjitej malit dhe shtrihej edhe poshtë në fshatin e mbuluar nga nata.

«Lule, more trima, që ratë për atdhe.»

«Por — tha me vete plaku Bato — këtë këngë, këtë këngë unë sapo desha ta këndoja. A nuk është kjo për birin e vetëtimës?»

Ai u fut mes njerëzve. Ata këndonin ashtu me dhembje dhe krismë, ata këndonin të harruar në jonet e fuqishme të këngës trimërore.

— Ai ishte yt bir, o plak Bato, vetëtimë ishte...

Ai vështroi fshatarët me radhë dhe pastaj vështroi malin. Partizanët ngjiteshin lart duke kënduar atë këngë të re që ia kishin marrë plakut nga goja.

Dhe plaku shtrëngoi pushkën dhe hodhi çapet e tij të rënda e pleqërishte pas tyre. Thonë se plaku ndoqi pas këngën, po më saktë është se plaku ndoqi pas vetëtimën...

P A S Q Y R A E L Ë N D Ë S

	Faqe
Njerëz të minierës	3
Rrugë në bardhësi	31
Plaku i një qyteti të hirtë	44
Vozabërësi dhe vajza e vrrarë	56
Sytë e kaltër të Madelës	71
Ura mbi greminë	83
Çakmaku i bardhë	98
Një njëri i neveritshëm	127
Në mesnatë kur flinte qyteti	142
Korridore në pafundësi	154
Plaku dhe kënga	165